

# LIGJ PËR AUTOMJETET

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
 Закон за возила

## KREU I

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Lënda e Ligjit

Me këtë ligj përcaktohen kushtet për lëshimin në treg dhe fillimi i shfrytëzimit të mjeteve të udhëtimit, regjistrimi dhe rregullsia teknike e mjeteve të udhëtimit, kushtet për kryerjen e punëve të shërbimeve teknike, personat juridikë për kontrollim teknik dhe personat juridikë për regjistrim dhe regjistrimi i të dhënave për mjetet e udhëtimit.

#### Neni 2

#### Qëllimi i Ligjit

Ligji ka për qëllim sigurimin e shkallës më të lartë të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe gjatë kryerjes së punëve bujqësore dhe pyjore, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të natyrës dhe të efikasitetit energjetik.

#### Neni 3

#### Domethënia e shprehjeve

Shprehje të caktuara në këtë ligj kanë domethënien si vijon:

1. **“Akt normativ”** është specifikimi i veçantë teknik, normativa ose rregullorja e UN/ECE që është si shtojcë e Marrëveshjes për miratimin e dispozitave uniforme (të njëtrajtshme) teknike për mjetet e udhëtimit me rrota, pajisjen dhe pjesët të cilat mund të instalohen dhe/ose të shfrytëzohen te mjetet e udhëtimit me rrota, si dhe për kushtet e njohjes së ndërsjellë të lejeve të lëshuara në bazë të këtyre dispozitave (Marrëveshja e vitit 1958);

2. **“Specifikim teknik”** është akti që i përcakton kërkesat teknike të cilat duhet t’i plotësojë mjeti i udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse ose njësia e pavarur teknike dhe pajisja që të mund të lëshohen në treg, përkatësisht të mund të përdoren, si dhe procedurat me të cilat mund të verifikohet se a janë plotësuar kërkesat;

3. **“Lejim i tipit”** është procedura me të cilën verifikohet se tipi i mjetit i mjetit të udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse ose njësia e pavarur teknike i plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe kërkesat përkatëse teknike;
4. **“Lejim nacional i tipit”** është procedura për lejimin e tipit, të përcaktuar në legjislaturën nacionale të shtetit të caktuar, me atë që validiteti i lejes së tillë është i përkufizuar në territorin e shtetit që e ka lëshuar;
5. **“UE-lejim i tipit”** është procedura me të cilën verifikohet se tipi i mjetit të udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse ose njësia e pavarur teknike i plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe kërkesat përkatëse teknike;
6. **“Lejim unik”** është procedura me të cilën verifikohet se mjeti unik i udhëtimit, unikat ose jo, i plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe kërkesat përkatëse teknike;
7. **“Lejim disafazësh i tipit”** është procedura me të cilën verifikohet se nga aspekti i të kompletuarit, të moskompletuarit dhe të kompletuarit shtesë mjeti i udhëtimit i plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe kërkesat përkatëse teknike;
8. **“Lejim i tipit hap pas hapi”** është procedura e lejimit me të cilën gradualisht mblidhet i tërë totali i UE lejeve të tipit për mjetin të udhëtimit dhe sistemet e lidhura me mjetin e udhëtimit, sistemet, pjesët përbërëse, njësitë e pavarura teknike, që më në fund sjell në lejimin e tërë mjetit të udhëtimit;
9. **“Lejimi i tipit me një hap”** është procedura me të cilën menjëherë bëhet lejimi i tipit të mjetit të udhëtimit si tërësi;
10. **“Lejim i kombinuar i tipit”** është procedura e lejimit hap pas hapi, me ç’rast në fazën përfundimtare të lejimit të tërë mjetit të udhëtimit janë siguruar lejimet e tipit për një sistem ose më tepër sisteme, pa mos pasur nevojë për lëshimin UE lejimit për këto sisteme;
11. **“Mjet udhëtimi”** është çdo mjet transportues i dedikuar për lëvizje nëpër rrugë, përveç ulëseve lëvizëse pa motor për persona të paaftë dhe për mjete transportuese për fëmijë;
12. **“Mjet udhëtimi me forcë lëvizëse motorike”** është çdo mjet udhëtimi që lëviz me forcën e motorit të vet, përveç mjeteve të udhëtimit që lëvizin nëpër shina;
13. **“Automjet”** është çdo mjet udhëtimi me forcë lëvizëse motorike, të cilat rëndom përdoren për transportin e personave dhe të mallrave në rrugë ose për tërheqjen e mjeteve të udhëtimit në rrugë dhe që ka së paku katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/h;
14. **“Autobus”** është mjeti i udhëtimit me motor për transportin e personave me më shumë se ulëse, duke përfshirë edhe ulësen e shoferit;
15. **“Mjet udhëtimi ngarkues”** është mjeti i udhëtimit me motor për transportin e ngarkesës;
16. **“Tërheqës rrugor”** është mjeti i udhëtimit me motor për tërheqje pa hapësirë për ngarkesë, i konstruktuar në mënyrë të veçantë për tërheqjen

e rimorkiove të rënda me bosht rrotullues;

17. **“Tërheqës me ulëse”** është automjet me ulëse që është konstruktuar në mënyrë të veçantë për tërheqjen e gjysmë-rimorkiove;

18. **“Mjet udhëtimit tërheqës”** është automjeti i cili tërheq rimorkio;

19. **“Rimorkio”** është mjeti i udhëtimit i konstruktuar që të tërhiqet prej mjetit të udhëtimit me motor; Rimorkioja mund të konstruktohet si rimorkio me bosht rrotulluese, bosht qendror ose gjysmë-rimorkio;

20. **“Kamp-shtëpizë”** është rimorkioja me mbindërtim të veçantë dhe pajisje të përhershme që mundëson për të qëndruar individë;

21. **“Mjet udhëtimit për banim”** është automjeti me mbindërtim të veçantë dhe pajisje të përhershme që mundëson për të qëndruar individë;

22. **“Rimorkio e lehtë”** është rimorkioja masa më e madhe e përgjithshme e së cilës nuk është mbi 750 kg;

23. **“Makinë mobile”** është automjet me motor të vet që është projektuar dhe prodhuar të kryejë punë specifike dhe për shkak të karakteristikave të veta konstruktive nuk është i përshtatshëm për transport të njerëzve dhe mallrave. Makinat e vendosura në shasi të automjetit motorik nuk konsiderohen makina mobile.

24. **“Biçikletë”** është mjet udhëtimit me një ulëse ose me dy ulëse, së paku me dy rrota dhe lëviz vetëm me forcën e vozitësit;

25. **“Biçikletë me motor ndihmës”** është mjeti i udhëtimit me lëvizje me pedalin, e cila si plotësim mund të ketë motor me djegie të brendshme me vëllim pune që nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup>, ose elektromotor me forcë më të madhe të kontinuar dalëse prej 0,25 kW, me ç’rast veprimi i motorit shkyçet kur shpejtësia do të arrijë 25 km/h, ose nëse biçikletisti e ndërpret veprimin e pedalinës;

26. **“Moped”** është mjet udhëtimit me forcë lëvizëse me motor me dy rrota ose me tri rrota, vëllimi punues i motorit me djegie të brendshme të cilit nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup>, përkatësisht forca e elektromotorit nuk kalon mbi 4kW dhe shpejtësia e të cilit në rrugë të rrafshët është e përkufizuar më së shumti 45 km/h;

27. **“Motoçikletë”** është mjet udhëtimit me forcë lëvizëse me motor me dy rrota, me rimorkio anësore ose pa të, vëllimi i punës së motorit me djegie të brendshme të së cilës nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup> dhe shpejtësia e lejuar e konstruksionit e së cilës nuk është mbi 45 km/h;

28. **“Triçikletë e lehtë (moped me tri rrota)”** është mjet udhëtimit me forcë lëvizëse me motor me tri rrota të instaluar në mënyrë simetrike përgjatë boshtit të mjetit të udhëtimit, vëllimi i punës së motorit me djegie të brendshme të së cilës nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup> dhe shpejtësia më e madhe e lejuar e së cilës nuk është mbi 45 km/h;

29. **“Triçiklet”** është mjet udhëtimit me forcë lëvizëse me motor me tri rrota të instaluar në mënyrë simetrike përgjatë boshtit të mjetit të udhëtimit, vëllimi i punës së motorit me djegie të brendshme të së cilës nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup> dhe shpejtësia më e madhe e lejuar e së cilës nuk është mbi 45 km/h;

30. **“Triçiklet e lehtë”** është mjet udhëtimit me forcë lëvizëse me motor me katër rrota të instaluar në mënyrë simetrike, masa e së cilës nuk kalon mbi 350 kg (pa bateri dhe me forcën e motorit jo mbi 4 kW, nëse

mjeti i udhëtimit është me forcë lëvizëse elektrike), me ç'rast vëllimi i motorit me djegie të brendshme nuk është mbi 50 cm<sup>3</sup> dhe shpejtësia më e madhe e konstrukcionit nuk është mbi 45 km/h;

31. **"Katërciklet"** është mjet udhëtimit me forcë lëvizës me motor me katër rrota të instaluar në mënyrë simetrike, masa e së cilës nuk është mbi 400 kg, nëse është e dedikuar për transportin e njerëzve, përkatësisht 550 kg, nëse është e dedikuar për transportin e ngarkesës (pa bateri nëse mjeti i udhëtimit është me forcë lëvizëse elektrike), me ç'rast forca e motorit nuk kalon 15 kW;

32. "Traktor" është automjet me fuqi motorike, duke e përfshirë traktorin bujqësor apo pyjor me rrota ose me zinxhirë me motor të vet, që ka së paku dy boshte dhe shpejtësi të përcaktuar të konstrukcionit maksimalë jo më të vogël se 6 km/h, funksioni kryesor i të cilit është fuqia tërheqëse dhe është i konstruktuar veçanërisht për tërheqje, shtyrje, bartje dhe t'i japë fuqi pajisjes së caktuar të lidhur, që është e konstruktuar për kryerjen e punëve bujqësore ose pyjore, përkatësisht për tërheqjen e rimorkiove bujqësore apo pyjore, mund të përshtatet për transport të ngarkesave në kuadër të punëve bujqësore dhe pyjore ose mund të jetë i pajisur me ulëse për udhëtarë;

33. **"Motokultivator"** është automjet me një bosht ose me dy boshte dhe me motor me forcë më së shumti prej mbi 12 kW dhe është i konstruktuar që të bartë, të tërheqë ose të shtypë lidhëse ose mjete të ndryshme të ndryshueshme ose të shërbejë për lëvizjen e mjeteve të tilla ose për tërheqjen e rimorkiove të lehta;

34. **"Masë e mjetit të udhëtimit"** është masa e mjetit të udhëtimit të përgatitur për vozitje pa udhëtarë dhe ngarkesë, përveç motoçikletave dhe tricikletave, me shofer pesha mesatare e të cilit është 75 kg, me 90% lëndë djegëse me rezervuar të mbushur plot me lëngje të ndryshme me përjashtim të ujërave të zeza, me rrotë rezervë dhe pajisje, kurse të autobusët edhe me anëtarë të tjerë të ekuipazhit pesha mesatare e të cilit është 75 kg, nëse për to janë paraparë ulëse të veçanta;

35. **"Masë e përgjithshme"** është masa e mjetit të udhëtimit së bashku me masën e ngarkesës, duke përfshirë edhe masën e personave të cilët gjenden në mjetin e udhëtimit, si dhe masën e rimorkios, e cila transportohet në mjetin e udhëtimit;

36. **"Masë më e madhe e konstrukcionit"** është masa të cilën e deklaroi prodhuesi duke pasur parasysh karakteristikat e konstrukcionit të mjetit të udhëtimit;

37. **"Ngarkesë ose"** është pjesa e masës së përgjithshme me të cilën boshti i mjetit të udhëtimit ngarkon shtresën rrugore horizontale në gjendje kur mjeti i udhëtimit qëndron;

38. **"Tip i mjetit të udhëtimit"** është mjeti i udhëtimit i kategorisë së caktuar, që nuk dallon sa u përket aspekteve esenciale. Tipi i mjetit të udhëtimit mund të përmbajë variante dhe përpunime.

39. **"Mjet udhëtimit bazë"** është çdo mjet udhëtimit që përdoret në fazën fillestare të procedurës disafazëshe të lejimit;

40. **"Mjet udhëtimit i pakompletuar"** është çdo mjet udhëtimit të cilit së paku i nevojite një fazë e mëtejme e përpunimit që t'i plotësojë të gjitha kërkesat teknike përkatëse;

41. **“Mjet udhëtimi i rikompletuar”** është mjet udhëtimin në fund të procedurës së lejitimit disafazësh që i plotëson të gjitha kërkesat teknike përkatëse;
42. **“Mjet udhëtimi i kompletuar”** është çdo mjet udhëtimi, i cili nuk duhet të ripërpunohet që t'i plotësojë kërkesat teknike përkatëse;
43. **“Mjet udhëtimi nga përmbyllja e serisë”** është çdo mjet udhëtimi nga pjesa e rezervave, që nuk mund të regjistrohet ose të shitet ose të lëshohet në përdorim për shkak të fillimit të validitetit të kërkesave të reja teknike, për të cilat nuk është bërë lejimi i tipit;
44. **“Sistem”** është tërësia e aparateve të cilat së bashku në mjetin e udhëtimin kryejnë një funksion ose më tepër funksione të caktuara dhe për të cilat vlejnë kërkesat e cilitdo qoftë akti normativ;
45. **“Pjesë përbërëse”** është elementi për të cilin vlejnë kërkesat e aktit normativ dhe që mund të bëhet pjesë e mjetit të udhëtimin dhe që mund të lejohet pavarësisht nga mjeti i udhëtimin, kur akti normativ këtë mundësi mund ta përcaktojë në mënyrë eksplicite;
46. **“Njësi e pavarur teknike”** është aparati për të cilin vlejnë kërkesat e aktit normativ, që do të bëhet pjesë e mjetit të udhëtimin dhe që mund të lejohet veças, megjithatë vetëm në lidhje me një tip ose me më tepër tipe specifike të mjeteve të udhëtimin dhe kur akti normativ këtë mundësi e përcakton në mënyrë eksplicite;
47. **“Pjesë dhe pajisje origjinale”** janë pjesët ose pajisja që janë përpunuar në pajtim dhe kushtet dhe standardet teknike për prodhim, që prodhuesi i mjetit të udhëtimin i përcakton për prodhimin e pjesëve dhe të pajisjes për prodhimin e pjesëve dhe të pajisjes për kompletimin e mjetit përkatës të udhëtimin. Kjo përfshin pjesët dhe pajisjen që janë përpunuar në linjën e njëjtë të prodhimin si ato pjesë dhe pajisja. Konsiderohet, përveç nëse nuk dëshkohet e kundërta, se pjesët janë origjinale nëse prodhuesi i pjesëve dëshmon se ato janë identike me cilësinë e pjesëve përbërëse të përdorura me rastin e kompletimit të mjetit të caktuar përkatës dhe janë përpunuar në pajtim me kushtet teknike dhe standardet e prodhimin, që i përcakton prodhuesi i mjetit të udhëtimin;
48. **“Prodhues”** është personi fizik ose juridik, i cili përgjigjet para organit për lejitim për të gjitha llojet e procedurave për lejitim ose procedurave për dhënie e pëlqimit dhe për sigurimin e identitetit të prodhimin. Personi fizik ose juridik nuk nevojitet të inkuadrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha fazat e përpunimit të mjetit të udhëtimin, sistemit, pjesës përbërëse ose të njësisë së pavarur teknike, që është objekt i procedurës së lejitimit;
49. **“Përfaqësues i prodhuesit”** është çdo person fizik ose person juridik me vendbanim në shtet, të cilin prodhuesi e autorizon ta përfaqësojë para organit për lejitim dhe të ndërmarrë masa në emrin e tij në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Ku është përmendur shprehja “prodhues” duhet të nënkuptohet qoftë prodhuesi, qoftë përfaqësuesi i tij;
50. **“Organ për lejitim”** është organi kompetent për lëshimin e lejeve të tipit të mjetit të udhëtimin, sistemeve, pjesëve përbërëse ose të njësisë teknike të pavarura ose lejeve të veçanta të mjeteve të udhëtimin; dhënie e pëlqimit për procedurë, për përpunimin dhe për tërheqjen e lejeve të lëshuara, për veprim si pikë kontakti në kontaktet me organet për lejitim shtetit tjetër; për autorizimin e shërbimeve teknike dhe të dëshmojë se prodhuesi i plotëson detyrimet nga aspekti i përshtatjes së prodhimtarisë;

51. **“Organ për vlerësimin e kompetencës”** është Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë;
52. **“Shërbim teknik”** është personi juridik i autorizuar nga ministri i Ekonomisë me propozimin e organit për lejim në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, me cilësinë e laboratorit për zbatimin e kontrollimeve, ose me cilësinë e trupit për vlerësimin e përshtatjes për vlerësime dhe kontrollime dhe/ose për inspektim;
53. **“Metodë kontrolluese virtuale”** është simulimi kompjuterik, duke përfshirë llogaritjet me të cilat dëshmohet se mjete i udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse, ose njësia e pavarur teknike i plotëson kërkesat teknike nga aspekti normativ. Për kontrollimet me metoda virtuale nuk ka nevojë për praninë fizike të mjetit të udhëtimit, sistemit, pjesës përbërëse ose të njësisë së pavarur teknike;
54. **“Leje e tipit”** është dokumenti me të cilin organi për lejim dëshmon zyrtarisht se tipi i mjetit të udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse ose njësia e pavarur teknike është lejuar;
55. **“UE-leje e tipit”** është dokumenti shtojcë i aktit normativ. Si dokument i barabartë konsiderohet edhe formulari për komunikatë i shtojcës përkatëse ndaj njërës nga rregulloret UN/ECE;
56. **“Leje për mjet unik udhëtimi”** është dokumenti me të cilin organi për lejim dëshmon se mjete i caktuar i udhëtimit është lejuar;
57. **“Vërtetim për përshtatje”** është dokumenti me të cilin prodhuesi, përkatësisht përfaqësuesi i prodhuesit dëshmon se mjete i udhëtimit nga seria, që i përket tipit të lejuar, është në përshtatje me aktet normative në momentin e lëshimit të tij në treg, përkatësisht dokument me të cilin shërbimi teknik dëshmon se mjete unik i lejuar i udhëtimit të cilit i përket, është në përshtatje me të gjitha aktet normative në momentin e lejimit të tij;
58. **“Pëlqim për regjistrim”** është dokumenti i cili lëshohet në procedurën për identifikim, ose në procedurën për identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të mjetit të udhëtimit, nëse është dëshmuar se mjete i udhëtimit është i aftësuar për vozitje të sigurt;
59. **“Regjistrim”** është lejimi për shfrytëzim i mjetit të udhëtimit në rrugë që përfshin identifikimin e tij me dhënien e numrit serik të njohur si numër i regjistrimit;
60. **“Import”** është hyrja e mjeteve të udhëtimit nga vendet e Unionit Evropian, përkatësisht importim nga vendi i tretë;
61. **“Person juridik për kontroll teknik”** është personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik të mjeteve të udhëtimit;
62. **“Prodhim”** është mjete i udhëtimit, sistemi, pjesa përbërëse, njësia e pavarur teknike ose pajisja për mjeteve të udhëtimit dhe për pjesëmarrësit në komunikacionin në rrugë dhe udhëtarët;
63. **“Karrocë”** është mjete udhëtimi të cilën e tërheq kafsha e mbrehur;
64. **“Dokument informatash”** është dokument i shtojcave ndaj akteve të caktuara normative, në të cilin janë regjistruar të dhënat që duhet t'i inkorporojë kërkuesi me ç'rast lejohet që dokumenti i informatave të jepet në formë elektronike;

65. **"Dosje informatash"** është dosja e plotësuar me dokument informatash, dokumentesh, të dhënash, vizatimesh, fotografish etj., që i dërgon kërkuesi, me ç'rast lejohet që dosja e informatave të jepet në formë elektronike;

66. **"Pako informatash"** është dosja e informatave, e plotësuar me raportin e kontrolleve dhe me të gjitha dokumentet tjera, që shërbimi teknik ose organi për lejim i kanë shtuar në dosjen e informatave gjatë kryerjes së detyrave të veta, me ç'rast lejohet që pakoja me informata të jepet në formë elektronike; dhe

67. **"Përmbajtje e pakos së informatave"** është dokument në të cilin inkorporuar përmbajtja e dokumentit të informatave, numërimi përkatës ose i shënuar ndryshe, kështu që njihen lehtë të gjitha palët, me ç'rast forma e këtij dokumenti është e atillë që paraqet evidencë të hapave të njëpasnjëshëm të mbajtjes së UE-lejimit të tipit, veçanërisht të datave të revizioneve dhe të plotësimeve.

## Neni 4

### Raporti me ligjet e tjera

(1) Dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji zbatohen ndaj kërkesave teknike të mjeteve të udhëtimit në komunikacioni rrugor, procedurave për lejimin e mjeteve të udhëtimit dhe ndaj kushteve të cilat duhet t'i plotësojnë personat e autorizuar juridikë që marrin pjesë në procedura, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj tjetër.

(2) Për prodhimet për të cilat ekzistojnë kërkesa në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për sigurimin e prodhimeve dhe dispozitat e miratuara në bazë të atij ligji.

(3) Për personat juridikë të cilët kryejnë punë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për sigurimin e prodhimeve dhe dispozitat e miratuara në bazë të atij ligji.

## Neni 4-a

### Zbatimi supsidiar

(1) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Në procedurat për mbikëqyrje inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, Ligjit për inspektoratin shtetëror të tregut, Ligjit për inspektoratin shtetëror të bujqësisë, Ligjit për polici, Ligjit për mjedis jetësor, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

## KREU II

### KUSHTET PËR LËSHIMIN NË TREG DHE FILLIMIN E SHFRYTËZIMIT TË PRODHIMEVE

#### Pjesa e parë

## Dispozitat e përgjithshme

### Neni 5

#### Kushtet

(1) Mjetet e udhëtimit, sistemet e tyre, pjesët rezervë, njësitë e pavarura teknike dhe pajisja mund të lëshohen në treg dhe të fillojnë të përdoren nëse i plotësojnë kërkesat e përcaktuara teknike, përkatësisht janë lejuar në pajtim me procedurën e përcaktuar, përkatësisht nëse e kanë kaluar procedurën e përcaktuar të identifikimit ose procedurën e identifikimit dhe vlerësimin e gjendjes teknike dhe nëse me shenja identifikimi (numri i shasisë dhe numri i motorit) në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Mjetet e udhëtimit regjistrohen nëse janë plotësuar kushtet në pajtim me dispozitat e Kreut III të këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Nuk mund të ndalohet, të përkufizohet ose të refuzohet shitja, regjistrimi dhe shfrytëzimi i mjeteve të udhëtimit, sistemeve, pjesëve rezervë, njërive të pavarura teknike dhe pajisjes nga aspekti i konstruksionit dhe funksionimit të tyre që janë përfshirë me këtë ligj, nëse kërkesat e tilla të përcaktuara me këtë ligj janë plotësuar.

### Neni 5-a

#### Informimi për automjetet e reja për udhëtarë

(1) Prodhuksi për automjetet e reja për udhëtarë të kategorisë M1, që lëshohen në treg, konsumatorëve duhet t'u sigurojë informata për konsumin e karburantit dhe emisionet e CO<sub>2</sub>, për informimin e tyre gjatë zgjedhjes së automjetit të ri.

(2) Ndalohen informatat dhe mënyra e informimit për konsumin e karburantit dhe emisionet e CO<sub>2</sub>, që nuk janë në përputhje me rregullën e miratuar në bazë të nenit 11 paragrafi (1) alineja 8 e këtij ligji, dhe që mund të shkaktojnë keqkuptime tek konsumatorët potencialë të automjeteve të reja për udhëtarë të kategorisë M1.

(3) Gjohë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Gjohë në shumë prej 30% nga gjoha e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (3) i këtij neni.

### Neni 6

#### Përfundime

Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen për:

- mjetet e udhëtimit të projektuara dhe të përpunuara për nevojat e Armatës së Republikës së Maqedonisë, policinë ose për shërbimet e zjarrfikësve;
- mjetet e udhëtimit të dedikuara për punë në kantiere kapitale ndërtimi, rrëmihje sipërfaqësore, gurore, limane dhe aeroporte;
- mobile;



- mjetet e udhëtimit shpejtësia më e madhe konstruksionit të së cilave nuk është mbi 6 km/h;
- mjetet e veçanta të transportit që i drejtojnë udhëtarët;
- mjetet e udhëtimit të dedikuara për rekreim jashtë rrugëve publike;
- biçikletat me elektromotor ndihmës;
- pajisjen e makinave të konstruktura në mënyrë të posaçme për shfrytëzim në pylltari;
- pajisjen e makinave pyjore, pajisjen e instaluar në shasinë e mjetit të udhëtimit për punë bujqësore;
- pajisjen e ndryshueshme të makinave që është ngritur tërësisht nga toka, kur mjeti i udhëtimit në të cilin është kyçur përdoret në rrugë;
- mjetet e udhëtimit, të cilat importohen përkohësisht për shkak të pjesëmarrjes në gara, panaire dhe manifestime të tjera të organizuara në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast importimi i përkohshëm i këtyre mjeteve të udhëtimit mund të zgjasë më së shumti 30 ditë;
- mjetet e udhëtimit të dedikuara për vozitje në komunikacionin rrugor, dhe që nuk regjistrohen;
- mjetet e udhëtimit të dedikuara ekskluzivisht për gara dhe;
- mjetet e udhëtimit prototipe, që përdoren nëpër rrugë me përgjegjësinë e prodhuesit, për shkak të zbatimit të programeve të veçanta për kontrollim, me kusht që të jenë planifikuar dhe përpunuar në mënyrë të veçantë për këtë qëllim.

## **Neni 7**

### **Procedura për plotësimin e kushteve**

(1) Përcaktimi i plotësimit të kushteve të nenit 5 të këtij ligji bëhet me këto procedura:

- lejimin e tipit të mjetit të udhëtimit, sistemit, pjesëve rezervë dhe njësive të pavarura teknike dhe pajisjes (UE lejimit të tipit dhe lejimit nacional të tipit);
- lejimin e pjesëve dhe pajisjes jo origjinale për mjetet e udhëtimit dhe të pjesëve e të pajisjes që nuk kanë leje për tip;
- lejimet e veçanta të mjeteve të udhëtimit sipas kërkesave të përgjithshme, përkatësisht të veçanta;
- identifikimin e mjetit të udhëtimit;
- identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të, mjeteve të udhëtimit; dhe
- kontrollimet e mjeteve të udhëtimit sipas kërkesave të veçanta.

(2) Lejen nga paragrafi 1 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni e lëshon organi për lejim. Plotësimin e kërkesave teknike në procedurat nga paragrafi 1 alinetë 1, 2 dhe 3 e verifikon shërbimi teknik.

(3) Procedurën për identifikim, përkatësisht për identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të mjetit të udhëtimit, në emër të organit për lejim, në bazë të autorizimit të veçantë nga neni 63 të këtij ligji e zbaton personi juridik për kontroll teknik ose shërbimi teknik.

(4) Procedurën e kontrollit të mjeteve të udhëtimit sipas kërkesave të veçanta në bazë të autorizimit të veçantë nga neni 63 të këtij ligji e zbaton personi juridik për kontroll teknik ose shërbimi teknik.

## **Neni 8**

### **Organi për lejim**

Organ për lejim është Ministria e Ekonomisë - Byroja për metrologji.

## Neni 9

### **Prodhimet të cilat nuk janë harmonizuar me të drejtën e Unionit Evropian, përkatësisht janë prodhuar në pajtim me dispozitat nacionale të shteteve të veçanta**

(1) Prodhimet e lëshuara në treg në shtet tjetër në pajtim me dispozitat e tij, e që nuk janë harmonizuar me të drejtën e Unionit Evropian, lejohen me procedurë të veçantë.

(2) Nëse organi për lejim, në bazë të dokumentit dhe të të dhënave të tjera lidhur me prodhimin vërteton se prodhimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk siguron mbrojtjen e interesit publik, do të ndalojë shfrytëzimin e prodhimit, ose do të kërkojë heqjen e prodhimit.

(3) Masat nga paragrafi (2) i këtij neni, organi për lejim mund t'i ndërmarrë sipas kushteve në vijim:

- në njoftimin me shkrim inkorporohet dispozita që është bazë për ndalimin për lëshimin në treg, përkatësisht kush kërkon tërheqjen e prodhimit nga tregu;
- nëse në bazë të të dhënave teknike e shkencore që janë në dispozicion konkludohet se ekzistojnë shkaqe të lidhura me mbrojtjen e interesit publik dhe se masa më të lehta nuk do të mundësonin nivelin e nevojshëm të sigurisë;
- para ndërmarrjes së masës i ka dhënë mundësi prodhuesit që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, t'u përgjigjet kërkesave; dhe
- para marrjes së vendimit lidhur me llojin e masës i ka përshkruar vërejtjet dhe i ka arsyetuar shkaqet për marrjen e masës.

(4) Kushtet e paragrafit (3) alineja 3 e këtij neni zbatohet vetëm për procedurën për lejimin e tipit.

(5) Në procedurën për lejim nga paragrafi (1) të këtij neni mund të merren parasysh kontrollet e bëra në shtet tjetër, nëse rezultatet e kontrolleve të tilla janë pranuar nga shërbimi teknik.

## Neni 10

### **Devijimi nga kërkesat**

(1) Organi për lejim mund të lejojë devijim nga kërkesat e caktuara në lejimin për:

- mjetet e udhëtimit pjesët rezervë dhe njësitë e pavarura teknike të cilave janë bërë në seri më të vogla në pajtim me dispozitat e miratuara të këtij ligji;
- mjetet e udhëtimit nga përmbyllja e serisë;
- mjetet e udhëtimit, pjesët e pajisjes e tyre që janë prodhuar sipas teknologjive të veçanta, ose me zgjidhje të veçanta teknike;
- automjete të konfiskuara me vendim gjyqësor të plotfuqishëm në procedurë penale ose kundërvajtëse në dobi të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për menaxhim me pronë të konfiskuar, dobi pronësore dhe sende të konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtje.
- mjetet e udhëtimit për dedikime të veçanta;
- mjetet e udhëtimit që lejohen si të veçanta.

(2) Me rastin e devijimit nga paragrafi (1) të këtij neni, shërbimi teknik mund të zbatojë edhe kërkesa relevante alternative.

(3) Kërkesa alternative në kuptimin e paragrafit (2) të këtij neni janë rregullat administrative dhe kërkesat teknike të cilat mund të përmbajnë edhe metoda virtuale kontrollimi, me qëllim që të garantohet siguria në shfrytëzimin dhe në komunikacionin rrugor, si dhe mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyra në nivelin e mundshëm më të lartë.

(4) Kërkesat alternative nga paragrafi (3) i këtij neni, i përcakton ministri i Ekonomisë.

## Neni 11

### Dispozitat të cilat i miraton ministri i Ekonomisë

(1) Ministri i Ekonomisë së afërmi i përcakton:

- kërkesat teknike për kategori të caktuara të mjeteve të udhëtimit, sistemet e tyre, pjesët përbërëse, njësitë e pavarura teknike dhe pajisjen, dimensionet, masat e përgjithshme dhe ngarkesën e osës, si dhe kërkesat teknike për mjetet unike të udhëtimit në pajtim me nenin 5 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën për lëshimin e lejes së tipit dhe të lejes së veçantë mjetet unike të udhëtimit në pajtim me nenin 7 të këtij ligji;
- formën dhe përmbajtjen e formularëve për lejimin e tipit, lejes së veçantë, vërtetimit për përshtatje dhe të pëlqimit për regjistrim në pajtim me nenin 7 dhe nenin 31 të këtij ligji;
- formën dhe përmbajtjen e shenjave të përshtatjes, si dhe mënyrën e vendosjes së tyre në pajtim me nenin 7 të këtij ligji;
- kriteret e përafërta të cilat duhet t'i plotësojnë mjetet e udhëtimit që të marrin statusin e mjetit të udhëtimit me vlerë historike (oldtamerë) dhe procedurën për verifikimin e përmbushjes së këtyre kriterëve në pajtim me nenin 25 të këtij ligji;
- mënyrën e zbatimit të kërkesave alternative për rastet nga neni 10 i këtij ligji;
- informatat që i janë në dispozicion konsumatorit për konsumin e karburantit dhe emisionet e CO2 lidhur me shitjen e automjeteve të reja për udhëtarë, në përputhje me nenin 5-a të këtij ligji,
- formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga neni 12 paragrafi (4) i këtij ligji,
- formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për lejet e lëshuara për tip nga neni 12 paragrafi (6) i këtij ligji,
- formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për lejet e lëshuara individuale nga neni 17 paragrafi (25) i këtij ligji,
- lartësinë e shpenzimeve për lejim individual nga shërbimet teknike sipas nenit 17 të këtij ligji,
- lartësinë e shpenzimeve në pajtim me nenin 19 të këtij ligji në procedurën për automjetet që janë të lejuara një herë, e në të cilat janë kryer riparime apo ndreqje në kuadër të shpenzimeve reale të nevojshme për lëshimin e saj,
- formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për ndarjen e shenjës së identifikimit (numri i shasisë) nga neni 20 paragrafi (4) i këtij ligji,
- formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për lejet e lëshuara nga neni 20 paragrafi (7) i këtij ligji,
- mënyrën dhe procedurën për shënimin dhe asgjësimin e shenjave të identifikimit të shasisë dhe/ose motorit të automjetit.
- lartësinë e shpenzimeve në pajtim me nenin 12 të këtij ligji në procedurën për lëshimin e lejes së tipit të prodhimit varësisht nga shpenzimet e nevojshme reale për lëshimin e saj;
- formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për lëshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit nga neni 17 paragrafi (7) i këtij ligji;
- lartësinë e shpenzimeve në pajtim me nenin 17 të këtij ligji në

procedurën për lëshimin e lejes së veçantë të mjetit të udhëtimit në kuadër të shpenzimeve të nevojshme reale për lëshimin e saj;  
- lartësinë e shpenzimeve në pajtim me nenin 22 të këtij ligji në procedurën për identifikim, dhe/ose për identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të mjetit të udhëtimit të personit juridik për kontroll teknik në kuadër të shpenzimeve të nevojshme reale për mbajtjen e kësaj procedure.

(2) Me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni mund të vërtetohet shfrytëzimi i detyrueshëm i specifikave teknike që i boton Ministria e Ekonomisë si publikime të veçanta në formë elektronike.

(3) Lista e specifikave të lëshuara teknike nga paragrafi (2) të këtij neni botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashihet zbatimi i standardeve, në pajtim me dispozitat për standardizim.

## **Pjesa e dytë**

# **LEJIMI I TIPIT TË PRODHIMIT**

## **Neni 12**

### **Procedura për lejimin e tipit**

(1) Lejimi i tipit është procedurë me të cilën vërtetohet se a është tipi i mjetit të udhëtimit, tipi i sistemit, tipi i një pjese të mjetit të udhëtimit, tipi i njësisë së pavarur teknike ose tipi i pajisjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe me kërkesat teknike përkatëse dhe, rast se janë plotësuar lëshohet leja për tipin.

(2) Nëse mjete i udhëtimit përpunohet në faza, leje mund të lëshohet për çdo fazë dhe gjatë fazave të mëtejme merren parasysh lejet e lëshuara në fazat paraprake (lejim disa fazësh i mjeteve të udhëtimit).

(3) Për lëshimin e lejes për një tip prodhimi, prodhuesi është i obliguar t'i paraqesë kërkesë organit për lejim.

(4) Për çdo tip prodhimi, prodhuesi është i obliguar t'i paraqesë kërkesë për lejim organit për lejim.

(5) Shpenzimet në procedurën për lëshimin e lejes së tipit të prodhimit bien mbi prodhuesin.

(6) Organi për lejim mban evidencë për lejet e lëshuara nga paragrafi (3) i këtij neni.

## **Neni 13**

### **Kushtet sipas së cilave vlejné lejet e lëshuara të tipit të prodhimit dhe shfuqizimi i tyre**

(1) Leja për tip prodhimi mund të lëshohet vetëm në bazë të procedurës së zbatuar në pajtim me dispozita e këtij ligji dhe me dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji dhe për prodhim i cili i plotëson kërkesat e përcaktuara teknike.

(2) Lejet për tipin e prodhimit të lëshuara në bazë të këtij ligji janë valide dhe prodhimi mund të lëshohet në treg, përkatësisht të mund të fillojë të përdoret deri në zbatimin e kërkesave të reja, plotësuese, përkatësisht të ndryshuara. Në dispozitat me të cilat zbatohen kërkesa të reja, plotësuese, të miratuara në bazë të këtij ligji, përcaktohet afati i validitetit të lejes së tipit që nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë muaj nga fillimi i validitetit të këtyre dispozitave.

(3) Organi për lejim do ta refuzojë lëshimin e lejes për tipin e prodhimit nëse vërteton se prodhimi, edhe pse i plotëson kushtet për shfrytëzim, për komunikacion rrugor, për ambientin jetësor ose për shëndetin e njerëzve, edhe përpos plotësimit të kushteve nga paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Nëse prodhuesi në pajtim me dispozitat për sigurimin e prodhimeve duhet të zbatojë procedurë për tërheqjen e serisë së prodhimeve të tipit të lejuar, për shkak se këto prodhime paraqesin rrezik të njëmendët, ai është i obliguar që menjëherë ta lajmërojë organin për lejim dhe të propozojë përshkrimin e masave për korrigjim me projekte.

(5) Organi për lejim mund të kërkojë nga prodhuesi ndërmarrjen e veprimeve plotësuese, përkatësisht të veprimeve të ndryshme korrigjuese të rreziqeve të shënuara të njëmendta të prodhimit. Nëse prodhuesi nuk i kryen veprimet kërkuara në afatin e caktuar nga organi për lejim, atëherë organi për lejim do ta tërheqë lejen e lëshuar.

(6) Gjobë në shumë prej 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje prodhuesit - person juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve (4) dhe (5) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 500 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje prodhuesit - person juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve (4) dhe (5) të këtij neni.

(8) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për prodhuesin-person juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek prodhuesi-person juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (6) i këtij neni.

(9) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shërbimit teknik që zbaton lejim në kundërshtim me dispozitat e neneve prej (1) deri në (5) të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për shërnimin teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek shërbimi teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (9) i këtij neni.

## Neni 14

### Përshtatja e produkteve

(1) Prodhuesi i cili ka leje EU për tipin e produktit është përgjegjës që secili produkt të jetë në përshtatje me tipin e lejuar të produktit, respektivisht është i detyruar që të organizojë procedurë prodhimi dhe sistem për kontrollin e produkteve me të cilin ajo sigurohet.

(2) Prodhuesi i cili ka leje UE për tipin e automjetit është i detyruar që për secilin automjet që është prodhuar në përshtatje me tipin e lejuar të automjetit që të jep leje për përshtatje.

(3) Nëse në prodhim paraqiten devijime të caktuara, prodhuesi është i detyruar që t'i ndërmerret të gjitha hapat e duhur për krijimin e sërishme të përshtatjes së produkteve adekuate me tipin e lejuar të produktit.

(4) Në rast të produkteve jo të përshtatshme, organi për lejim mund ta tërheqë lejen e tipit të produktit ose të përcaktojë afat për mënjanimin e gabimeve të konstatuara. Nëse prodhuesi nuk i bën veprimet e kërkuara në afatin e caktuar nga organi për lejim, atëherë organi për lejim do ta tërheqë lejen e dhënë.

(5) Gjoha në shumë prej 1.500 deri 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. <sup>2</sup>

(6) Gjoha në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

(7) Gjoha në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës të prodhuesit për kundërvajtje të bërë nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni.

## Neni 15

### Përshtatja e prodhimit

(1) Organi për lejim para dhënies së lejes UE për tipin e produktit, kurse pas dhënies së lejes UE për tipin e produktit është i detyruar që të disponojë me dëshmi se ekzistojnë mekanizma dhe procedura të duhura për sigurimin e kontrollit efikas me të cilin do të sigurohet që produkti të jetë i përshtatshëm me tipin e lejuar.

(2) Në zbatimin e obligimit nga paragrafi (1) i këtij neni, organi për lejim sipas nevojës bashkëpunon me organin për lejim nga shteti tjetër.

(3) Konstatimin e përshtatshmërisë së prodhimit nga paragrafi (1) i këtij neni e bën shërbimi teknik me kategori C dhe D në pajtim me nenin 58 të këtij ligji.

## Neni 16

### Ndryshimet në të dhënat dhe lejimi

(1) Prodhuesi i cili ka marrë leje për tipin në pajtim me dispozitat e këtij ligji është i detyruar që ta informojë organin për lejim në lidhje me të gjitha ndryshimet e të dhënave të përfshira në pakon e informacionit të tipit të lejuar të produktit.

(2) Organi për lejim mund të merr vendim vetëm në lidhje me ato kërkesa ose plotësime të lejimit të tipit të produktit që janë të lidhur me vendimin e tij gjatë lejimit të parë.

(3) Secili prodhues, posedues i lejes së tipit është i detyruar që ta informojë për lejim në lidhje me mbarimin e prodhimit, respektivisht ë lidhje me secilin ndryshim në të dhënat në pakon e informacionit.

(4) Gjoha në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni.

(5) Gjoha në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

(6) Gjorbë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për prodhuesin-person juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek prodhuesi-person juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (4) i këtij neni.

## **Pjesa e tretë**

# **LEJIMI I VEÇANTË I AUTOMJETEVE**

## **Neni 17**

### **Procedura**

(1) Lejimi i veçantë i automjetit është procedurë në të cilën organi për lejim në bazë të udhëzimeve të shërbimit teknik vërteton se automjeti i veçantë i kontrolluar, unik ose jo, i plotëson kërkesat e caktuara dhe në pajtim me atë i jepet leje për automjet të veçantë.

(2) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni e përmban numrin identifikues të automjetit (numrin e shasisë dhe numrin e motorit) së cilës i takon.

(3) Për dhënien e lejes së veçantë të automjetit, prodhuesi përfaqësues i prodhuesit, ose pronari është i detyruar që të paraqesë kërkesë në organin për lejim.

(4) Shërbimi teknik jep vërtetim për përshtatshmërinë e automjetit të veçantë të lejuar në bazë të lejes nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Shpenzimet në procedurë për dhënien e lejes së veçantë për automjetin janë në barë të kërkuarit nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Për kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni, organi për miratim detyrohet që të veprojë në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(7) Nëse organi për miratim nuk miraton leje për lejim veç e veç të automjetit, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës, të parashtrojë kërkesë në sekretarinë e drejtorit të organit për miratim - Byroja për Metrologji dhe drejtori të miratojë leje për lejim veç e veç të automjetit.

(8) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton ministri i Ekonomisë.

(9) Drejtori i organit për miratim - Byroja për Metrologji, detyrohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni, në sekretarinë e drejtorit të organit për miratim, të miratojë aktvendim me të cilin do të konstatojë se kërkesa për lëshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit pranohet apo refuzohet. Nëse drejtori nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit për miratim - Byroja për Metrologji.

(10) Me kërkesën për lëshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit, kërkuari dorëzon edhe kopje nga kërkesa nga paragrafi (6) i këtij neni.

(11) Nëse drejtori i organit për miratim - Byroja për Metrologji nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(12) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin për miratim - Byronë për Metrologji nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon drejtorin e organit për miratim - Byronë për Metrologji kompetent për lëshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë Inspektoratit Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(14) Nëse drejtori i organit për miratim - Byroja për Metrologji nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, inspektori do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin drejtori i cili udhëheq organin do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i organit për miratim - Byroja për Metrologji nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të parashtrtojë kallëzime te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (12) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të parashtrtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(17) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (16) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafët (12) dhe (13) të këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafët (14) dhe (15) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin për miratim-Byronë për Metrologji nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Në rastin nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.



(19) Në rastet nga paragrafi (18) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës, e informon parashtruesin e kërkesës.

(20) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (17) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë kallëzim të prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(21) Nëse drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji nuk vendos në afatin nga paragrafi (15) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(22) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(23) Akti nënligjor nga paragrafi (8) i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(24) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (8) i këtij neni, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e organit për miratim - Byrosë për Metrologji.

(25) Organi për lejim mban evidencë për lejet e lëshuara individuale nga paragrafi (3) i këtij neni.

## Neni 18

### Zbatimi i procedurës

(1) Procedura e lejes së veçantë të automjetit realizohet:

- për automjet i cili tipi nuk ka qenë i lejuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e marra në bazë të këtij ligji;
- në rast të punimit në disa faza të automjetit për fazat e veçanta të punimit, nëse disa nga ato fazat janë lëndë e procedurës së lejimit në më shumë faza. Lejimi i veçantë i automjetit nuk mund të zbatohet për fazën e parë dhe për fazën në mes pas së cilës pason faza që është lëndë e lejimit.

(2) Dispozita e paragrafit (1) i këtij neni ka të bëjë edhe për automjetet, respektivisht për pajisjet e tyre të veçanta nëse përdoren për transportin e njerëzve, respektivisht për mallra me të cilat bëhet transporti në linja të veçanta në komunikacionin ndërkombëtar, të përpunuara në mënyrë të veçantë, respektivisht automjetet e pajisura në mënyrë të veçantë (automjetet për dedikim të veçantë siç janë automjetet për transportin e materieve të rrezikshme sipas Marrëveshjes evropiane transport ndërkombëtar rrugor të materieve të rrezikshme (ADR), automjetet për transportin e produkteve ushqimore që prishen lehtë sipas Marrëveshjes për transport ndërkombëtar të produkteve ushqimore që prishen lehtë dhe pajisjen e automjeteve speciale për transport të tyre (ATP)), nëse është përcaktuar ashtu me ligj tjetër, respektivisht me marrëveshje ndërkombëtare. Në atë rast lejim i veçantë bëhet në pajtim me kërkesat e veçanta për kategorinë konkrete të cilit automjeti për dedikim të veçantë. Për atë automjet të lejuar lëshohet vërtetim për përshtatshmëri.

(3) Në rastin nga paragrafi (2) të këtij neni, mund të bëhet lejim i veçantë në pajtim me kërkesat e përgjithshme për kategorinë e veçantë të automjeteve dhe me kërkesat e veçanta për automjetet e veçanta për dedikime të veçanta.

(4) Me ligj tjetër ose me marrëveshje ndërkombëtare mund të përcaktohet obligimi që përshtatja me kërkesat e veçanta nga paragrafi (3) i këtij neni që pronari i automjetin ta mbajë gjatë tërë kohës së shfrytëzimit të sajë që konstatohet me kontrollin e mjeteve për kërkesa të veçanta.

(5) Në rast se konstatohet papërshtatshmëri me kërkesat e veçanta të përcaktuara me dispozitën nga paragrafi (4) i këtij neni, nëse ajo nuk mund të mënjanohet nga pronari, atëherë leja e veçantë për atë automjet merret nga ana e organit për lejim.

(6) Për automjetet e Armatës së Republikës së Maqedonisë që nuk janë përfshirë me nenin 6 alineja 1 e këtij ligji, kërkesat e veçanta për llojin e caktuar për dedikim të veçantë, përveç me dispozitë, respektivisht me marrëveshje ndërkombëtare mund të përcaktohen edhe me akt të ministrit për mbrojtje.

## Neni 19

### Automjetet e përmirësuara dhe të riparuar

(1) Për automjetet që njëherë janë lejuar, e në të cilat janë bërë përmirësime ose riparime që:

- kanë të bëjnë me të dhënat e evidentuara në procedurën e regjistrimit të automjeteve;
- ndikojnë ose që do të ndikojnë në sistemet e lejuara, pjesët përbërëse, njësitë e veçanta teknike dhe pajisjet e automjeteve;
- ndikojë ose që do të mund të ndikojë në sigurinë e automjetit dhe ruajtjen e mjedisit jetësor zbatohet procedura për lejim të automjetit të përmirësuar respektivisht riparuar.

(2) Për përmirësime, respektivisht riparime nga paragrafi (1) i këtij neni janë punë të cilat kanë të bëjnë me: ndryshimet e masës dhe parametrat gjeotermike të automjetit; ndryshimin e llojit, variantin dhe punimin e automjetit; përmirësimin ose ndryshimin e sistemeve të veçanta bazë, respektivisht sistemeve të instaluar paraprakisht, pjesët përbërëse, njësitë teknike të pavarura dhe pajisjet në automjet me të tjera që kanë karakteristika të ndryshuara; riparimet të rëndësishme ose përmirësime (ndërrimi i shasisë e tjerë); instalimi i sistemeve jo origjinale dhe të palejuara, pjesët përbërëse, njësitë dhe pajisjet teknike të veçanta; instalimet në punë me gaz të lëngët nafte, respektivisht me gaz tokësor të komprimuar në automjet e ngjashëm.

(3) Ndërrimi i cilit do qoftë sistem, pjese përbërëse, njësi të veçantë teknike dhe pajisje të automjeti, me atë origjinal, nuk konsiderohet për ndërrime në automjet.

(4) Për riparim të automjetit nuk konsiderohen ndërrimet e bëra të automjetit në pajtim me nenin 54 paragrafi (2) dhe neni 55 i këtij ligji.

## Neni 20

### Kushtet për lejimin e veçantë të automjetit

(1) Lejimi i veçantë i automjeteve duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e sjella në bazë të këtij ligji;

(2) Në mënyrë të veçantë lejohet dhe jepet leje për automjet të veçantë nëse është punuar në pajtim me dokumentacionin e dorëzuar me të cilin vërtetohet se janë plotësuar kërkesat e caktuara teknike. Gjatë lejimit të automjeteve të përmirësuar për sistemet e instaluar, pjesët përbërëse,

njësitë e veçanta teknike dhe pajisjet, merret parasysh ajo dispozitë që ka qenë në fuqi në ditën kur automjeti për herë të parë ka qenë i regjistruar, përveç për sistemet e reja të instaluara, pjesët përbërëse, njësitë teknike të veçanta dhe pajisjen, për të cilat merret parasysh dispozita që ka qenë në fuqi në kohën kur ato si gjeneratë e prodhimit janë instaluar.

(3) Organi për lejim do të refuzojë kërkesën për dhënien e lejes për automjetin e veçantë nëse shërbimi teknik vlerëson se automjeti edhe për kundër plotësimit të të gjitha kërkesave të caktuara teknike paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion, në mjedisin jetësor ose për siguri gjatë punës, pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Nëse automjeti nga neni 18 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk ka numra identifikues të shtypur nga ana e prodhuesit, para se të fillojë procedura e lejimit të veçantë, prodhuesi është i detyruar që ta shtyp shenjën identifikuese (numrin e shasisë) të caktuar nga organi për lejim.

(5) Nëse automjeti është i përmirësuar, kurse nuk ka shenjën identifikuese, respektivisht shenja është e dëmtuar ose e shkruar për herë të dytë, shtypet shenja e parë identifikuese e cila mund të përcaktohet edhe në bazë të dokumentacionit prodhues ose në bazë të prodhimit të prodhuesi i automjetit. Nëse shenja identifikuese nuk mund të përcaktohet, kërkesa për lejimin e veçantë të automjetit refuzohet nga organi për lejim.

(6) Nëse automjeti është prodhuar nga personi fizik ose juridik, si automjet unik, organi për lejim do t'i lëshojë leje me shenjë të ndarë identifikimi (numër të shasisë) prodhuesit, i cili është i detyruar ta shtyp në vendin adekuat në automjet.

(7) Organi për lejim mban evidencë për lejet e lëshuara nga paragrafët (1) dhe (6) të këtij neni.

(8) Gjoha në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (4) të këtij neni.

(9) Gjoha në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit - person fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (4) të këtij neni.

(10) Gjohë në shumë prej 30% nga gjoha e matur për prodhuesin-person juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek prodhuesi-person juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (8) i këtij neni.

(11) Gjoha në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit teknik që jep leje në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) deri (5) të këtij neni.

(12) Gjohë në shumë prej 30% nga gjoha e matur për shërnimin teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek shërbimi teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (11) i këtij neni.

## **Pjesa e katërt**

# **IDENTIFIKIMI, IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I GJENDJES TEKNIKE TË AUTOMJETIT**

## **Neni 21**

## Përcaktimi i procedurës

(1) Identifikimi është procedurë në të cilën konstatohet përshtatshmëria e automjetit dhe të dhënat e tija teknike themelore nëpërmjet dokumentit të ofruar dhe/ose me kontrollin e të dhënave në regjistri i automjeteve të lejuara të tipeve dhe të veçanta, sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të pavarura teknike dhe pajisjeve të automjeteve në Byronë e Metrologjisë.. <sup>3</sup>

(2) Vlerësimi i gjendjes teknike të automjetit është procedurë gjatë të cilës në mënyrë vizuale kontrollohet se a është tërësisht dhe a është në gjendje të aftë për vozitje të sigurt në komunikacionin rrugor, respektivisht për punë të sigurt gjatë kryerjes së punëve bujqësore ose atyre të pylltarisë.

(3) Me procedurën nga paragrafi (2) i këtij neni kontrollohet se automjeti a është përmirësuar, respektivisht riparuar në pajtim me nenin 19 të këtij ligji.

## Neni 22

### Fushëveprimi i kryerjes së procedurave

(1) Automjetet nga neni 23, 24 dhe 25 të këtij ligji, mund të regjistrohen dhe të fillojnë të shfrytëzohen pas procedurës së bërë të identifikimit, ose pas procedurës së bërë të identifikimit dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit. Regjistrimi i automjetit bëhet në bazë të pëlqimit për regjistrim.

(2) Pëlqimin për regjistrim nga paragrafi (1) i këtij neni e jep shërbimi teknik ose personi juridik për kontroll teknik i autorizuar për procedurën e identifikimit dhe/ose identifikimit dhe vlerësimin të gjendjes teknike, pasi që do ta kontrollojë gjendjen identike të automjetit, do t'i grumbullojë të dhënat teknike dhe do ta konstatojë tërësinë e tij dhe gjendjen e sigurisë për vozitje, respektivisht punën e sigurt.

(3) Shpenzimet gjatë procedurës për identifikim, dhe/ose identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit janë në barë të kërkuarit nga nenet 23, 24 dhe 25 të këtij ligji.

(4) Shërbimi teknik dhe personat juridike për kontroll teknik, të autorizuar për procedurën për identifikim dhe/ose identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit, pas kalimit të muajit rrjedhës, të organi për lejim dorëzojnë fotokopje të çdo pëlqimi për regjistrim, që e kanë lëshuar dhe në shtojcë të saj, e dorëzon dokumentin në bazë të të cilit është vendosur se automjeti në fjalë i plotëson kushtet në procedurën për identifikim dhe/ose identifikim ose vlerësim të gjendjes teknike të automjetit. Fotokopjet dorëzohen gjatë javës së parë të muajit të ardhshëm për muajin që ka kaluar. Fotokopjet vërtetohen me vulë të vënë origjinale nga shërbimi teknik dhe personi juridik kontroll teknik, të autorizuar për procedurën për identifikim dhe/ose identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit.

(5) Organi për lejim mban evidencë për pëlqimet e lëshuara për regjistrim që janë lëshuar nga shërbimi teknik dhe personi juridik për kontroll teknik i autorizuar për procedurën për identifikim dhe/ose identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit.

(6) Gjoha në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik për kontroll teknik që bën

procedura në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (2) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik për kontroll teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kontroll teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (6) i këtij neni.

## **Neni 23**

### **Identifikimi dhe vlerësimi i gjendjes teknike të automjetit**

(1) Personat fizikë dhe juridikë të cilët duan ta regjistrojnë dhe të fillojnë me përdorimin e automjetit, për të cilin është aprovuar tipi në përputhje me rregullat e harmonizuara për BE-aprovimin e tipit, ndërsa për të njëjtin nuk ka siguruar vërtetim për përputhshmëri në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, te personi juridik për kontrollin teknik paraqesin kërkesë për identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjetit.

(2) Personat fizikë dhe juridikë të cilët duan që për herë të parë të regjistrojnë në Republikën e Maqedonisë automjet për të cilin në vendin anëtar të Bashkimit Evropian është lëshuar dokumenti i regjistrimit i cili e mundëson regjistrimin e përkohshëm ose të përhershëm, ose për automjetin i cili është përdorur në vendin anëtar të Bashkimit Evropian e për të cilin regjistrimi nuk është i domosdoshëm, te personi juridik për kontrollin teknik paraqesin kërkesë për identifikimin dhe për vlerësimin e gjendjes teknike të automjetit.

(3) Dispozitat e paragrafit (2) të këtij neni, nuk kanë të bëjnë për automjetin aprovimi i të cilit është bërë që të vlejë vetëm në territorin e vendit anëtar të Bashkimit Evropian.

(4) Në rastin nga paragrafi (3) i këtij neni, zbatohet procedura e aprovimit të veçantë të automjetit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e nxjerra në bazë të këtij ligji.

## **Neni 24**

### **Identifikimi i automjeteve**

(1) Te personi juridik për kontrollin teknik, të autorizuar për realizimin e procedurës së identifikimit dhe/ose të identifikimit dhe të vlerësimin të gjendjes teknike të automjeteve, zbatohet procedura për identifikimin e automjeteve të cilat regjistrohen për herë të parë në Republikën e Maqedonisë, për nevojat e:

- 1) Organizatave ndërkombëtare dhe organizatave ndërshtetërore - për përdorimin zyrtar;
- 2) Përfaqësive diplomatike dhe konsullore të shteteve të tjera në Republikën e Maqedonisë - për përdorimin zyrtar;
- 3) Personave diplomatikë dhe konsullorë të punësuar në përfaqësitë e huaja në Republikën e Maqedonisë dhe anëtarët e familjes së tyre më të ngushtë - për përdorimin privat;
- 4) Shtetasve të Republikës së Maqedonisë, të cilët kthehen nga puna ose qëndrimi i përhershëm ose i përkohshëm në vend të huaj, në qoftë se kanë qenë në vend të huaj së paku një vjet pa ndërprerje;
- 5) Shtetasve të huaj të cilëve u është lëshuar aprovim për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Maqedonisë;
- 6) Organet e administratës shtetërore të Republikës së Maqedonisë, organet tjera shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal, ndërmarrjet

publike të themeluara nga shteti, institucionet publike, organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Maqedonisë dhe personat juridike, të cilëve me ligj u është besuar kryerja e funksioneve publike, nëse ata marrin automjete të dhuruara nga institucioni shtetëror, organi shtetëror, përfaqësia diplomatike-konsullore, ndërmarrja publike, institucioni joqeveritar ose organizata humanitare, personi fizik ose juridik nga vendi tjetër.

7) Organizatave humanitare për kryerjen e punëve të tyre humanitare;

8) Automjete të cilat para futjes së sërishme në Republikën e Maqedonisë, një herë kanë qenë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

(2) Procedura e identifikimit të automjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni, bëhet vetëm në bazë të dokumentacionit të parashtruar, pa kontrollimin e automjetit dhe pa kërkesë për përputhshmërinë me rregullat tjera nga sfera e automjeteve.

(3) Identifikimi i automjeteve nga paragrafi (1), pika 3 e këtij neni, nuk ka të bëjë me shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

(4) Identifikimi i automjetit nga paragrafi (1), pikat 4 dhe 5 të këtij neni, mund të bëhet brenda afatit prej një viti nga kthimi i përhershëm, gjegjësisht prej marrjes së lejes për qëndrimin e përhershëm ose të përkohshëm, nëse automjeti paraprakisht ka qenë në pronësi të kërkuesit së paku gjashtë muaj para hyrjes në Republikën e Maqedonisë.

(5) Për dëshmimin e statusit të automjetit dhuruar nga paragrafi (1) pika 6) e këtij neni, nevojitet që të organi për lejim të dorëzojnë dëshmi se automjeti në fjalë, është i dhuruar nga subjekt nga paragrafi (1) pika 6 e këtij neni dhe dëshmi për praninë të automjetit të dhuruar. Këto automjete nuk guxojnë të tjetërsohen në pesë vitet e ardhshme nga dita e marrjes së lejes.

## **Neni 25**

### **Dhënia e statusit të automjetit me vlerë historike (olldtajmer)**

(1) Personi fizikë ose juridikë i cili do që të regjistrojë gjegjësisht të fillojë me përdorimin e automjetit me vlerë historike, pranë personave juridikë për kontrollim teknik paraqet kërkesë për dhënien e statusit të automjetit me vlerë historike (olldtajmer). Pas identifikimit të bërë të automjetit, personi juridik për kontrollin teknik i jep statusin e automjetit me vlerë historike (olldtajmer), automjetit për të cilin përcakton se i përmbush të gjitha kriteret nga paragrafi (2) i këtij neni, si edhe kriteret e përcaktuara me rregullat e nxjerra në bazë të këtij ligji.

(2) Statusi i automjetit me vlerë historike (olldtajmer) i jepet automjetit që është më i vjetër se 35 vjet, i cili është ruajtur dhe teknikisht është mirëmbajtur, si edhe i përshtatur me strukturën dhe formën konstruktive origjinale, ndërsa për shkak të rëndësisë së vet historike dhe teknike, nuk përdoret për transportin e përditshëm.

## **KREU III**

### **REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE**

#### **Pjesa e parë**

## Dispozitat e përgjithshme

### Neni 26

#### Kushti për pjesëmarrje në komunikacionin rrugor

(1) Kushti për pjesëmarrje në komunikacionin rrugor (1) Për pjesëmarrje në komunikacionin rrugor, automjetet duhet:

- të jenë të regjistruara,
- të jenë të shënuara me etiketë për regjistrimin e kryer,
- të kenë patentë të vlefshme shoferi ose vërtetim të vlefshëm për vozitje provuese dhe
- të jenë të shënuara me tabela të përcaktuara të regjistrimit.

(2) Shoferi i automjetit është i obliguar, që me automjetin, të mbajë lejeqarkullim ose vërtetim për vozitje provuese.

(3) Në komunikacionin rrugor lëshohen edhe automjete shpejtësia e konstruksionit e të cilave nuk kalon 25 km/h dhe rimorkiot e lehta, nëse kanë sisteme në gjende të rregullt, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje. Rimorkiot e lehta duhet të shënohet me tabela të përsëritura të regjistrimit të automjetit tërheqës dhe duhet të kenë dëshmi të vlefshme për kontroll të kryer teknik, në të cilin është shënuar afati se kur duhet të kryhet kontrolli teknik i automjetit.

(4) Automjete të përfaqësive diplomatike dhe konsullore dhe misioneve të shteteve të huaja dhe të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë dhe të punësuarve të tyre, të përfaqësive të huaja tregtare, të komunikacionit, kulturore dhe përfaqësive tjera, të zyrave të huaja për korrespondencë dhe të korrespondentëve të huaj të përhershëm, përkatësisht të shtetasve të huaj të punësuar në zyrat e huaja për korrespondencë dhe automjetet motorike dhe të rimorkueshme të shtetasve të huaj, të cilave për shkak të shkollimit, specializimit, hulumtimeve shkencore, punësimeve apo kryerjes së veprimtarisë profesionale, të dhënies së azilit ose të pranimit të statusit të refugjatit, të cilët përherë apo përkohësisht qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë më shumë se gjashtë muaj, si edhe automjete të tjera të cilat janë në Republikën e Maqedonisë në bazë të deklaratave doganore për lëshimin e mallit në qarkullim të lirë, për ose import të përkohshëm, i cili zgjat më shumë se gjashtë muaj, mund të marrin pjesë në komunikacionin rrugor, nëse janë regjistruar në Republikën e Maqedonisë.

(5) Dispozita nga paragrafi (4) i këtij neni nuk ka të bëjë me automjete që qëndrojnë përherë apo përkohësisht në Republikën e Maqedonisë më shumë se gjashtë muaj dhe janë të regjistruara në njërin prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

(6) Automjetet e regjistruara jashtë vendit mund të marrin pjesë në komunikacionin rrugor, nëse kanë tabela të regjistrimit, dokumente për regjistrim të automjeteve dhe shenjë të shtetit ku është regjistruar automjeti, në përputhje me dispozitat e Konventës së ratifikuara për komunikacionin rrugor. Shenja e shtetit mundet, në vend të etiketave të posaçme, të vendoset në tabelat e regjistrimit.

(7) Në komunikacionin rrugor mund të marrin pjesë dhe automjete të shënuara me tabela të huaja të regjistrimit për vozitje provuese ose me tabela të përhershme në gjendje të rregullt teknike dhe që kane lidhur sigurim nga përgjegjësia në komunikacionin ndërkombëtar dhe dokumente të vlefshme për vozitje provuese, përkatësisht dokumente të vlefshme për regjistrim.

(8) Automjet i regjistruar në Republikën e Maqedonisë nuk mund ta lëshojë territorin e Republikës së Maqedonisë, nëse nuk ka vendosur shenjë ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.

(9) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (4) të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni, nëse nga kalimi i vlefshmërisë së leje qarkullimit nuk kanë kaluar më shumë se 30 ditë.

(11) Gjopa në shumë prej 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (2) të këtij neni.

(12) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (4) të këtij neni.

(13) Gjobë në shumë prej 30% nga gjopa e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (12) i këtij neni.

(14) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (4) dhe (6) të këtij neni.

(15) Gjobë në shumë prej 50 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet shoferit për automjet të regjistruar jashtë vendit, i cili nuk ka shenja të shtetit në të cilin është regjistruar.

(16) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni.

(17) Gjobë në shumë prej 30% nga gjopa e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (16) i këtij neni.

## Neni 27

### Rregulla më të përafërta

(1) Ministri i Punëve të Brendshme, i përcakton më për së afërmi:

- mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të automjetit, në përputhje me nenin 26 dhe nenin 31 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën e çregjistrimit të automjeteve në përputhje me nenin 40 dhe nenin 41 të këtij ligji;
- formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për lëshimin e vërtetimit për vozitje provuese, forma dhe përmbajtja e formularit të lejes së qarkullimit dhe të vërtetimit për vozitje provë, si dhe mënyra e plotësimit të formularit të vërtetimit për vozitje provë dhe procedura për lëshimin e tyre në pajtim me nenet 26, 32 dhe 33 të këtij ligji,
- formën dhe përmbajtjen e vulës me të cilën bëhet verifikimi i regjistrimit të bërë të automjetit në lejen e komunikacionit, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;
- formën, përmbajtjen, cilësinë dhe mënyrën e vendosjes së etiketës për regjistrim të kryer,



- formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për lëshimin e targave provuese, forma dhe përmbajtja e targave dhe të targave dhe të targave provë të automjeteve, si dhe mënyra e dhe procedura për lëshimin e tyre në pajtim me nenet 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të këtij ligji,
- rajone të regjistrimit të automjeteve dhe shenjat e tyre në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;
- kushtet e përafërta në lidhje me hapësirës, pajisjes, kuadrot, forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së evidencës për lëshimin e vërtetimeve për vozitje provë dhe targa provë nga ana e personave juridikë të autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik të personave juridikë të cilët lëshojnë automjete në treg, nëse lëshojnë vërtetime për vozitje provë dhe targa provë, në pajtim me nenet 30 dhe 38 të këtij ligji,
- lartësinë e shpenzimeve në procedurën për dhënien e targave në suazat e shpenzimeve realisht të nevojshme për dhënien e tyre, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.
- forma dhe përmbajtja e urdhër pagesës për shfrytëzuar e automjetit me targa provë metalike dhe formën dhe përmbajtjen e regjistrimit të certifikatave të lëshuara për vozitje provë dhe targa provë.

(2) Ministri i Mbrojtjes e përcakton mënyrën e regjistrimit të automjeteve të Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe të automjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes, si edhe formën dhe përmbajtjen e targave të regjistrimit.

(3) Ministri i Punëve të Brendshme, e përcakton mënyrën e regjistrimit të automjeteve të Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si edhe formën dhe përmbajtjen e targave të regjistrimit.

(4) Drejtori i Agjencisë për Kundërzbulim e përcakton mënyrën e regjistrimit të automjeteve të Agjencisë për Kundërzbulim, si edhe formën dhe përmbajtjen e targave.

## **Pjesa e dytë**

# **REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE**

## **Neni 28**

### **Detyrueshmëria e regjistrimit të automjeteve**

(1) Regjistrimi i automjeteve është regjistrimi i të dhënave që kanë të bëjnë me shenjat e regjistrimit dhe me të dhënat që kanë të bëjnë me automjetin dhe me pronarin e automjetit në evidencën e automjeteve të regjistruara, dhe dhënia e etiketës për regjistrimin e kryer.

(2) Në Republikën e Maqedonisë, regjistrohen automjete pronarët e të cilave kanë vendbanim në Republikën e Maqedonisë, automjete të përfaqësive diplomatike dhe konsullore dhe të misioneve të shteteve të huaja dhe përfaqësi të organizatave ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë dhe përfaqësi të huaja tregtare, të komunikacionit, të kulturës dhe përfaqësi të tjera në Republikën e Maqedonisë.

(3) Në Republikën e Maqedonisë, regjistrohen automjete pronarët e të cilave janë shtetas të huaj të cilëve u është lëshuar leje për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Maqedonisë dhe shtetas të Republikës së Maqedonisë të cilët kanë vendqëndrim. Mbi personin vendor juridik ose fizik regjistrohen automjete të cilat janë në përputhje me rregullat doganore për importimin e përkohshëm dhe përdoren në bazë të kontratës për lizing ose të kontratës për bashkëpunim afarist e cila

është lidhur ndërmjet kompanisë vendore dhe të huaj, respektivisht për panairë ose për gara sportive.

(4) Regjistrohen edhe automjete të cilat shtetasit e huaj, pas përfundimit të qëndrimit në Republikën e Maqedonisë, i nxjerrin nga Republika e Maqedonisë, automjete të blera në Republikën e Maqedonisë, automjete të cilat do të regjistrohen në shtete tjera dhe automjete të cilat pas ripërpunimit gjegjësisht përpunimit të plotë, do të nxirren jashtë Republikës së Maqedonisë. Leja e komunikacionit për këto automjete lëshohet me vlefshmëri prej 30 ditësh, kohë e cila nevojitet që automjeti të çohet në shtetin ku do të regjistrohet. Automjetet janë të regjistruara deri në skadimin e vlefshmërisë së lejes së komunikacionit.

(5) Regjistrohen automjete të cilat kanë qenë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë, të cilat kanë qenë të vjedhura, ndërsa organet e huaja të sigurisë të njëjtat i kanë zbuluar. Leja e komunikacionit lëshohet me vlefshmëri për kohën e cila nevojitet që automjeti të silllet në Republikën e Maqedonisë respektivisht me vlefshmëri prej së shumti 30 ditësh. Automjetet janë të regjistruara deri në skadimin e vlefshmërisë së lejes së komunikacionit.

(6) Me kërkesën për regjistrimin e automjeteve nga paragrafi (4) i këtij neni, duhet të bashkëngjitet edhe vërtetimi për përputhshmëri ose pëlqimi për regjistrimin e automjetit. Vërtetimi për përputhshmëri lëshohet në qoftë se automjeti i përmbush të gjitha kërkesat e parapara, të përcaktuara me këtë ligj dhe me rregullat e nxjerra në bazë të këtij ligji, ndërsa pëlqimi për regjistrimin lëshohet në qoftë se është konstatuar se automjeti është në gjendje për vozitje të sigurt.

## Neni 29

### Automjeti në pronësinë e më shumë personave

(1) Nëse automjeti është në pronësi të dy ose më shumë personave fizikë ose juridikë, regjistrohet në emrin gjegjësisht emërtimin e njërit nga ato persona në bazë të marrëveshjes me shkrim, të verifikuar te noteri.

(2) Automjeti që është lëndë e kontratës për lizing ose e kontratës për qira ose i cili shitet me mbajtjen e të drejtës në pronësi, mund të regjistrohet në emrin, gjegjësisht emërtimin e shfrytëzuesit të automjetit, vetëm nëse për këtë ekziston pëlqim me shkrim nga pronari i automjetit, i verifikuar te noteri.

(3) Në rastin nga paragrafi (2) i këtij neni, dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me pronarin e automjetit, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për shfrytëzuesin e automjetit ndërsa në lejen e komunikacionit regjistrohen edhe të dhënat e pronarit të automjetit.

(4) Automjeti i cili është lëndë e kontratës për lizing ndërsa dhënësi i lizingut (pronari i automjetit), ka regjistruar filiale në territorin e Republikës së Maqedonisë, automjeti mund të regjistrohet dhe të mbajë shenja të regjistrimit sipas selisë së filialit.

## Neni 30

### Regjistrimi i automjeteve

(1) Regjistrimin e automjeteve e bën Ministria e Punëve të Brendshme, sipas vendbanimit gjegjësisht selisë së pronarit të ose nëse pronari ka

filiale sipas selisë së filialit respektivisht bartësit të së drejtës për përdorimin e automjetit.

(2) Regjistrimin e automjeteve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore dhe të misioneve të shteteve të huaja dhe të përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë, si edhe të shtetasve të huaj të cilët janë të punësuar në ato përfaqësi, e bën Ministria e Punëve të Brendshme.

(3) Regjistrimin e automjeteve të Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme e bën Ministria e Punëve të Brendshme.

(4) Regjistrimin e automjeteve të Agjencisë për Kundërzbulim e bën Agjencia e Kundërzbulimit.

(5) Regjistrimin e automjeteve të Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes e bën Ministria e Mbrojtjes.

## **Neni 31**

### **Procedura e regjistrimit**

(1) Automjeti regjistrohet pas kërkesës së parashtruar nga ana e pronarit të automjetit.

(2) Me kërkesën për regjistrimin nga paragrafi (1) i këtij neni, pronari i automjetit është i obliguar t'i paraqesë edhe provat me shkrim në vijim:

- prejardhja e automjetit;
- pronësia e automjetit;
- detyrime doganore dhe tatimore të rregulluara të automjetit;
- vërtetim për përputhshmërinë, ose pëlqim për regjistrimin, nëse bëhet fjalë për automjet për të cilin duhet të ketë vërtetim ose pëlqim të atillë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- rregullshmëria teknike e automjetit, përveç për automjetin për të cilin kontrolli teknik nuk është i obligueshëm, në përputhje me nenin 50 të këtij ligji;
- sigurimi i bërë, taksat e paguara, detyrimet e rregulluara në emër të kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike dhe për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe obligimet tjera, të përcaktuara me ligj;
- testimi i bërë i automjetit, nëse bëhet fjalë për automjet të dedikuar për transportin e materieve të rrezikshme;
- çregjistrimi i bërë i automjetit prej organit kompetent të i cili është bërë regjistrimi paraprak;
- statusi i automjetit me vlerë muzeore (olldtajmer).

(3) Provat nga paragrafi (2), alinetë 3, 4 dhe 9 të këtij neni, paraqiten vetëm gjatë regjistrimit të parë të automjetit në Republikën e Maqedonisë.

(4) Prova nga paragrafi (2), alineja 4 e këtij neni, nuk paraqitet gjatë regjistrimit të automjetit me vlerë muzeore (olldtajmer).

(5) Automjeti nuk do të regjistrohet edhe përskaaj provave të paraqitura nga paragrafi (2), alineja 4 e këtij neni, nëse organi për aprovim e njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme se automjeti i takon tipit të automjeteve të cilat edhe përskaaj lejes së lëshuar për tip, paraqet rrezik për komunikacionin rrugor.

## **Neni 32**

## **Leja e komunikacionit dhe targat, etiketa për regjistrimin e kryer**

(1) Për automjet të regjistruar lëshohet leja e komunikacionit, etikete për regjistrimin e kryer dhe numri i përcaktuar i targave, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë zbulimit të veprave penale dhe të kryesve të tyre, si edhe gjatë sigurimit të personave dhe të objekteve, për automjetet e veçanta të policisë lëshohen dy ose më shumë leje, etiketa për regjistrimin e kryer të komunikacionit, dhe targa, në rastet kur atë do ta përcaktojë ministri i Punëve të Brendshme.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për shkak të realizimit të detyrave të caktuara, për automjetet e veçanta të Agjencisë për Kundërzbulim, lëshohen dy ose më shumë leje, etiketa për regjistrimin e kryer të komunikacionit dhe targa, në rastet kur atë do ta përcaktojë drejtori i Agjencisë për Kundërzbulim.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për shkak të realizimit të detyrave të caktuara nga sfera e zbulimit, e kundërzbulimit, e pengimit dhe e zbulimit të veprave penale dhe mbrojtjes së forcave, për automjetet e veçanta të Ministrisë së Mbrojtjes, lëshohen dy ose më shumë leje, etiketa për regjistrimin e kryer të komunikacionit dhe targa, në rastet kur atë do ta përcaktojë ministri i Mbrojtjes.

### **Pjesa e tretë**

## **LEJEQARKULLIMI DHE ETIKETA PËR REGJISTRIMIN E KRYER**

### **Neni 33**

#### **Lëshimi i lejes së komunikacionit**

(1) Leja e komunikacionit lëshohet në formular ngjyra e të cilit, përmbajtja, lloji dhe cilësia e materialit të të cilit janë të njëjta në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Formulari i lejes së komunikacionit shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën angleze dhe alfabetin e saj.

(3) Të dhënat në formularin e lejes së komunikacionit shënohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në alfabetin themelor latin (ICAO Doc.9303).

(4) Qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, me kërkesë të tyre personale, formulari i lejes së komunikacionit u shtypet dhe të dhënat në të shënohen edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor qytetari.

(5) Qytetarët të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha zyrtare, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në lejen e komunikacionit, shënohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari dhe në alfabetin themelor latin (ICAO Doc.9303).

(6) Lejen e komunikacionit e lëshon ose vlefshmërinë e saj e vazhdon Ministria e Punëve të Brendshme.

(7) Për automjetet e reja të cilat regjistrohen për herë të parë në Republikën e Maqedonisë, leja e komunikacionit lëshohet për kohën e cila nuk është më e gjatë se afati deri në bërjen e kontrollit të parë teknik dhe për kohën për të cilën është lidhur sigurimi i obligueshëm, taksat e paguara, detyrimet e rregulluara në emër të kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike, për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe detyrime të tjera të përcaktuara me ligj. Për automjetet tjera, leja e komunikacionit lëshohet për kohën e cila është në suazat e vlefshmërisë së kontrollit të rregullt teknik dhe për kohën për të cilën është lidhur sigurimi i obligueshëm, taksat e paguara, detyrimet e rregulluara në emër të kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike, për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe detyrime të tjera të përcaktuara me ligj.

(8) Makina e mobile, motokultivatori, motoçikleta e lehtë (biçikleta me motor), triçikleti i lehtë dhe katërçikleti i lehtë, i nënshtrohen regjistrimit të përsëritur vetëm gjatë ndërrimit të pronarit, respektivisht bartësit të së drejtës për përdorimin e automjetit ose gjatë ndërrimit të vendbanimit të tij gjegjësisht të selisë.

(9) Pronari i automjetit nga paragrafi (8) i këtij neni, është i obliguar ta ripërtërijë policën e sigurimit të automjetit dhe të jenë të shënuara me etiketë për regjistrimin e kryer, gjatë kohës së përdorimit të automjetit.

(10) Traktori dhe/ose rimorkio e traktorit i nënshtrohen regjistrimit në çdo gjashtë vjet nga regjistrimi i parë.

(11) Pronari i automjeteve nga paragrafi (10) i këtij neni është i obliguar gjatë kohës së vlefshmërisë të lejes së qarkullimit të posedojë dëshmi për sigurim të kryer dhe dëshmi për rregullshmëri teknike të automjetit (dëshmi për kontroll të kryer teknik të automjetit.

(12) Çdo ndryshim i cili ndikon mbi ndërrimin e të dhënave në lejen e komunikacionit, të cilat kanë të bëjnë veçanërisht me: ndryshimet teknike të automjetit, ndërrimin e pronësisë, ndërrimin e adresës së banimit, çregjistrimin e automjetit dhe ngjashëm, pronari është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e ngjarjes së ndryshimit, ta paraqesë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas vendit të regjistrimit të automjetit ose sipas vendbanimit gjegjësisht selisë së pronarit. Me fletëparaqitjen për ndryshimin, pronari i automjetit të regjistruar është i obliguar që të bashkëngjisë edhe prova me të cilat e dëshmon ndryshimin e krijuar.

(13) Humbja e lejes së komunikacionit shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(14) Për lejen e humbur të komunikacionit nga paragrafi (13) i këtij neni, lëshohet duplikatë në përputhje me të dhënat që përmbahen në evidencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(15) Leja e komunikacionit për të cilën është lëshuar publikata, nuk guxon të përdoret në komunikacioni rrugor ndërsa nëse e njëjta gjetet, pronari është i obliguar që ta kthejë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(16) Për lejen e komunikacionit e cila është vjetërsuar ose është dëmtuar në mënyrë e cila e pamundëson përdorimin e saj, pronari është i obliguar që të paraqesë kërkesë për ndërrim me leje të re.

(17) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (9) dhe (12) të këtij neni.

(18) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (15) dhe (16) të këtij neni.

## **Neni 33-a**

### **Etiketa për regjistrimin e kryer**

(1) Etiketën për regjistrimin e kryer e përpunon personi fizik ose juridik i autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

(2) Etiketa për regjistrimin e kryer detyrimisht duhet të ketë cilësi dhe mbrojtje të përcaktuara në rregullën e nenit 27 paragrafi (1) alineja 5 të këtij ligji.

(3) Nuk lejohet të ndërrohet etiketa për regjistrimin e kryer të automjetit. Automjeti nuk mund të jetë në komunikacionin rrugor me etiketë të ndryshme për regjistrimin e kryer nga ajo e përcaktuar ose me etiketë të ndryshuar për regjistrim të kryer.

(4) Etiketa për regjistrimin e kryer duhet të vendoset në mënyrën e përcaktuar në rregullën nga neni 27 paragrafi (1) alineja 5 e këtij ligji.

(5) Etiketa për regjistrimin e kryer duhet të jetë e dukshme qartë dhe e lexueshme, të mos jetë e dëmtuar.

(6) Gjobë në shumë prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje pronarit të automjetit, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

## **Pjesa e katërt**

### **TARGAT**

#### **Neni 34**

#### **Detyrimi i shënimit**

(1) Automjetet në komunikacionin rrugor detyrimisht shënohen me dy targa, përveç motoçikletave të lehta (biçikleta me motor), motoçikletave, katërçikletave të lehta, triçikletave të lehta, triçikletave, automjetet me lidhëze, makinat e punës, rimorkiot e traktorëve dhe motokultivatorët që shënohen me një targë.

(2) Shpenzimet në procedurën e dhënies së targave janë në barrë të pronarit të automjetit.

#### **Neni 35**

#### **Ndërlidhja e targave**

(1) Targat e dhëna për shënimin e automjetit kanë të bëjnë vetëm me atë automjet.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, me kërkesë të veçantë të pronarit, shënimi i targave mund të bëhet me dëshirë të tij në mënyrë tjetër.

(3) Targat nga paragrafi (2) i këtij neni, kanë të bëjnë vetëm me pronarin e automjetit.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje vozitësit i cili përdor targa në automjet për të cilin nuk janë lëshuar.

## **Neni 36**

### **Përmbajtja e targave**

(1) Targat për automjetet i përpunon personi juridikë ose fizikë i autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

(2) Targat, detyrimisht duhet të kenë cilësi dhe mbrojtje përkatëse.

(3) Nuk lejohet ndryshimi i targave të automjetit. Automjeti nuk mund të jetë në komunikacion me targa të ndryshme nga ato të përcaktuarat ose me targë të ndërruar.

(4) Targat detyrimisht duhet të vihen në vendin që e ka paraparë prodhuesi i automjetit, në atë mënyrë që të shihen dhe lexohen mirë, të mos jenë të dëmtuara, të fshehura dhe të mbuluara në plotësim. Targat detyrimisht duhet të jenë ngulmuar ose mbërthyer me vidhë ose fortë të vendosura në mënyrë tjetër.

(5) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (3) dhe (4) të këtij neni.

## **Neni 37**

### **Ndërrimi i targave**

(1) Pronari i automjetit është i obliguar që t'i ndërrojë targat me të reja, kur së paku njëra targë është humbur, është shkatërruar ose dëmtuar ose kur për shkak të përdorimit të gjatë janë bërë të papërdorshme ose të palexueshme.

(2) Gjatë ndërrimit të targave të humbura, jepen targa të reja të cilat kanë numër tjetër, të ndryshëm nga numri i targave të humbura.

(3) Gjatë ndërrimit të targave të shkatërruara ose të targave të papërdorshme, jepen targa të reja me numrin e njëjtë të regjistrimit.

(4) Targat e shkatërruara ose të papërdorshme nga paragrafi (1) i këtij neni i kthehen organit kompetent i cili i ka dhënë.

(5) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 1.200 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (6) i këtij neni.

## Neni 38

### Vërtetim për vozitje provuese dhe për targa provuese

(1) Vërtetimi për vozitje provuese dhe për targë provuese pronarit të mjetit transportues i mundëson shfrytëzim të përkohshëm të mjetit transportues të peregjistruar në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Vërtetimi për vozitje provuese dhe për targë provuese lëshohet me vlefshmëri deri në pesë ditë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, certifikata për vozitje provë dhe tabela bartëse metalike mund të lëshohen për vitin kalendarik për të cilin përdoren targa metalike bartëse provë të personave juridikë që prodhojnë dhe/ose të lëshojnë automjete në treg.

(4) Vërtetimi i lëshuar për vozitje provë dhe targa provë nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni shfrytëzohen për shënimin e vetë automjetit për të cilin është parashtruar kërkesë për vërtetim të vozitjes provë dhe targës provë.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) të këtij neni, Ministria e Punëve të Brendshme për një numër të regjistrimit nga targa metalike bartëse provë, lëshon vërtetim për vozitje provë të personave juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë automjete në treg në bazë të kërkesa e tyre. Personat juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë automjete në treg me kërkesës për vërtetim për vozitje provë dhe targa metalike bartëse provë i dorëzon provat në vijim dhe atë:

a) personat juridik të cilët kryejnë prodhim

- provë për veprimtari të regjistruar,
- provë për sigurim të detyrueshëm të lidhur për automjete të cilat i prodhon ose janë prodhuar ,
- vërtetim për përputhshmëri për lloje të miratuar të automjetit dhe
- taksa të paguara.

b) personat juridik të cilat lëshojnë në treg

- provë për veprimtari të regjistruar,
- provë për sigurim të detyrueshëm të lidhur të automjetit i lëshon në treg,
- vërtetim për përputhmëni për lloje të miratuar të automjetit për automjet ose vërtetim për përputhshmëri, respektivisht në pajtim për regjistrimin për automjet të importuar të vjetër,
- provë për obligimet doganore të rregulluara për automjet dhe
- taksa të paguara.

(6) Vërtetim për vozitje provë dhe targë metali bartëse prove shfrytëzohen për shënimin automjeteve në pronësi të personave juridikë që prodhojnë dhe/ose lëshojnë automjete që janë në treg ose janë nën mbikëqyrje doganore. Vërtetimet e lëshuara për vozitje provë dhe targa provë nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, pronari i automjetit mund t'i shfrytëzojë për: lëvizje deri në vendin e përcaktuar për kontrolli teknik të automjeteve, deri te organi kompetent për regjistrimin e automjeteve, zbatimin procedurave doganore, procedura për miratimin individual të automjeteve, rinovim ose riparim, ekspozitë, manifestim respektivisht shitje e automjetit, vendi për ruajtje, si dhe automjete me të cilat kryhet vozitje provë.

(7) Gjatë shfrytëzimit të vërtetimit për vozitje provë dhe targa metalike bartëse të personave juridikë të cilët kryejnë prodhim dhe/ose lëshimin e automjetit në treg, detyrimisht kanë nevojë të kenë urdhërpagesë.



(8) Për vërtetimet e lëshuar për vozitje provë dhe targa provë nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, regjistër mban Ministria e Punëve të Brendshme.

(9) Evidencë për lëshimin e vërtetimit për vozitje provë dhe targa provë mbajnë personat juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjetit të personave juridikë të cilët lëshojnë automjete në treg.

(10) Të dhënat e përmbajtura në evidencën nga paragrafi (9) të këtij neni, ruhen në kohëzgjatje prej tre viteve.

(11) Ministria e Punëve të Brendshme si dhe personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjetit ose personi juridik i vili lëshon automjet në treg janë të obliguar në lokalitetin ku parashtrahet kërkesa për lëshimin e vërtetimit për vozitje provë si dhe targa provë të pronarit të automjetit në vend të dukshëm të theksojë informacionin për mënyrën e shfrytëzimit dhe përdorimit të vërtetimit për vozitje provë dhe targa provë për shkak të informimit të tyre.

(12) Në rastin nga paragrafi (2) të këtij neni, vërtetimin për vozitje provuese dhe për targë provuese e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose person juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve apo përmes personit juridik i cili merret me lëshimin e mjeteve transportues në treg.

(13) Në rastin nga paragrafi (3) të këtij neni, vërtetimi/met për vozitje provuese dhe për provë bartëse metalike targa e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme.

(14) Personi juridik i cili kryen kontroll teknik të automjetit dhe personi juridik i cili lëshon automjet në treg për kryerjen e punëve nga paragrafi (2) të këtij neni e autorizon Ministria e Punëve të Brendshme në kërkesë të tij.

(15) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet shoferit i cili drejton automjet motorik në komunikacionin rrugor në territorin e Republikës së Maqedonisë, pa poseduar vërtetim për vozitje provuese dhe tabela provuese.

(16) Personave të autorizuar të cilët kryejnë kontroll teknik të automjetit dhe personat juridik të cilët kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë në treg automjete nëse nuk veprojnë në pajtim me dispozitat nga paragrafët (2), (3), (4), (6), (7), (9), (11) dhe (14) të këtij neni, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej 2 000 euro në kundërvlerë me denarë.

(17) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (16) të këtij neni.

## **Neni 38-a**

### **Kushtet për marrjen e autorizimit për dhënien e vërtetimit për vozitje provë dhe tabela provë**

(1) Për marrjen e autorizimit nga neni 38 i këtij ligji, personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjetit dhe personi juridik i cili e lëshon në treg automjetin i plotëson këto kushte, të cilat kanë të bëjnë me:

- kushte përkatëse hapësinore,
- pajisje të nevojshme informative,
- evidencë për dhënien e vërtetimeve për vozitje provë dhe tabela provë

- kuadër përkatës profesional dhe
- sigurim nga përgjegjësia profesionale.

## **Neni 38-b**

### **Autorizimi dhe marrja e autorizimit për lëshimin e vërtetimit për vozitje provë dhe tabela provë**

(1) Personi i autorizuar për kryerjen e punëve teknike të automjetit dhe personi juridik i cili merret me lëshimin e automjeteve në treg janë të obliguar çdoherë t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara me dispozitat e neneve 38 dhe 38-a të këtij ligji.

(2) Ministri i Punëve të Brendshme me vendim do t'ia heqë autorizimin e personit juridik të autorizuar për kryerjen e kontrolleve teknike të automjeteve dhe personit juridik i cili lëshon automjete në treg, nëse pushon t'i plotësoj kushtet nga neni 38 dhe 38-a të këtij ligji.

## **Neni 39**

### **Shenjëzimi i automjeteve**

(1) Automjetet që janë regjistruar në shtet tjetër si dhe në Republikën e Maqedonisë, të cilat shfrytëzohen për qëllime protokollare në territorin e Republikës së Maqedonisë, shenjëzohen me targa të Republikës së Maqedonisë dhe për ato lëshohet leje qarkullimi për kohën e shfrytëzimit të tyre.

(2) Targa dhe leje qarkullimi për mjetet transportuese nga paragrafi (1) të këtij neni jep Ministria e Punëve të Brendshme.

(3) Pas skadimit të kohës së shfrytëzimit të mjeteve transportuese, leja e qarkullimit shfuqizohet kurse targa përsëri mund të përdoret për shenjëzimin e automjeteve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Nëse mjeti transportues nga paragrafi (1) të këtij neni, që shfrytëzohet në Republikën e Maqedonisë është i siguruar nga përgjegjësia automobilistike në shtetin në të cilin mjeti transportues është regjistruar, për mjetin transportues të njëjtë nuk kontraktohet sigurim i ri në Republikën e Maqedonisë.

## **Pjesa e pestë**

### **ÇREGJISTRIMI I MJETEVE TRANSPORTUES**

## **Neni 40**

### **Detyrimi për çregjistrim**

(1) Pronari i mjetit transportues të regjistruar duhet detyrimisht ta çregjistrojë mjetin transportues të tij tek organi i cili e ka regjistruar dhe me çregjistrimin brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e çregjistrimit, t'i kthejë targat, nëse:

1) mjeti transportues është shkatërruar, përkatësisht ka statusin e automjetit të shfrytëzuar, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit jetësor;

2) mjeti transportues për çdoherë është nxjerrë jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë;

3) mjeti transportues do të regjistrohet jashtë vendit për shkak të shpërnguljes së pronarit të mjetit transportues, përkatësisht për shkaqe të tjera;

4) mjeti transportues është vjedhur;

5) vlefshmëria e lejes së qarkullimit ka skaduar para më shumë se 30 ditësh, përkatësisht para më shumë se një viti për mopedë (biciklete me motor), motoçikleta, treçikleta të lehta, treçikleta, katërçikleta të lehta, katërçikleta, mjete transportuese për banim, rimorkio për banim dhe oldtajmerë.

6) brenda kohës së vlefshmërisë së lejes të qarkullimit ka pushuar të vlejë sigurimi i detyrueshëm.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni, pronari i mjetit transportues duhet detyrimisht vetëm ta çregjistrojë mjetin transportues të tij.

(3) Targat me shenja të njëjta nuk mund t'i jepen pronarit të automjetit, nëse kanë humbur, nëse automjeti është vjedhur ose nëse për atë janë dhënë targa me shenjë të përzgjedhur.

(4) Ministria e Punëve të Brendshme duhet detyrimisht t'i ruajë targat e kthyer një vjet nga dita e kthimit të tyre.

(5) Nëse në periudhën kohore nga paragrafi (4) të këtij neni, me targat e kthyer nuk është regjistruar mjeti transportues i njëjtë, ato targa asgjësohen.

(6) Nëse në rastin nga paragrafi (1) pika 5 të këtij neni, pronari nuk e çregjistron mjetin transportues të tij dhe nuk i kthen targat, Ministria e Punëve të Brendshme me shkrim e njofton pronarin e mjetit transportues, se brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit duhet detyrimisht t'i përmbushë obligimet e tij nga paragrafi (1) të këtij neni.

(7) Nëse pronari i mjetit transportues brenda afatit nga paragrafi (6) të këtij neni, nuk i përmbush obligimet e tij, Ministria e Punëve të Brendshme mjetin transportues e shlyen nga evidenca e mjeteve transportuese të regjistruara dhe ndërmerr masa për heqjen e targave si shpenzim në barrë të pronarit të mjetit transportues.

(8) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të mjetit transportues i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 të këtij neni.

(9) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të mjetit transportues i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 të këtij neni.

(11) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (10) i këtij neni.

(12) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni.

(13) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (12) i këtij neni.

## **Neni 41**

### **Detyrat e pronarit gjatë çregjistrimit të mjetit transportues**

(1) Pronari i mjetit transportues që ka status të mjetit transportues të shfrytëzuar, në përputhje me rregullat për mbrojtje të mjedisit jetësor, krahas obligimeve nga neni 40 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, gjatë çregjistrimit të mjetit transportues duhet detyrimisht të paraqesë vërtetim për kalimin e automjetit të shfrytëzuar për asgjësim.

(2) Pronari i mjetit transportues që nuk ka status të automjetit të shfrytëzuar, në përputhje me rregullat për mbrojtje të ambientit jetësor, gjatë çregjistrimit të mjetit transportues detyrimisht duhet të plotësojë deklaratë për lokacionin e vendndodhjes të mjetit transportues. Ministria e Punëve të Brendshme, deklaratën e dërgon në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Mjeti transportues i çregjistruar duhet të gjendet në lokacionin e cekur në deklaratën e këtij paragrafi.

(3) Gjobë në shumë prej 160 deri 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të mjetit transportues i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (4) i këtij neni.

## **KREU IV**

### **RREGULLSHMËRIA TEKNIKE E MJETEVE TRANSPORTUESE**

#### **Pjesa e parë**

#### **Dispozita të përgjithshme**

## **Neni 42**

### **Rregullshmëria teknike e mjeteve transportuese**

(1) Mjeti transportues në komunikacionin rrugor duhet teknikisht të jetë në rregull, që do të thotë se duhet të ketë sisteme në gjendje të rregullt, pjesë përbërëse, njësi teknike të pavarura dhe pajisje dhe t'i përmbushë kërkesat e përcaktuara nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor.

(2) Mjeti transportues që është regjistruar jashtë vendit mund të inkuadrohet në komunikacionin rrugor në territorin e Republikës së Maqedonisë nëse ka sisteme të rregullta, pjesë përbërëse, njësi të

pavarura teknike dhe pajisje që janë përcaktuar me Konventën e ratifikuar për komunikacionin rrugor.

(3) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit i cili në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni në komunikacionin rrugor, drejton mjet transportues që nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në aspekt të:

- instalimit për lidhjen e mjetit transportues tërheqës dhe mjetit transportues që lidhet;
- sistemit të drejtimit;
- sistemit të frenave dhe
- pneumatikëve.

(4) Gjobë në shumë prej 120 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit i cili në komunikacionin rrugor drejton mjet transportues që nuk ka sisteme të përcaktuara, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje, apo nëse të njëjtat nuk janë në rregull.

(5) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili në komunikacionin rrugor drejton automjet që nuk i përmbush kërkesat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje e bërë nga paragrafi (5) i këtij neni.

### **Neni 43**

#### **Instalimi i sistemeve të licencuara, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes**

(1) Në mjetin transportues mund të instalohen vetëm sisteme të licencuara, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje, nëse për të njëjtat nevojitet licencim në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligji tjetër, si dhe me rregullat e miratuara në bazë të tyre.

(2) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik i cili në mjetin transportues instalon sistem, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të automjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (4) i këtij neni.

### **Neni 44**

#### **Mjetet transportuese për dedikime të posaçme**

(1) Mjeti transportues për dedikime të posaçme sipas nenit 18 paragrafit (2) të këtij ligji, mund të inkuadrohet në komunikacionin rrugor, nëse është bërë, pajisur, shenjëzuar dhe kontrolluar dhe nëse për të njëjtin është lëshuar vërtetim i vlefshëm për përputhshmëri konform rregullave nga fusha e sigurisë dhe transportit në komunikacionin rrugor. Mjeti transportues për dedikime të posaçme duhet të jetë në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve të vlefshme ndërkombëtare për lloje të veçanta të transportit ndërkombëtar në komunikacionin rrugor.

(2) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 2.200 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (3) i këtij neni.

## **Neni 45**

### **Mjetet transportuese për transportin e një grupi fëmijësh**

(1) Grup fëmijësh lejohet të transportohet vetëm me mjet transportues i cili është shenjëzuar në mënyrë të rregullt dhe që i përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (3) i këtij neni.

## **Neni 46**

### **Pajisje e detyrueshme për automjetet motorike, biçikletat, traktorët dhe mjete mprehëse**

(1) Automjetet motorike, biçikletat, traktorët dhe mjetet mprehëse në komunikacionin rrugor duhet ta kenë pajisjen e detyrueshme në automjete, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni.

## **Neni 47**

### **Traktorë jashtë komunikacionit rrugor**

(1) Traktori që është jashtë komunikacionit rrugor i cili shfrytëzohet për kryerjen e punëve bujqësore, përkatësisht punëve pyjore, duhet të ketë sisteme të përcaktuara të rregullta, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje. Nëse në traktor janë instaluar rripa sigurie, shoferi dhe udhëtarët duhet të lidhen sipas rregullave.

(2) Në traktor mund të instalohen vetëm sisteme të licencuara, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje, nëse për të njëjtat nevojitet licencim në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të traktorit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë në denarë do t'u kumtohet për kundërvajtje udhëtarëve të cilët nuk lidhen sipas rregullave.

(6) Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik i cili në traktor instalon sisteme, pjesë përbërëse, njësi të pavarura teknike dhe pajisje në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (2) të këtij neni.

(8) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (7) i këtij neni.

## Neni 48

### Rregullat e ministrit të Punëve të Brendshme

(1) Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë rregulla më të afërta për:

- pajisje të detyrueshme të automjetit, biçikletës dhe karrocës për pjesëmarrje të sigurt në komunikacionin rrugor, si dhe për traktorë për kryerje të sigurt të punëve bujqësore përkatësisht pyjore në përputhje me nenin 46 dhe nenin 47 të këtij ligji;
- kërkesa të veçanta teknike të mjeteve transportuese me të cilat transportohen grupe fëmijësh në përputhje me nenin 45 të këtij ligji;
- kërkesat që duhet t'i përmbushin mjetet transportuese që të jenë teknikisht në rregull, si dhe për mënyrën dhe procedurën e kryerjes së kontrolleve teknike në përputhje me nenet 49 deri në 53 të këtij ligji;
- ndryshime e mjeteve transportuese që nuk do të thotë riparim dhe meremetim dhe mënyrën e evidentimit të tyre, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit për instalim në përputhje me nenin 54 dhe nenin 55 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën e kryerjes së kontrollit të rregullshmërisë teknike të automjeteve me të cilat bëhet transporti në komunikacionin rrugor në përputhje me nenin 44 të këtij ligji;
- kushtet më të afërta në aspekt të kushteve të lokaleve, kushteve materialo-teknike, kushteve të sigurisë dhe kushteve në aspektin e kuadrit në përputhje me nenin 54 paragrafin (5) të këtij ligji dhe

- mënyrën e procedurës për dhënien e provës në përputhje me nenin 52 paragrafin (3) të këtij ligji.

(2) Me rregullat nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të përcaktohet shfrytëzimi i detyrueshëm i specifikimeve teknike.

(3) Me rregullat nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të parashikohet shfrytëzimi i standardit, në përputhje me rregullat e standardizimit.

## **Pjesa e dytë**

# **KONTROLI TEKNIK**

## **Neni 49**

### **Kontrolli i rregullshmërisë teknike të mjeteve transportuese**

(1) Rregullshmëria teknike e mjeteve transportuese që marrin pjesë në komunikacionin rrugor konstatohet përmes kontrollit teknik që paraqet procedurë me të cilën personi juridik për kontrollin teknik i konstaton të dhënat në lidhje me mjetin transportues, sistemet e tij, pjesët përbërëse, njësitë e pavarura teknike dhe pajisjen, si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera për të njëjtat, të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me afatet për kryerjen e kontrolleve teknike, nuk zbatohen ndaj mjeteve transportuese të Armatës së Republikës së Maqedonisë, si dhe ndaj mjeteve transportuese që janë të inkuadruara në aktivitete të ushtrimeve dhe trajnimeve dhe në operacione humanitare dhe paqeruajtëse jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për mjetet transportuese nga paragrafi (2) të këtij neni, kontrolli teknik duhet të bëhet në afat prej 30 ditësh nga dita e kthimit të tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 50**

### **Llojet e kontrolleve teknike**

(1) Mjetet transportuese të inkuadruara në komunikacionin rrugor, me përjashtim të motokultivatorëve dhe makinave për mobile, detyrimisht kontrollohen në kontrollin e parë teknik dhe në kontrollet teknike periodike në përputhje me nenin 51 të këtij ligji.

(2) Mjetet transportuese duhet të kontrollohen në kontrolle të jashtëzakonshme teknike, dhe realizimi i kontrollit të tyre bëhet konform nenit 86 të këtij ligji. Kontrolli i jashtëzakonshëm i kryer teknik nuk ndikon mbi afatin e kryerjes së kontrolleve teknike periodike.

## **Neni 51**

### **Afatet për kryerjen e kontrolleve të rregullta teknike**

(1) Kontrolli i parë teknik kryhet:

1) Një vit pas regjistrimit të parë për:

- mjete transportuese për ngarkim dhe për tërheqës në rrugë;



- mjete transportuese për transportimin e materieve të rrezikshme;
  - autobusë;
  - mjete transportuese që lidhen, përveç për rimorkiot e lehta, rimorkiot e banimit dhe rimorkiot e traktorëve, si dhe për mjete të veçanta transportuese për transportimin e barkave, skuterëve ujqorë dhe mjeteve të tjera për sport dhe rekreacion masa më e lartë e përgjithshme e të cilave i tejkalon 750 kg. por nuk i tejkalon 3500kg;
  - mjete transportuese për transport publik të udhëtarëve;
  - mjete transportuese për transportin e një grupi fëmijësh;
  - mjete transportuese që përdoren për aftësimin e kandidatëve për shoferë dhe
  - mjete transportuese që janë pajisur si mjete transportuese me të drejtë përparësie për kalim, përkatësisht mjete transportuese për shoqërim.
- 2) dy vjet pas regjistrimit të parë për makina mobile, traktorë dhe automjetet me së paku katër rrota, të cilat shfrytëzohen për transportin e udhëtarëve me jo më shumë se tetë ulëse, me përjashtim të ulëses të shoferit dhe për të gjitha mjetet tjera transportuese;
- 3) katër vjet për rimorkio të lehta pas blerjes nga ana e pronarit të parë.

(2) Kontrollat teknike periodike të mjetit transportues bëhen së paku një herë në vit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, kontrollat teknike periodike kryhen çdo gjashtë muaj për:

- mjetet transportuese për transport publik të udhëtarëve;
- autobusë;
- mjetet transportuese që përdoren për aftësimin e kandidatëve për shoferë;
- mjetet transportuese që përdoren për transportimin e një grupi fëmijësh;
- mjetet transportuese që janë pajisur si mjete transportuese me të drejtë përparësie kalimi, përkatësisht mjete transportuese për shoqërim, përveç mjeteve transportuese që përdoren nga shërbimet zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve, që për nga forma dhe dedikimi janë mjete transportuese për shuarjen e zjarreve;
- mjetet transportuese për dhënie me qira (rent-a-kar) dhe;
- mjetet transportuese për transportimin e materieve të rrezikshme.

Mjetet transportuese që përdoren për dedikimet e cekura nga ky paragraf duhet në lejen e qarkullimit ta kenë të shënuar dedikimin, përkatësisht formën e karrocërisë.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni, kontrolli teknik periodik i mjeteve transportuese nga paragrafi (1) pika (2) të këtij neni për të cilat nga regjistrimi i parë nuk kanë kaluar tetë vjet, duhet të bëhet në çdo dy vjet.

(5) Rimorkio të lehta, rimorkio për banim dhe mjete të veçanta transportuese që lidhen për transportimin e barkave, skuterëve ujqorë dhe pajisjes tjetër për sport dhe rekreacion masa më e lartë e përgjithshme e të cilave është mbi 750 kg. por që nuk i tejkalon 3.500 kg edhe rimorkio të traktorit shuma e ngarkimeve të boshtit të lejuara teknike është mbi 1.500 kg, duhet të jenë teknikisht të kontrolluara në çdo katër vjet.

(6) Për veturat që janë regjistruar jashtë vendit, kontrolli i parë teknik bëhet para regjistrimit të parë në Republikën e Maqedonisë, kurse kontrollat teknike periodike bëhen në përputhje me paragrafët prej 2 deri në 5 të këtij neni, duke llogaritur prej regjistrimit të parë jashtë vendit.

(7) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet pronarit të automjetit motorik, i cili vepron në kundërshtim me

dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni.

## **Neni 52**

### **Kryerja e kontrollit teknik**

(1) Kontrolli teknik i mjeteve transportuese bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe udhëzimeve të prodhuesit të instalimeve dhe pajisjes që përdoren gjatë kontrolleve teknike.

(2) Nëse në kontrollet teknike është konstatuar se mjete transportues teknikisht është në rregull, lëshohet dokument me shkrim në të cilin shënohet afati kur mjete transportues duhet ta bëjë kontrollin e ardhshëm teknik.

## **Neni 52-a**

### **Përcaktimi i shenjave të identifikimit**

(1) Për automjetet e regjistruara në Republikën e Maqedonisë, të cilat për çfarëdo qoftë arsyesh shenja e identifikimit në kornizën e automjetit (shasisë) ose shenja e identifikimit të motorit të automjetit janë të dëmtuara/të palexueshme, dhe kjo është verifikuar gjatë kryerjes së kontrollin teknik, personi juridik për kryerje të kontrollit teknik e njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(2) Në bazë të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Ministria e Punëve të Brendshme kryen inspektim të automjetit, i përcakton shenjat e vërteta të identifikimit të automjetit dhe lëshon udhëzim për shtypjen e tyre.

(3) Nëse në bazë të inspektimit të kryer, Ministria e Punëve të Brendshme përcakton se automjeti është lëndë e procedurës për kundërvajtje apo penale, ai konfiskohet.

(4) Shtypja e shenjës së identifikimit të automjetit (shastisë) ose vendosja e shenjës së identifikimit të motorit të automjetit, bëhet në bazë të udhëzimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në shërbim teknik të autorizuar për shtypjen e shenjave të identifikimit.

## **Neni 53**

### **Konstatimi i riparimit ose meremetimit**

(1) Nëse gjatë kontrollit teknik të mjetit transportues konstatohet riparim ose meremetim të mjetit transportues për shkak të të cilit të dhënat në lejen e qarkullimit dhe në regjistrin e të dhënave në lidhje me mjetet transportuese nuk përputhen me gjendjen e konstatuar të mjetit transportues mund të lëshohet dokument me shkrim për kontrollin e bërë teknik vetëm në bazë të procedurës së realizuar plotësisht për pëlqim të veçantë në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, përkatësisht me regjistrimin përkatës në vërtetimin për përputhshmëri.

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik për kontroll teknik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik për kontroll teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për

kontroll teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (2) i këtij neni.

## **Pjesa e tretë**

# **NDRYSHIMET E MJETEVE TRANSPORTUESE**

## **Neni 54**

### **Ndryshimet e evidentuara të mjetit transportues**

(1) Pronari i mjetit transportues detyrimisht duhet të kërkojë që ndryshimet e mjetit transportues të cilat janë bërë me pëlqimin e tij, kurse nuk paraqesin riparime dhe meremetime në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, të evidentohen pranë shërbimit teknik, në afat prej 15 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

(2) Ndryshimet nga paragrafi (1) të këtij neni, kanë të bëjnë me instalimin e sistemeve të veçanta, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes që janë të ndryshme prej sistemeve të instaluar bazike, kurse të njëjtat janë licencuar për t'u instaluar në tipin konkret (variantin, ose modelin) të mjetit transportues, siç janë:

- sisteme për nxjerrjen e gazrave,
- pajisje përtërheqjen e mjeteve transportuese, masa më e lartë e të cilave nuk i tejkalon 3.500 kg, me përjashtim të traktorëve;
- bashkues dhe
- trupa ndriçues etj.

(3) Instalimin e sistemeve të veçanta, pjesëve përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes nga paragrafi (2) të këtij neni, e bën personi fizik ose juridik që është regjistruar për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve transportuese, për të cilën gjë jep vërtetim për instalim.

(4) Instalimin e pajisjes për motorë me gaz të lëngshëm nafte, me gaz tokësor të kompresuar, ose pajisjes tjetër konform dispozitave të këtij ligji, e bën personi juridik ose fizik i cili është autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

(5) Autorizimi nga paragrafi (4) të këtij neni, i jepet personit juridik ose fizik i cili posedon autorizim nga prodhuesi i instalimeve ose pajisjes që e instalon, i cili i përmbush kushtet hapësinore, materialo-teknike, kushtet e sigurisë, si dhe kushtet sa i përket kuadrit për vendosjen e instalimit dhe pajisjes plotësuese të mjetit transportues.

(6) Nëse personi i autorizuar për instalimin e pajisjes për motor me gaz të lëngshëm nafte, përkatësisht me gaz tokësor të kompresuar, ose instalim tjetër dhe pajisje plotësuese, nuk i përmbush punët e besuara në përputhje me ligj, ose e ndërpret përmbushjen e kushteve nga paragrafi (5) të këtij neni, ministri Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia ndalojë kryerjen e punëve dhe do të përcaktojë afat prej 30 ditësh për shmangien e mangësive të konstatuara.

(7) Nëse personi i autorizuar nuk i shmang mangësitë e konstatuara nga paragrafi (7) të këtij neni, ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë autorizimin.

(8) Aktvendimi nga paragrafi (7) të këtij neni është i formës së prerë dhe kundër të njëjtit mund të hapet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(9) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje pronarit të mjetit transportues i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 800 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik pronar i mjetit transportues i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni.

(11) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (10) i këtij neni.

(12) Gjobë në shumë prej 480 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik ose juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (4) të këtij neni.

## **Neni 55**

### **Ndryshime të paevidentuara të mjetit transportues**

(1) Për ndryshimet e mjetit transportues, që nuk kanë ndikim më të madh mbi sigurinë e komunikacionit rrugor, përkatësisht mbi mjedisin jetësor dhe në mënyrë të drejtë dhe të lehtë mund të bëhen para fillimit të shfrytëzimit të mjeteve transportuese, pronari i mjetit transportues nuk e ka për obligim që të kërkojë evidentimin e tyre.

(2) Ndryshimet nga paragrafi (1) të këtij neni, kanë të bëjnë me instalimin e pajisjes për vendosjen e bagazhit, antenave, elementeve dekorative etj.

## **KREU V**

### **KUSHTET PËR KRYERJEN E PUNËVE**

#### **Pjesa e parë**

### **SHËRBIMI TEKNIK**

## **Neni 56**

### **Autorizimi**

(1) Punët e shërbimeve teknike i kryejnë persona juridikë të cilët janë të autorizuar me aktvendim nga ministri i Ekonomisë, me propozim të organit për autorizim, dhe në bazë të akreditimit nga organi për vlerësimin e kompetencës.

(2) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, për marrje të autorizimit paraqet kërkesë në organin për lejim, i cili në afat prej 15 ditësh nga marrja e kërkesës dorëzon propozim te ministri i Ekonomisë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni dhe dokumentacionin përcjellës e përcakton ministri i Ekonomisë.

(4) Nëse propozimi i organit për lejim është negativ, ministri i Ekonomisë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit miraton aktvendim me të cilin e refuzon kërkesën e personit juridik për shërbim teknik.

(5) Nëse propozimi i organit për lejim është pozitiv, ministri i Ekonomisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit miraton aktvendim për autorizimin e personit juridik për shërbim teknik.

(6) Nëse ministri i Ekonomisë nuk merr aktvendim në afat nga nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, personi juridik ka të drejtë në afat prej tri ditësh punë nga kalimi i këtij afati, të parashtroje kërkesë të sekretaria e ministrit, për marrjen e aktvendimit për kërkesën e parashtruar.

(7) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni, e përcakton ministri i Ekonomisë.

(8) Ministri i Ekonomisë është i detyruar që të miratojë aktvendim më së voni në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni, me të cilin do ta pranojë ose ta refuzojë kërkesën.

(9) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(10) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, të kryeje mbikëqyrje në organin kompetent nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(11) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligj miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin e Ekonomisë që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(12) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos në afatin nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës, në të cilin funksionari i cili udhëheq organin do të vendosë mbi kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(13) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos as në afatin shtesë nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(14) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(15) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditëve të punës ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (14) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit

të parashtruesit të kërkesës në përputhje me paragrafët (9) dhe (10) dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhje me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, për inspektorin dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(16) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin shtesë nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(17) Në rastin nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite punë, do të autorizojë tjetër inspektor që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(18) Në rastet nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(19) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin (15) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(20) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në Gjykatën Administrative.

(21) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(22) Gjobë në shumë prej 3.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili kryen punë të shërbimit teknik pa autorizim nga paragrafi (1) të këtij neni.

(23) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (22) i këtij neni.

## Neni 56-a

(1) Me përjashtim nga neni 56 paragrafi (1) i këtij ligji, për automjetet për transport të materieve të rrezikshme, punët e shërbimeve teknike i kryejnë persona juridikë që kryejnë lejim individual të automjeteve, që janë të autorizuar me aktvendim të ministrit të Punëve të Brendshme, e në bazë të akreditimit nga organi për vlerësim të kompetencës.

(2) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni për marrjen e autorizimit paraqet kërkesë të ministri i Punëve të Brendshme.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni dhe dokumentacionin përcjellës e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(4) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga personi juridik.

(5) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk miraton aktvendim për autorizim, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për miratim të aktvendimit për autorizim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i atij afati, të paraqesë kërkesë në sekretarinë e ministrit të Punëve të Brendshme për miratim të aktvendimit nga ministri i Punëve të Brendshme.

(6) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni, i përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(7) Ministri i Punëve të Brendshme është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni, në sekretarinë e ministrit të Punëve të Brendshme, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për miratim të aktvendimit pranohet apo refuzohet. Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(8) Me kërkesën për miratim të aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon edhe kopje të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni.

(9) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh punë.

(10) Inspektori është i detyruar që në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje inspektuese në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të përcaktojë nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(11) Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligj miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin e Punëve të Brendshme që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta pranojë apo refuzojë kërkesën dhe për masat e ndërmarra në afatin e njëjtë ta njoftojë inspektorin dhe t'i dorëzojë ekzemplar të aktit me të cilin është vendosur për kërkesën.

(12) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos në afatin nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri i Punëve të Brendshme do të vendosë mbi kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(13) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos as në afatin shtesë nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(14) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (10) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(15) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (14) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës nga paragrafi (9) i këtij neni, ose nuk ka paraqitur kallëzim në përputhje me paragrafin (13) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për inspektorin dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Ministrinë e Punëve të Brendshme nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(16) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin shtesë nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(17) Në rastin nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite punë, do të autorizojë tjetër inspektor që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(18) Në rast nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(19) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin (15) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(20) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(21) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(22) Gjobë në shumë prej 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që kryen punë të shërbimit teknik pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(23) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik që kryen punë të shërbimit teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik që kryen punë të shërbimit teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (22) i këtij neni.

## **Neni 57**

### **Punët që i kryen shërbimi teknik**

(1) Shërbimi teknik autorizohet veçanërisht për kryerjen e punëve si vijojnë:

- analiza, kontrolle dhe aktivitete certifikimi në lidhje me procedurën për licencimin e tipit të mjetit transportues;
- analiza, kontrolle dhe aktivitete certifikimi në lidhje me procedurën për licencimin e tipit të sistemit, pjesës përbërëse, njësive të pavarura teknike dhe pajisjes;
- përcaktimi i përmbushjes të kërkesave teknike në procedurën për licencimin e veçantë të mjetit transportues në përputhje me kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij



ligji;

- përcaktimi i përmbushjes të kërkesave teknike në procedurën për dhe automjetit për dedikim të veçante në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji,
- shtypje të shenjave të identifikimit dhe
- licencim të mjeteve transportuese të riparuar ose meremetuara në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, si dhe evidentimin e ndryshimeve në përputhje me nenin 54 të këtij ligji.

(2) Personi juridik paraqet kërkesë autorizimi për kryerjen e një ose me shumë punëve nga njëra apo më shumë alineve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Shërbimi teknik i kryen ose i kontrollon analizat e nevojshme për licencimin e tipit, i bën kontrollimet e nevojshme, i zbaton procedurat në përputhje me specifikimet e nevojshme dhe vepron në përputhje me kërkesat alternative.

(4) Shërbimi teknik kryen edhe detyra të identifikimit dhe identifikimin e vlerësimit e gjendjes teknike të mjeteve transportuese për të cilat është i autorizuar si shërbim teknik në përputhje me paragrafin (1) alinetë 1, 3 dhe 4 të këtij neni.

## Neni 58

### Kategoritë e shërbimeve teknike

(1) Shërbimet teknike që kryejnë aktivitete të lidhura me lejimin e tipit, që realizohen në pajtim me aktet rregulluese, mund të jenë nga kategoritë si vijojnë:

- kategoria A, që kryejnë inspektime në lokalet e veta. Shërbimi teknik i kategorisë A mund të kryejë aktivitete, apo të mbikëqyrë inspektime, në pajtim me aktet rregulluese për të cilat është i autorizuar, edhe në lokalet e prodhuesit apo të personave të tretë.
- kategoria B që kryejnë inspektime në lokalet e prodhuesit apo të personave të tretë.

(2) Shërbimet teknike që kryejnë aktivitete të lidhura me përshtatshmërinë e prodhimit, mund të jenë nga kategoritë si vijojnë:

- kategoria C që kryejnë vlerësim dhe mbikëqyrje fillestare të sistemit për kualitetin e prodhimit,
- kategoria D që kryejnë inspektim apo testim të njësisë së prodhimit, apo kryejnë mbikëqyrje.

(3) Shërbimet teknike që kryejnë aktivitete për lejim individual të automjetit dhe automjetit për dedikim të veçantë, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe për aktivitetet e lejimit të rikonstruktiveve dhe riparimeve, në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, akreditohen sipas kushteve të përcaktuara në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji.

## Neni 59

### Kushtet për autorizim

(1) Për marrjen e autorizimit si shërbim teknik, personi juridik për çdo objekt në të cilin kryen kontroll duhet t'i plotësojë kushtet përkatëse në aspektin e lokalit, pajisjes dhe kuadrove dhe obligohet të ketë aftësi përkatëse, njohuri teknike të veçanta dhe përvojë të dëshmuar në sfera të

veçanta, sipas dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Procedura për akreditimin e shërbimit teknik nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet nga ana e organit për vlerësimin e kompetencës.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, shërbimi teknik që kryen punë të fazës së fundit nga lejimi në shumë faza të tipit dhe lejimit individual, akreditohet sipas nenit 58 paragrafi (3) i këtij ligji.

## Neni 60

### Autorizimi dhe heqja e autorizimit

(1) Shërbimi teknik i autorizuar obligohet që në mënyrë të përhershme t'i plotësojë kushtet për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Me propozimin e organit për lejim, ministri i Ekonomisë me aktvendim mund t'ia heqë autorizimin shërbimit teknik, nëse:

- ka pushuar që t'i plotësojë kushtet e caktuara për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.
- kundër tij është ngritur procedura e falimentimit apo likuidimit;
- ka pushuar që të punojë në bazë të aktvendimit gjyqësor dhe
- punët e veta nuk i kryen në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (2) i këtij neni është përfundimtar, dhe kundër tij nuk mund të ngritet kontest administrativ, para gjykatës kompetente.

(4) Secilin shërbim të autorizuar teknik, Ministria e Ekonomisë e nostrifikon në Komisionin Evropian me: emrin, selinë, adresën elektronike, emrin e personit përgjegjës dhe kategorinë e punëve që i kryen, si dhe për të gjitha ndryshimet e atyre të dhënave.

## Neni 61

### Rregullat e ministrit të Ekonomisë

(1) Ministri i Ekonomisë më afërsisht, i përcakton:

- kushtet e lokalit, pajisjen, aparatet dhe kuadrot për shërbimet teknike, në pajtim me nenin 59 të këtij ligji;
- procedurat për kryerjen e punëve të shërbimeve teknike, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji dhe
- mënyrën dhe procedurën për miratimin dhe heqjen e aktvendimit për autorizim të shërbimeve teknike, në pajtim me nenin 56 të këtij ligji.

(2) Me rregullën nga paragrafi (1) alineja 2 e këtij neni, mund të përcaktohet shfrytëzimi i detyrueshëm i specifikimeve teknike.

## Pjesa e dytë

# PERSONI JURIDIK PËR KONTROLL TEKNIK

## Neni 62

## Autorizimi i ministrit të Ekonomisë

(1) Punët e identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike mund t'i kryejnë persona juridike për kontroll teknik, të cilët janë të autorizuar me aktvendim të ministrit të Ekonomisë.

(2) Për marrjen e autorizimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik parashtron kërkesë në Ministrinë e Ekonomisë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton ministri i Ekonomisë.

(4) Personi juridik për kontroll teknik nuk mund të kryejë identifikim dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjeteve të veta.

(5) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga personi juridik për kontroll teknik.

(6) Nëse ministri i Ekonomisë nuk miraton aktvendim për autorizim, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi (5) i këtij neni, personi juridik për kontroll teknik ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i atij afati, të parashtojë kërkesë në sekretarinë e ministrit të Ekonomisë, për miratimin e aktvendimit për kërkesën e parashtruar.

(7) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni e përcakton ministri i Ekonomisë.

(8) Ministri i Ekonomisë është i detyruar që të miratojë aktvendim më së voni në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës, me të cilin do ta pranojë ose refuzojë kërkesën.

(9) Nëse ministri i Ekonomisë nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(10) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në Ministrinë e Ekonomisë nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(11) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligj miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin e Ekonomisë që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(12) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos në afatin nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri i Ekonomisë do të vendosë mbi kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos as në afatin shtesë nga paragrafi (12) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(14) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrorë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrorë në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(15) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditëve të punës ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (14) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës në përputhje me paragrafët (9) dhe (10), dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhje me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, për inspektorin dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(16) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin shtesë nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim të prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(17) Në rastin nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizojë tjetër inspektor që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(18) Në rastet nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(19) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin (15) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(20) Nëse ministri i Ekonomisë nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

(21) Procedura në Gjykatën kompetente është urgjente.

(22) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(23) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (22) i këtij neni.

(24) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (5) i këtij neni.

(25) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (24) i këtij neni.

## Neni 62-a

### Autorizimi i ministrit të Punëve të Brendshme

(1) Punët e kontroleve teknike mund t'i kryejnë persona juridikë të cilët kanë marrë autorizim nga ministri i Punëve të Brendshme.

(2) Për marrjen e autorizimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik parashtron kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(4) Personi juridik për kontroll teknik nuk mund të kryejë kontroll teknik të automjeteve të veta.

(5) Autorizimi nga paragrafi (1) i këtij neni, jepet në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga personi juridik.

(6) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk e jep autorizimin, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e autorizimit në afatin nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga kalimi i atij afati, të parashtojë kërkesë në sekretarinë e ministrit të Punëve të Brendshme, për miratimin e aktvendimit nga ministri i Punëve të Brendshme.

(7) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(8) Ministri i Punëve të Brendshme është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni në sekretarinë e ministrit të Punëve të Brendshme, të miratojë aktvendim me të cilin do ta pranojë ose refuzojë kërkesën për dhënie të autorizimit. Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(9) Me kërkesën për miratimin e aktvendimit nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon edhe kopje të kërkesës për dhënie të autorizimit.

(10) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(11) Inspektori detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (10) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje inspektuese në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të konstatojë nëse procedura është zbatuar në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(12) Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin e Punëve të Brendshme që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe për masat e ndërmarra në afatin e njëjtë ta njoftojë inspektorin dhe t'i dorëzojë ekzemplar të aktit me të cilin është vendosur për kërkesën.

(13) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos në afatin nga paragrafi (12) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri i Punëve të Brendshme do të vendosë mbi kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(14) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (13) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune, do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(16) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (15) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës nga paragrafi (10) i këtij neni, ose nuk ka paraqitur kallëzim në përputhje me paragrafin (14) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për inspektorin dhe do të caktojë afat shtesë prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Ministrinë e Punëve të Brendshme nëse procedura është zbatuar në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(17) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(18) Në rastin nga paragrafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite punë, do të autorizojë tjetër inspektor që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(19) Në rastin nga paragrafi (18) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(20) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhje me paragrafin (16) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(21) Nëse ministri i Punëve të Brendshme nuk vendos në afatin nga paragrafi (14) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

(22) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(23) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(24) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi i autorizuar juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (23) i këtij neni.

(25) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (5) i këtij neni.

(26) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi i autorizuar juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (25) i këtij neni.

## **Neni 63**

### **Punët e personit juridik për kontroll teknik**

1) Personi juridik për kontroll teknik, autorizohet për kryerjen e njërës apo më tepër punëve, si vijojnë:

- identifikimin e automjeteve;
- identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve;
- kontrollin e automjeteve me kërkesa të veçanta dhe
- kontrole teknike të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

(2) Autorizimi për kontroll teknik të automjetit, lëshohet së paku për një grup kategorish të automjeteve. Autorizimi për identifikimin dhe identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve, lëshohet vetëm në kuadër të autorizimit për kontroll teknik të automjeteve.

## **Neni 64**

### **Kushtet për marrjen e autorizimit**

Për marrjen e autorizimit nga neni 63 i këtij ligji, personi juridik duhet t'i plotësojë kushtet që kanë të bëjnë me:

- kuadrin përkatës profesional, pajisjen e nevojshme, aparatet dhe lokalet dhe
- sigurimin nga përgjegjësia profesionale.

## **Neni 65**

### **Autorizimi dhe heqja e autorizimit**

(1) Personi juridik i autorizuar obligohet që në mënyrë të përhershme t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Ministri i Punëve të Brendshme, mundet që personit juridik për kontroll teknik me aktvendim t'ia heqë autorizimin për kryerjen e kontrollit teknik, përkatësisht ministri i Ekonomisë mundet personit juridik për kontroll teknik me aktvendim t'ia heqë autorizimin për kryerjen e identifikimit dhe

identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike, nëse:

- ka pushuar t'i plotësojë kushtet e përcaktuara për kryerjen e punëve të përcaktuara, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
- detyrimet e rregulluara nga neni 31 paragrafi (2) alineja 6 të këtij ligji, nuk i paguan në llogari pagesore të institucioneve përkatëse
- në bazë ditore nuk i fut të gjitha të dhënat në softuerin elektronik të përcaktuar në nenin 73-a të këtij ligji,
- kundër tij është ngritur procedura e falimentimit apo likuidimit;
- ka pushuar që të punojë në bazë të aktvendimit gjyqësor dhe
- punët e veta nuk i kryen në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Nëse personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme përcakton se personi juridik për kontroll teknik nuk i plotëson kushtet në lidhje me kushtet hapësinore, pajisjen, mjetet, kuadrin e nevojshëm si dhe evidencat të cilat mbahen te personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik, do të përpilojë procesverbal dhe me aktvendim do t'i ndalojë të ushtrojë kontroll teknik të automjeteve, në të cilin do të përcaktojë afat prej 30 ditësh në të cilin personi juridik duhet t'i mënjanojë mangësitë e vërejtura.

(4) Nëse personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik nuk i mënjanon mangësitë e përcaktuara në afatin e paraparë nga paragrafi (3) i këtij neni, ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim ia heq autorizimin për kryerje të kontrolleve teknike të automjeteve personit të autorizuar juridik.

(5) Nëse personit juridik të autorizuar për kryerje të kontrollit teknik, i është hequr autorizimi për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve, i hiqet edhe autorizimi për kryerjen e identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve.

(6) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik të autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik për kontroll teknik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kontroll teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (4) i këtij neni.

(7) Aktvendimi nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet kontest para gjykatës administrative. **4**

## Neni 66

### Dhënia e provimit dhe përtëritja e diturisë

(1) Kandidatët për kryerjen e punëve të kontrollit teknik te personat juridikë për kontroll teknik, duhet ta japin provimin profesional për aftësi. Provimi profesional jepet para komisionit të formuar nga ministri i Punëve të Brendshme, që përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Kandidatit që do ta japë me sukses provimin profesional, komisioni i lëshon certifikatë për provimin e dhënë.

(2) Kandidatët për kryerjen e punëve te personat juridikë për kontroll teknik, që kryejnë identifikimin dhe vlerësimin dhe gjendjes teknike të automjeteve, duhet ta japin provimin profesional për aftësi. Provimi profesional jepet para komisionit të formuar nga ministri i



Ekonomisë, që përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Kandidatit që do ta japë me sukses provimin profesional, komisioni i lëshon vërtetim për provimin e dhënë.

(3) Në bazë të certifikatës për provim të dhënë profesional të këtij neni Ministria e Punëve të Brendshme u lëshon licencë për punë punëtorëve profesionale.

(4) Për lëshimin e licencës për punë punëtorët profesionale paguajnë kompensim për shpenzime për lëshim të licencës në lartësi të shpenzimeve të bëra reale për lëshimin e saj.

(5) Afati i vlefshmërisë së licencës për punë të punëtorëve profesionale është katër vjet.

(6) Formën, përmbajtjen, mënyrën e lëshimit të licencës dhe lartësinë e shpenzimeve për lëshimin e licencës i përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(7) Punëtorët profesionalë nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, duhet ta përtërijnë diturinë e vet në çdo katër vite, nga dita e lëshimit të certifikata për provimin e dhënë.

(8) Kandidati që nuk e ka dhënë provimin do të dërgohet përsëri për dhënien e provimit, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së rezultateve të provimit.

(9) Në periudhën deri në dhënien e përsëritur të provimit profesional, kandidati nuk ka të drejtë që të kryejë punë për të cilat nevojitet provimi profesional.

(10) Shpenzimet për dhënien e provimit profesional, janë në llogari të kërkuesit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

## Neni 66-a

(1) Provim profesional nga nenin 66 paragrafi (1) të këtij ligji mund të japë person i cili i plotëson këto kushte:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë,
- të ketë të mbaruar arsimin specialistik për kontrollor për kontroll teknik të automjeteve,
- të ketë të mbaruar fakultetin e makinerisë, fakultetin e komunikacionit apo fakultetin elektroteknik dhe të ketë stazh pune prej së paku gjashtë muaj nga sfera e automjeteve motorike apo të ketë të mbaruar shkollën e mesme teknike në drejtimin e makinerisë, komunikacionit apo elektroteknikës dhe stazh pune prej së paku dymbëdhjetë muaj nga sfera e automjeteve motorike dhe
- të ketë patentë shoferi për drejtimin e automjetit së paku të kategorisë "B".

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, personat që kanë mbaruar fakultetin e makinerisë, fakultetin e komunikacionit apo fakultetin elektroteknik nuk duhet ta plotësojnë kushtin nga alineja 3.

(3) Personi i autorizuar juridik për kontroll teknik të automjeteve për çdo stacion për kontroll teknik të automjeteve, duhet të ketë kuadër përkatës profesionaludhëheqës dhe dy persona profesionalë për kryerje të kontrollit teknik të automjeteve.

(4) Në rast të pengesës objektive për kryerjen e detyrave të rregullta të punës, personi profesional për kryerje të kontrollit teknik zëvendësohet nga ana e udhëheqësit që i plotëson kushtet për person profesional për kryerje të kontrollit teknik, dhe i cili është i punësuar në stacionin për kontroll teknik por jo më shumë se tridhjetë ditë pune gjatë një viti kalendarik.

(5) Provimi nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, përbëhet prej pjesës teorike, me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve, jepet me shkrim në mënyrë elektronike, me përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(6) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit nga paragrafi (1) i këtij neni i përpilojnë profesorë universitarë nga sfera e automjeteve dhe persona me së paku dhjetë vite përvojë pune në sferën e automjeteve, në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) të këtij ligji,

(7) Pyetjet e provimit i verifikon Komisioni për dhënien e provimit profesional nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, e njëherit kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve së paku dy herë në vit.

(8) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit profesional nga paragrafi (1) i këtij neni, i kryen Ministria e Punëve të Brendshme, për çka ministri i punëve të Brendshme cakton person përgjegjës i cili përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënie të provimit, ndërsa provimin teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror, i zgjedhur nga ministri i Punëve të Brendshme.

(9) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve, Komisioni vendos më së paku 30% të pyetjeve të ndryshohen ose plotësisht të mënjanohen, apo të zëvendësohen me të reja nga bazat nga paragrafi (6) të këtij neni.

(10) Gjatë revizionit, Komisioni nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, veçanërisht i ka parasysh ndryshimet e rregullave juridike në të cilat bazohen pyetjet, numrin e kandidatëve të cilët i janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kritere tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazës nga paragrafi (3) i këtij neni.

(11) Anëtarët e Komisionit për Verifikim, në pajtim me nenin 66 paragrafi (1) i këtij ligji, kanë të drejtë kompensimi me para që e përcakton ministri i Punëve të Brendshme dhe i njëjti caktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara, si dhe nga ndërlikueshmëria e materies.

(12) Kompensimi vjetor në para nuk e tejkalon shumën e tri rrogave mesatare mujore të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës.

(13) Me gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi nga paragrafi (8) të këtij neni i cili do të lejojë të japë provim kandidat i cili nuk i plotëson kushtet të përcaktuara të këtij ligji.

(14) Personit përgjegjës nga paragrafi (8) të këtij neni për çdo sesion të mbajtur të provimeve i takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Ministria e Punëve të Brendshme miraton aktvendim.

## Neni 66-b

Provimi profesional nga neni 66 paragrafi (2) të këtij ligji mund të japë personi që i përmbush kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë,
- të ketë të mbaruar fakultetin e makinerisë, fakultetin e komunikacionit apo fakultetin elektroteknik dhe të ketë stazh pune prej së paku gjashtë muaj nga sfera e automjeteve motorike apo të ketë të mbaruar shkollën e mesme teknike në drejtimin e makinerisë, komunikacionit apo elektroteknikës dhe stazh pune prej së paku dymbëdhjetë muaj nga sfera e automjeteve motorike.

(2) Provimi nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, përbëhet prej dy pjesëve si vijon:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve, jepet me shkrim në mënyrë elektronike, me përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter dhe
- pjesa e dytë (pjesa praktike), ku kandidatëve që e kanë dhënë pjesën e parë (pjesën teorike) të provimit u kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve për automjetin për çfarë duhet të përpilohet pëlqim për regjistrim ose letër për refuzim.

(3) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit nga paragrafi (1) i këtij neni i përpilojnë profesorë universitarë nga sfera e automjeteve dhe persona me së paku dhjetë vite përvojë pune në sferën e automjeteve, në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) i këtij ligji,

(4) Pyetjet e provimit i verifikon Komisioni për dhënien e provimit profesional nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, e njëherit kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve së paku dy herë në vit.

(5) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit profesional nga paragrafi (1) i këtij neni i kryen Ministria e Ekonomisë, për çka ministri i Ekonomisë cakton person përgjegjës i cili përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit, ndërsa provimin teknikisht e realizon personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror, i zgjedhur nga Ministria e Ekonomisë.

(6) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnim të bazave të pyetjeve, Komisioni vendos më së paku 30% të pyetjeve të ndryshohen ose plotësisht të mënjahohen, zëvendësohen me të reja nga bazat nga paragrafi (3) të këtij neni.

(7) Gjatë revizionit, Komisioni nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, veçanërisht i ka parasysh ndryshimet e rregullave në të cilat bazohen pyetjet, numrin e kandidatëve që u janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kritere tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazës nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Anëtarët e Komisionit për Verifikim, në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) i këtij ligji, kanë të drejtë kompensimi në para, që e përcakton ministri i ekonomisë dhe i njëjti caktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara, si dhe ndërlikueshmërisë së materies.

(9) Kompensimi vjetor në para nuk e tejkalon shumën e tri rrogave mujore mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës.

(10) Me gjobë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet personi nga paragrafi (5) të këtij neni i cili do të lejojë provimin

ta japë provim kandidat i cili nuk i plotëson kushtet të përcaktuara të këtij ligji.

(11) Personit përgjegjës nga paragrafi (5) të këtij neni për çdo sesion të mbajtur të provimeve i takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Ministria e Ekonomisë miraton aktvendim.

## Neni 66-v

(1) Kandidatit i mundësohet që të fillojë ta japë provimin në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënie të provimit.

(2) Provimi jepet në lokal për dhënien e provimit, të pajisur veçanërisht për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizimin e dhënies.

(3) Kandidatët të cilëve u është lejuar kërkesë për dhënie të provimit dhe publiku informohen për datën dhe kohën e dhënies së provimit nëpërmjet ueb faqes së Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Servisit publik radiodifuziv.

(4) Kandidatët të cilëve u është lejuar kërkesë për dhënie të provimit dhe publiku informohen për datën dhe kohën e dhënies së provimit nëpërmjet ueb faqes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Servisit publik radiodifuziv.

(5) Dhënia e provimit nga paragrafi (1) i nenit 66 të këtij ligji incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(6) Dhënia e provimit nga paragrafi (2) i nenit 66 të këtij ligji incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë.

(7) Personi juridik që e realizon provimin profesional, duhet t'i përmbushë kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale teknike dhe informatike në lokalet për dhënien e provimit profesional, kushte të cilat më afërsisht i përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(8) Kriteret në lidhje me kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale teknike dhe informatike të lokaleve për dhënien e provimit profesional, i përcakton ministri i Ekonomisë.

(9) Në lokalin për dhënien e provimit nga neni 66 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, gjatë dhënies së provimit janë të pranishëm dy përfaqësues nga komisioni për dhënien e provimit, një përfaqësues nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (informatikanë) dhe një përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Zyrës së Kryetarit të Qeverisë.

(10) Anëtarëve të Komisionit për dhënie të provimit nga paragrafi (9) të këtij neni për çdo sesion të mbajtur të provimeve nga neni 66 paragrafi (1) të këtij ligji u takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Ministria e Punëve të Brendshme miraton aktvendim.

(11) Anëtarëve të Komisionit për dhënie të provimit nga paragrafi (9) të këtij neni për çdo sesion të mbajtur të provimeve nga neni 66 paragrafi

(2) të këtij ligji u takon kompensim në para, në shumë prej një të tretës të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka Ministria e Ekonomisë miraton aktvendim.

(12) Personi i autorizuar juridik i cili teknikisht e zbaton provimin është i obliguar ta bllokojë shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënie të provimit.

(13) Agjencia për komunikime elektronike (në tekstin e mëtejshëm: AKE) kryen monitorim të përhershëm të bllokimit të shtrirjes së radio frekuencave në hapësirën për dhënie të provimit, me qëllim të pengohet çfarëdo qoftë lloj i komunikimit elektronik me rrethinën jashtë hapësirës për dhënie të provimit.

(14) AKE në hapësirën për dhënie të provimit instalon pajisje matëse e cila siguron regjistrim elektronik nga matjet të kryera në kohëzgjatje prej 30 ditë, dhe të njëjtat magazinohen në sistemin qendror kontrollues të AKE.

(15) AKE formon komision tre anëtarësh i cili përpilon raport në bazë të shkresave elektronike të magazinuara në sistemin qendror të kontrollit të AKE dhe i njëjti për provimin nga nenin 66 paragrafi (1) të këtij ligji e dorëzon te Ministria e Punëve të Brendshme dhe për provimin nga nenin 66 paragrafi (2) të këtij ligji e dorëzon te Ministria e Ekonomisë më së voni në afat prej 15 ditë nga përfundimi i provimit.

(16) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar i cili teknikisht e zbaton provimin nga nenin 66-a paragrafi (5) dhe nenin 66-b paragrafi (5) të këtij ligji nëse nuk e bllokon shtrirjen e radio frekuencave në hapësirën për dhënie të provimit.

(17) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit të autorizuar juridik që e realizon teknikisht provimin nga paragrafi (5) neni 66-a i këtij ligji, nëse nuk e incizon, nuk e emiton drejtpërdrejt në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nëse nuk e vendos incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(18) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit të autorizuar juridik që e realizon teknikisht provimin nga paragrafi (5) neni 66-b i këtij ligji, nëse nuk e incizon, nuk e emiton drejtpërdrejt në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe nëse nuk e vendos incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë.

## **Neni 66-g**

(1) Para fillimit të dhënies së provimit profesional, përfaqësuesi nga ministritë kompetente, që e organizojnë provimin, e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë të provimit, nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve dhe akteve nënligjore, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike, sendeve të përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informaticientët, në rast se ka problem teknik me kompjuterin.

(4) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat, provimi ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(5) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanohen në afat prej pesë minutash provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, vepron në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar edhe i shqiptohet ndalesë për dhënie të provimit nga neni 66 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji dhe kohëzgjatje prej tre vjet, për çka Ministria e Punëve të Brendshme ose Ministria e Ekonomisë miraton aktvendim kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin profesional dhe kjo konstatohet në procesverbalin për dhënien e provimit profesional.

(8) Përfaqësuesit e autorizuar nga ministritë kompetente që e organizojnë provimin, gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që e jep provimin, përveç në rast të mënjanimit të problemit teknik, kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

(9) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet përfaqësuesit të autorizuar nga neni 66-b paragrafi (4), nëse vepron në kundërshtim me paragrafin (8) të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet institucionit të autorizuar që e realizon provimin, nëse nuk e ndërpret provimin në pajtim me paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni.

(11) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet përfaqësuesve të autorizuar nga neni 66-v paragrafi (9) të këtij ligji nëse lejojnë kandidati të veprojë në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

(12) Gjobë në shumë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet kandidatit i cili vepron në kundërshtim me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

### **Neni 66-d**

(1) Provimi profesional nga neni 66 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, fillon me dhënien e pjesës së parë të provimit (pjesës teorike).

(2) Pjesa e dytë e provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, jepet në afat prej së paku 15 ditësh pas dhënies së suksesshme të pjesës së parë.

(3) Ministri i Punëve të Brendshme me Rregullore e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve në provimin nga neni 66 paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Ministri i Ekonomisë me Rregullore e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve në provimin nga neni 66 paragrafi (2) të këtij ligji.

### **Neni 66-gj**

(1) Pjesa e parë e provimit jepet për çdo sferë përkatëse dhe përmban së paku 50 pyetje me pesë opsione për rrethim prej të cilave një është i saktë, dy janë të ngjashëm, një është i pasaktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël pikësh) dhe një është i pasaktë në masë të madhe (në të humben numër i madh pikësh).

(2) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, është që kandidati ta japë pjesën e parë të provimit.

(3) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e parë të provimit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

### **Neni 66-e**

(1) Pjesa e dytë e provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji përbëhet nga shembulli praktik, respektivisht bëhet identifikimi dhe vlerësimi i gjendjes teknike të automjetit për të cilin duhet të përpilohet pëlqim për regjistrim ose letër për refuzim në formularë të numërtuar.

(2) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

### **Neni 66-zh**

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit profesional bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit profesional nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, bëhet identifikimi dhe vlerësimi i gjendjes teknike të automjetit për të cilin duhet të përpilohet pëlqim për regjistrim ose letër për refuzim në formularë të numërtuar.

(4) Kandidati që e jep provimin praktik i plotëson Pëlqimin për regjistrim të automjetit ose letrën për refuzim dhe varësisht nga formularët e plotësuar, ato vlerësohen me pikë.

(5) Pyetjet e përmbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit profesional dhe përgjigjet e tyre nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(6) Pyetjet e përmbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit profesional dhe përgjigjet e tyre nga neni 66 paragrafi (2) të këtij ligji, ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional në Ministrinë e Ekonomisë.

(7) Sistemet elektronike nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni përmbajnë edhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 100 pyetjesh për çdo sferë.

(8) Në sistemin elektronik përmbahet edhe udhëzimi për rregullat dhe literaturën në të cilat përmbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e provimit.

(9) Numri i pyetjeve dhe shembujve praktikë në bazat nga paragrafi (7) i këtij neni, zmadhohet për 10 % në viti duke filluar nga viti 2015.

(10) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë të provimit nga neni 66 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

### **Neni 66-z**

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë të provimit nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, kandidatit i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 66-zh i këtij ligji.

(2) Në ditën e dhënies së pjesës së parë të provimit nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë, kandidatit i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 66-zh i këtij ligji.

(3) Pas lejit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përmbajtjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga neni 66-zh paragrafi (5) i këtij ligji, nga bazat nga neni 66-zh paragrafi (5) i këtij ligji.

(4) Pjesa e parë e provimit nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, përmban udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së tij, për të cilin përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme jep sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit.

(5) Pjesa e parë e provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, përmban udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së tij, për të cilin përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë jep sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit.

(6) Sistemi elektronik për dhënien e provimit nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, në një termin për më shumë se një kandidat.

### **Neni 66-x**

(1) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë të provimit nga neni 66 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 66-zh i këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(2) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni mënjanohen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(3) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mënjanohen në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

### **Neni 66-i**

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka marrë së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.



## Neni 66-j

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së përcaktuar për dhënien e pjesës së dytë të provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, është 60 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga shembulli praktik, ka marrë së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

## Neni 66-k

(1) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, u lëshohet Certifikatë për provim të dhënë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit.

(2) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, u lëshohet Vërtetim për provim të dhënë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit.

(3) Me kërkesë të kandidatit që ka dhënë provim nga paragrafët (1) dhe (2) të nenit 66 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme apo Ministria e Ekonomisë, e informon për gabimet e bëra në testin për dhënien e provimit profesional, me mundësimin e shikimit të drejtpërdrejtë të testit.

## Neni 66-l

(1) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga testet dhe formularët e numërtuar për pëlqim për regjistrim të automjetit ose aktvendim për refuzim të dhënies së provimit profesional dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura ruhen në Ministrinë e Ekonomisë.

(2) Ministri i Punëve të Brendshme formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, i cili në punën e vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe në të cilin, krahas përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, marrin pjesë edhe përfaqësuesi nga Komisioni për dhënien e provimit dhe informatikani nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, i caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Ministri i Ekonomisë formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, i cili në punën e vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe në të cilin, krahas përfaqësuesit të Ministrisë së ekonomisë, marrin pjesë edhe përfaqësuesi nga Komisioni për dhënien e provimit dhe informatikani nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, i caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Komisioni për revizion nga paragrafi (2) të këtij neni mblidhet pas çdo provimi të mbajtur dhe kryen revizion të zbatimit të provimit, duke përfshirë edhe nëse provimin e kanë dhënë kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet për dhënie të provimit në pajtim me nenin 66-a paragrafi (1) të këtij ligji, për çka dorëzon raport te ministri për Punë të Brendshme.

(5) Komisioni për revizion nga paragrafi (3) të këtij neni mblidhet pas çdo provimi të mbajtur dhe kryen revizion të zbatimit të provimit, duke përfshirë edhe nëse provimin e kanë dhënë kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet për dhënie të provimit në pajtim me nenin 66-b paragrafi (1) të këtij ligji, për çka dorëzon raport te ministri për ekonomi.

(6) Anëtarëve të komisioneve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni u takon kompensim në para i cili në nivel vjetor është një rrogë neto mesatare në Republikën e Maqedonisë, për çka ministria kompetente miraton aktvendim.

(7) Nëse Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, konstaton parregullsi në realizimin e provimit nga individë sipas nenit 66-e paragrafi (5) të këtij ligji, propozon heqje të Vërtetimit për provim të dhënë, në pajtim me nenin 66 paragrafi (2) të këtij ligji.

(8) Ministri i Punëve të Brendshme miraton Aktvendim për heqjen e Certifikatës për provim të dhënë nga neni 66-j i këtij ligji, në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni, në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit.

(9) Ministri i Ekonomisë miraton Aktvendim për heqjen e Vërtetimit për provim të dhënë nga neni 66-j i këtij ligji, në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni, në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit.

(10) Kundër Aktvendimit nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni, mund të ngritët kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(11) Gjobjë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet ministrit të Punëve të Brendshme apo ministrit të Ekonomisë nëse nuk e miraton aktvendimin në afatin e përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(12) Me gjobjë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohen anëtarët të komisioneve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni nëse përcaktojnë parregullsi në zbatimin e provimit, ndërsa atë nuk e konstaton në raportin të cilin e dorëzojnë te ministri kompetent.

## Neni 66-I

(1) Lartësinë e kompensimit nga neni 66 paragrafi (10) të këtij ligji e përcakton ministri i Punëve të Brendshme në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, të domosdoshme për zbatimin e provimit, përgatitjen e bazave të pyetjeve, realizimin e testit elektronik, përgatitjen e materialeve dhe thirrjeve dhe përgatitjen e Certifikatave për provimin e dhënë.

(2) Lartësinë e kompensimit nga neni 66 paragrafi (10) i këtij ligji e përcakton ministri i Ekonomisë në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, të domosdoshme për zbatimin e provimit, përgatitjen e bazës me pyetje, për zbatimin e testit elektronik, për përpilimin e materialeve dhe ftesave dhe për përpilimin e Certifikatave për provimin e dhënë.

(3) Shpenzimet për dhënien e provimit nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, paguhen në llogarinë e veçantë të të hyrave personale të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(4) Shpenzimet për dhënien e provimit nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, paguhen në llogarinë e veçantë të të hyrave personale të Ministrisë së Ekonomisë.

(5) Nëse shpenzimet nuk janë paguar në llogarinë përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme apo Ministrisë së Ekonomisë, më së voni 15 ditë

para ditës së caktuar për realizimin e provimit, kandidatit nuk i lejohet dhënia e provimit.

(6) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagimit të mjeteve nuk e jep provimin, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligjin.

## Neni 67

### Rregullat e ministrit

(1) Ministri i Punëve të Brendshme, për sferën e kontrollit teknik do të miratojë rregulla, për:

- kriteret më të afërta për kushtet e lokalit, pajisjes, aparateve dhe kuadrove për personat juridikë për kontroll teknik, si dhe për kalibrimin dhe verifikimin e aparateve dhe pajisjes, në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;
- procedurat për kryerjen e punëve të kontrollit teknik, në pajtim me nenin 63 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën për lëshimin dhe heqjen e aktvendimit për autorizim të personit juridik për kontroll teknik, në pajtim me nenin 62 dhe nenin 65 të këtij ligji;
- grupet dhe kategoritë e automjeteve, për të cilat lëshohet autorizimi për kontroll teknik të automjeteve, në pajtim me paragrafin (2) të nenit 63 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit profesional, formën dhe përmbajtjen e formularit të certifikata për provimin e dhënë, mënyrën e punës së komisionit për realizimin e provimit profesional dhe programin për dhënien e provimit profesional, si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për provimet e realizuara profesionale nga ana e komisionit, në pajtim me nenin 66 të këtij ligji.
- lartësia e shpenzimeve për dhënien e provimit profesional, është në nivelin e shpenzimeve të nevojshme reale për dhënien e tij, në pajtim me paragrafin (1) të nenit 66 të këtij ligji;
- lartësinë e shpenzimeve për dhënien e provimit profesional, në pajtim me paragrafin (6) të nenit 66 të këtij ligji.

(2) Ministri i Ekonomisë për sferën e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve, do të miratojë rregulla për:

- kriteret më të afërta për kushtet e lokalit, pajisjen, aparatet dhe kuadrot për personat juridikë për kontroll teknik, në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;
- procedurat për kryerjen e punëve të identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve, në pajtim me nenin 21 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën për miratimin dhe heqjen e aktvendimit për autorizim të personit juridik për kontroll teknik, për kryerjen e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve, në pajtim me nenin 62 dhe nenin 65 të këtij ligji;
- grupet e kategorive të automjeteve, për të cilat lëshohet autorizimi për identifikim dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjeteve, në pajtim me paragrafin (2) të nenit 63 të këtij ligji;
- mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit profesional, formën dhe përmbajtjen e formularit të vërtetimit për provimin e dhënë, mënyrën e punës së komisionit për realizimin e provimit profesional dhe programin për dhënien e provimit profesional, si dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për provimet e realizuara profesionale nga ana e komisionit, në pajtim me nenin 66 të këtij ligji.
- lartësia e shpenzimeve për dhënien e provimit profesional, është në lartësinë e shpenzimeve të nevojshme reale për dhënien e tij, nga

paragrafi (2) i nenit 66 të këtij ligji dhe  
- lartësinë e shpenzimeve për dhënien e provimit profesional, në pajtim me paragrafin (6) të nenit 66 të këtij ligji.

## **Pjesa e tretë 5**

### **Neni 68**

*I fshirë*

### **Neni 69**

*I fshirë*

### **Neni 70**

*I fshirë*

### **Neni 71**

*I fshirë*

### **Neni 72**

*I fshirë*

## **KREU VI**

# **REGJISTRI I AUTOMJETEVE**

### **Neni 73**

#### **Regjistri i automjeteve**

Ministria e Punëve të Brendshme mban regjistër të automjeteve, i cili i përmban të dhënat e evidencës për:

- tipet e lejuara të automjeteve;
- vërtetimet e lëshuara për përshtatshmëri dhe pajtime për regjistrim;
- automjetet e regjistruara;
- automjetet e shkatërruara;
- mbikëqyrjen rrugore të rregullsisë teknike të automjeteve, që marrin pjesë në komunikacionin rrugor dhe
- provimet e realizuara profesionale.

#### **Regjistri i automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik**

### **Neni 73-a**

(1) Ministria e Transportit dhe Lidhjeve përmes softuerit elektronik mban regjistër të automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik, i cili përmban të dhëna nga evidenca e personave juridikë të autorizuar për kontroll teknik për:

- automjete të cilat e kanë kaluar kontrollin teknik,
- kartonin personal të çdo automjeti veç e veç,

- pagesa dhe kompensime të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik dhe
- kompensime tjera të cilat kanë të bëjnë me evidencën e automjeteve dhe ndjekjen e pagesave dhe kompensimeve.

(2) Personat e autorizuar juridikë për kontroll teknik janë të obliguar çdo që ditë të fusin të dhëna nga paragrafi (1) i këtij neni në regjistrin e automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik.

### **Neni 73-b**

(1) Për azhurnimin e të dhënave në regjistrin nga neni 73-a i këtij ligji, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të shfrytëzojë të dhëna nga evidenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Byrosë së Metrologjisë.

(2) Për veprim në pajtim me kompetenca e përcaktuara me ligj, qasje në të dhënat e regjistrin nga neni 73-a të këtij ligji mund të kenë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Byroja e Metrologjisë, Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë dhe Inspektorati Shtetëror i Transportit.

### **Neni 73-v**

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve sipas nevojës mund të shkëmbejnë të dhëna dhe informata nga evidenca e regjistrave nga neni 73 dhe neni 73-a të këtij ligji.

### **Neni 74**

#### **Të dhënat personale të përmbajtura në regjistrin e të dhënave**

(1) Të dhënat personale mund të shfrytëzohen në pajtim me qëllimet e përcaktuara me këtë ligj, dhe në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Të dhënat personale të futura në regjistrin nga neni 73 i këtij ligji, menjëherë fshihen në rastet kur konfirmohet se nuk janë të sakta, ose kanë pushuar shkaqet për të cilat e dhëna personale është futur në regjistër.

### **Neni 75**

#### **Arritja te regjistri i të dhënave**

(1) Të dhënat e përmbajtura në regjistrin nga neni 73 i këtij ligji, nga futja e tyre deri në fshirjen e tyre nga regjistri, mund të jepen në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara në pajtim me rregullat nga neni 76 i këtij ligji.

(2) Prodhuesit e automjeteve, sistemeve të tyre, pjesëve përbërëse apo njësisive të pavarura teknike dhe pajisjes, kanë të drejtë që të marrin të dhëna lidhur me atë se cili person është pronar, përkatësisht shfrytëzues i automjetit të caktuar, nëse ato të dhëna u nevojiten, në pajtim me nenin 13 paragrafi (4) i këtij ligji.

(3) Lidhur me arritjen e të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, vendos ministri i Punëve të Brendshme, në bazë të kërkesave me shkrim të

arsyetuara dhe dëshmime të bashkëngjitura, lidhur me ekzistimin e rrethanave për të cilat kërkohet arritja të të dhënave.

## Neni 76

### Rregullat e ministrit të Punëve të Brendshme

Ministri i Punëve të Brendshme më afërsisht i përcakton, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të të dhënave, si dhe kriteret për qasje kompjuterike të regjistrit të të dhënave, si dhe mënyrën e futjes dhe dhënies së të dhënave nga regjistri, në pajtim me nenin 73 dhe 75 të këtij ligji.

## KREU VII

### MBIKËQYRJA

## Neni 77

### Mbikëqyrja

Mbikëqyrje në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryejnë:

- Ministria e Ekonomisë, lidhur me: plotësimin e kushteve për kryerjen e procedurave për identifikimin dhe identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve, nga ana e personave juridikë për kontroll teknik që janë të autorizuar për atë, si dhe për punën e shërbimeve teknike dhe
- Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me: plotësimin e kushteve për kryerjen e procedurës së kontrollit teknik nga ana e personave juridikë për kontroll teknik, dhe lidhur me plotësimin e kushteve për punën e regjistrimit nga ana e personave juridikë për regjistrimin e automjeteve.

(2) Ministria e Ekonomisë nëpërmjet organit për lejim gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, kryen kontroll të së paku 1% nga numri i automjeteve të kontrolluara për punët të cilat i kryen personi juridik për kontroll teknik i cili është i autorizuar për identifikim dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike, përkatësisht kryen kontroll të 1% të automjeteve për të cilat është mbajtur procedurë për lejim.

(3) Ministria e Punëve të Brendshme gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kryen kontroll teknik të së paku 1% të numrit të automjeteve të kontrolluara për kategoritë automjete për të cilin është autorizuar personi juridik për kontroll teknik.

(4) Ministri i Ekonomisë më së afërmi i përcakton mënyrën dhe procedurën për zbatimin e dispozitave nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Ministri i Punëve të Brendshme i përcakton mënyrën dhe procedurat për zbatimin e dispozitave nga paragrafi (3) i këtij neni.

## Neni 78

### Mbikëqyrja inspektuese

(1) Mbikëqyrje inspektuese në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryejnë:

- Inspektorati shtetëror i tregut, ndaj ligjshmërisë së lëshimit të vërtetimit për përshtatshmëri nga ana e prodhuesve dhe përfaqësuesve të tyre dhe

ndaj punës së personave juridikë për kontroll teknik, që i realizojnë procedurat e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve;

- Inspektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndaj punës së personave juridikë për kontroll teknik dhe personave juridikë për regjistrimin e automjeteve dhe mbikëqyrjen ndaj përmbajtjes në kushtet e përcaktuara për punë të personit të autorizuar, për instalimin e aparatit motorik me gaz të lëngët të naftës, gaz të komprimuar tokësor apo aparatit tjetër dhe pajisjes plotësuese nga neni 54 paragrafi (4) i këtij ligji, dhe mbikëqyrjen e rregullsisë teknike të të gjitha automjeteve në komunikacionin rrugor.

- Inspektorati shtetëror i bujqësisë dhe Inspektorati shtetëror i pylltarisë, lidhur me kërkesat që duhet t'i plotësojnë traktorët jashtë komunikacionit rrugor, gjatë kryerjes së punëve bujqësore dhe pyjore dhe

- Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor, lidhur me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrja inspektuese nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe mbikëqyrja e automjeteve për dedikim të veçantë, kryhet në koordinim ndërmjet organeve kompetente inspektuese.

## Neni 79

### **Autorizimi dhe masat e inspektorit nga Inspektorati shtetëror i tregut**

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori kompetent nga Inspektorati shtetëror i tregut, ka të drejtë:

1) ta kontrollojë evidencën, që duhet ta mbajë personi juridik për kontroll teknik, i autorizuar për veprimet e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike në bazë të këtij ligji, dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji;

2) t'i marrë të dhënat nga regjistri i të dhënave për automjetet, që janë të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese;

3) të marrë të dhëna dhe të kryejë kontroll të sigurisë teknike të lokaleve, aparateve, pajisjes, dokumenteve, formularëve dhe vulave;

4) të marrë kopje të dokumenteve dhe të dhëna të tjera, që janë të nevojshme lidhur me kryerjen mbikëqyrjes inspektuese;

5) të përcaktojë masa për mënjanimin e parregullsisë;

6) ta ndalojë lëshimin në treg apo ta ndalojë shfrytëzimin apo të mënjanojë nga shitja automjete, sisteme, pjesë përbërëse apo njësi të pavarura teknike dhe pajisje, që nuk janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;

7) përkohësisht ta ndalojë kryerjen e punëve të lidhura me zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, deri në mënjanimin e parregullsisë të konfirmuara;

8) të ndalojë, punën ta kryejë personi që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për kryerjen e asaj pune;

9) t'i propozojë organit kompetent kumtimin e masave për mënjanimin e parregullsisë të konfirmuara, përkatësisht heqjen e autorizimit.

(2) Kundër çdo mase të ndërmarrë nga inspektori shtetëror ose personi i autorizuar për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh, të komisioni i formuar nga ministri i Ekonomisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni është i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë të gjithë juristë të diplomuar me së paku tre vjet përvojë

pune në profesion. Kryetari i komisionit është nga radhët e nëpunësve shtetërore udhëheqës.

## Neni 80

### **Autorizimi dhe masat e inspektorit të Inspektoratit shtetëror të bujqësisë dhe Inspektoratit shtetëror të pylltarisë**

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori kompetent i Inspektoratit shtetëror të bujqësisë dhe/ose Inspektoratit shtetëror të pylltarisë, në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtë:

- 1) të kontrollojë nëse traktori që është jashtë komunikacionit rrugor dhe përdoret për kryerjen e punëve bujqësore, përkatësisht pyjore, ka sisteme, pjesë përbërëse apo njësi të pavarura teknike dhe pajisje në gjendje të rregullt, në pajtim me kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
- 2) nëse traktori është i pajisur me kabinë apo kornizë mbrojtëse nga rrotullimi;
- 3) të kontrollojë nëse shoferi dhe udhëtarët i shfrytëzojnë rripat e sigurisë dhe pajisjen tjetër mbrojtëse, nëse të atillë janë instaluar dhe janë paraparë;
- 4) të marrë masa për ndalimin e shfrytëzimit të traktorëve që nuk kanë sisteme, pjesë përbërëse apo njësi të pavarura teknike dhe pajisje në gjendje të rregullt, në pajtim me kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Kundër çdo mase të ndërmarrë nga inspektori shtetëror ose personi i autorizuar për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh, të komisioni i formuar nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni është i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë të gjithë juristë të diplomuar me së paku tre vjet përvojë pune në profesion. Kryetari i komisionit është nga radhët e nëpunësve shtetërore udhëheqës.

## Neni 81

### **Mbikëqyrja inspektuese ndaj personave juridikë për kontrolle teknike**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori kompetent nga Ministria e Punëve të Brendshme, ka të drejtë:

- 1) ta kontrollojë evidencën, që duhet ta mbajë personi juridik për kontrolle teknike, në bazë të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji;
- 2) t'i marrë të dhënat nga regjistri i të dhënave për automjetet, që janë të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese;
- 3) të marrë të dhëna dhe të kryejë kontroll të sigurisë teknike të lokaleve, aparateve, pajisjes, dokumenteve, formularëve dhe vulave;
- 4) të marrë kopje të dokumenteve dhe të dhëna të tjera, që janë të nevojshme lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese;
- 5) të kërkojë nga personi përgjegjës te personat juridikë për kontroll teknik, t'ia mundësojë kryerjen përsëri të procedurës për konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit të veçantë;
- 6) t'i ndërmarrë masat e nevojshme për zhdukjen e dokumenteve të



lëshuara, nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese konfirmohet se kryerësi i procedurës nga paragrafi (1) pika 5 e këtij neni, ka konfirmuar rregullsi teknike të automjetit në gjendje të parregullt teknike;

- 7) të përcaktojë masa për mënjanimin e parregullsive;
- 8) përkohësisht ta ndalojë kryerjen e punëve të lidhura me zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, deri në mënjanimin e parregullsive të konfirmuara;
- 9) të ndalojë, punën ta kryejë personi që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për kryerjen e asaj pune;
- 10) t'i propozojë organit kompetent, kumtimin e masave për mënjanimin e parregullsive të konfirmuara, përkatësisht heqjen e autorizimit.

(2) Shpenzimet për procedurën e përsëritur nga paragrafi (1) pika 5 e këtij neni, nuk janë në llogari të pronarit, përkatësisht të shfrytëzuesit të automjetit, pa dallim nga rezultati i procedurës.

(3) Kundër çdo mase të ndërmarrë nga inspektori kompetent ose personi i autorizuar për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh, te komisioni i formuar nga ministri i Punëve të Brendshme.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni është i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë të gjithë juristë të diplomuar me së paku tre vjet përvojë pune në profesion. Kryetari i komisionit është nga radhët e nëpunësve shtetërorë udhëheqës.

## **Neni 81-a**

### **Heqja e licencës për punë punëtorëve profesionale**

(1) Nëse personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme gjatë kontrollit të personit juridik për kryerjen e kontrollit teknik përcakton se punëtori profesional nuk e kryen kontrollin teknik në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të cilat dalin nga ai, nga ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim dhe t'i hiqet licenca për punë për periudhë prej tre, përkatësisht për periudhë prej gjashtë muajsh nëse parregullsia e lëndës në punë përsëritet në afat prej 12 muajsh.

(2) Nëse punëtori profesional e vërteton rregullshmërinë teknike të automjeteve me pajisje të parregullta për frenim, pajisje për menaxhim ose automjete për pajisje të paatëstuar për gaz të lëngshëm të naftës, ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë licencën për punë për periudhë prej gjashtë muajsh.

(3) Nëse punëtori profesional e vërteton rregullsinë teknike të automjetit për të cilin nuk është kryer kontroll teknik, ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë licencën për punë për periudhë prej dy vitesh.

(4) Nëse për shkak të lëshimeve të ndodhura nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni ka ndodhur fatkeqësi në komunikacion ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë licencën për punë punonit profesional për periudhë prej pesë vitesh.

(5) Aktvendimi nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet kontest para gjykatës administrative.

(6) Për kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë autorizimin personit juridik për kontroll teknik.

(7) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh, në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar juridik nëse urdhëron, ose lejon punëtori profesional të realizojë punë në stacionin për kontroll teknik në rastet kur i është hequr licenca për punë, kur nuk e ka dhënë testin për kontroll të profesionalizmit ose nëse punët në lidhje me kontrollin teknik të automjeteve nuk i realizon në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të cilat dalin nga ai.

(8) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi i autorizuar juridik për kryerjen e kontrollit teknik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (7) i këtij neni.

## **Neni 81-b**

### **Mbikëqyrja e presonit juridik për kontroll të automjeteve për transport të materieve të rrezikshme**

(1) Mbikëqyrje mbi punën e personit të autorizuar juridik për kontroll të automjeteve për transport të materieve të rrezikshme, kryen Ministria e Punëve të Brendshme.

(2) Nëse personi i autorizuar juridik për kontroll të automjeteve për transport të materieve të rrezikshme nuk i kryen punët e autorizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat të miratuara në bazë të këtij ligji ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim përkohësisht do t'i ndalojë kryerjen e punëve dhe do të caktojë afat prej 30 ditësh për mënjanimin e mangësive të përcaktuara.

(3) Nëse personi i autorizuar juridik për kontrollin e automjeteve për transport të materieve të rrezikshme nuk i mënjanon mangësitë e përcaktuara në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë autorizimin.

(4) Aktvendimi nga paragrafi (3) i këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet kontest para gjykatës kompetente.

## **Neni 82**

### **Mbikëqyrja inspektuese në komunikacionin rrugor**

(1) Mbikëqyrjen inspektuese në komunikacionin rrugor e kryen Ministria e Punëve të Brendshme, me ç'rast nëpunësit e uniformuar policorë kanë të drejtë që ta ndalojnë dhe kontrollojnë automjetin, sistemet e tij, pjesët përbërëse apo njësitë e pavarura teknike dhe pajisjen, si dhe dokumentet dhe dëshmitë e tjera që duhet t'i ketë me vete shoferi i automjetit dhe janë lëndë e mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Për zbatimin e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, shoferi është i obliguar që të ndalet në vendin që do ta caktojë nëpunësi i uniformuar policor, me dhënien e shenjave të përcaktuara, në mënyrë dhe sipas procedurës që është e rregulluar në pajtim me rregullat lidhur me transportin dhe sigurinë në komunikacionin rrugor. Pronari, përkatësisht shfrytëzuesi i automjetit, ka të drejtë që të marrë pjesë gjatë zbatimit të masave nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese konfirmohen parregullsi për shkak të të cilave duhet të hiqet automjeti nga komunikacioni, shpenzimet e kontrollit të kryer i paguan shoferi.

(4) Gjoha në shumë prej 200 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje shoferit, që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

## Neni 83

### Shfrytëzimi i njësive mobile

(1) Mbikëqyrje ndaj rregullsisë teknike të automjeteve në komunikacionin rrugor, që ka të bëjë me kontrollin, përkatësisht matjen e efikasitetit të sistemit të frenave dhe emetimit të gazrave të nxjerra, si dhe shikimin dhe kontrollin e kufizuesve të shpejtësisë, e kryejnë inspektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me ndihmën e aparateve matëse të vendosura në automjetin e veçantë (në tekstin e mëtejme: njësitë mobile).

(2) Për pajisjen e matjes dhe aparatet e njësive mobile, përdoren pajisja për matje dhe aparatet, që i plotësojnë të njëjtat kërkesa siç janë kërkesat për aparatet dhe pajisjen, të cilat në punën e vet i përdorin personat juridikë për kontrolle teknike.

## Neni 84

### Masat në mbikëqyrjen rrugore dhe gjatë kryerjes së punëve

(1) Nëpunësi polic i uniformuar duhet që gjatë ushtrimit të detyrave të tija ta largojë nga komunikacioni, respektivisht të ndalojë shfrytëzimin e automjetit që:

1. teknikisht nuk është në rregull;
2. është dëmtuar në aksident të komunikacionit, e që nuk është në gjendje të sigurt për të marrë pjesë në komunikacionin rrugor;
3. nuk është lejuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji;
4. nuk i plotëson kërkesat e veçanta teknike për dedikimin që shfrytëzohet;
5. është përmirësuar respektivisht riparuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji;
6. ka të instaluara sisteme, pjesë përbërëse ose njësi dhe pajisje të pavarur teknike që nuk janë lejuar për atë automjet edhe pse është dashur që të lejohet;
7. nuk është i regjistruar dhe nuk ka leje qarkullimi të vlefshme;
8. nuk ka, ose nuk është e shënuar në mënyrë të përcaktuar me tabelë regjistruese ose prove për atë automjet dhe
9. është shënuar me tabelë provë ose regjistrimi, që nuk janë dhënë për atë automjet.

(2) Largimi i automjetit, respektivisht, ndalimi për shfrytëzim zgjat deri sa të mënjanohen shkaqet për të cilat është larguar, respektivisht është dhënë ndalimi. Nëpunësi policor i uniformuar, që e largon automjetin nga komunikacioni, mund t'ia merr lejen e qarkullimit dhe tabelat e regjistrimit ose ato provë dhe t'i urdhërojë shoferit që t'i nxjerrë tabelat e regjistrimit ose ato provë nga automjeti. Nëse shoferi nuk i heq targat ose targat provë nga automjeti, ato nxirren në barrë të shoferit. Nëpunësi policor i uniformuar jep vërtetim për lejen e qarkullimit të marrë, respektivisht për tabelat e regjistrimit ose ato provë.

(3) Nëpunësi policor i uniformuar e dërgon automjetin për kontroll të jashtëzakonshëm teknik dhe i merr tabelat e regjistrimit dhe ato provë nëse dyshon se:

- automjeti nuk është teknikisht në rregull për shkak të gabimeve të pjesëve që e vënë në lëvizjeve ose pajisjeve për drejtim të automjetit ose frenim, si dhe të lidhjet midis automjetit që tërheq ose që tërhiqet,
- nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në kuptim të nxjerrjes së gazrave dhe zhurmës,
- automjeti është i dëmtuar aq shumë sa nuk është në gjendje për pjesëmarrje të sigurt në komunikacionin rrugor, përveç në rastet e përmendura në paragrafin (4) alineja 1 e këtij neni.

(4) Nëpunësi i uniformuar policor i merr tabelat e regjistrimit dhe e dërgon automjetin në shërbimet teknike për lejimin e veçantë nëse dyshon se:

- automjeti është i dëmtuar për vozitje ose sistemi i drejtimit, ai frenimit ose
- automjeti është përmirësuar ose riparuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji të miratuara në bazë të këtij ligji, ose
- sistemet e instaluara, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike dhe pajisjet që nuk janë të lejuara për atë automjet, e është dashur që të lejohen.

(5) Në rastin si në paragrafin (3) alineja 3 e këtij neni dhe paragrafi (4) alineja 1 e këtij neni, pasi që automjeti të riparohet bëhet kontrolli teknik, respektivisht lejimi i veçantë i automjetit, në pajtim me nenet 19 dhe 54 të këtij ligjit.

(6) Shpenzimet për kontrollin e jashtëzakonshëm teknik i paguan shoferi. Shoferit shpenzimet për kontrollin e bërë teknik, përveç në rastin nga paragrafi (5) të këtij neni i kthehen nëse në kontrollin teknik konstatohet se automjeti është në gjendje të rregullt teknike.

(7) Leja e qarkullimit, respektivisht tabelat e regjistrimit ose ato provë të marra, i kthehen pronarit ose shfrytëzuesit të automjetit të cilit i janë marrë në afat prej tre ditëve nga dita e marrjes, nëse është mënjeluar arsyeja për të cilën janë marrë. Pronari respektivisht shfrytëzuesi i automjetit dëshmon se është mënjeluar arsyeja për marrjen me dëshmi për rregullshmëri teknike të automjetit, respektivisht me regjistrimin e ndryshimit në vërtetimin për përshtatjet e automjetit. Pas skadimit të afatit prej tre ditëve, tabelat e regjistrimit i kthehen organit të regjistrimit që i ka dhënë, kurse tabelat provë asgjësohen.

## Neni 85

### Detyrimi për bashkëpunim

(1) Shoferi është i detyruar që me kërkesë të nëpunësit të uniformuar të mundësojë kontrollin e automjetit dhe të bashkëpunojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit.

(2) Shoferi është i detyruar që me kërkesë të nëpunësit polic i uniformuar të mundësojë kontroll teknik të automjetit. Nëse në vendin e mbikëqyrjes inspektuese automjeti nuk mund të kontrollohet teknikisht, shoferi është i detyruar që me kërkesë të ta dërgojë automjetin në kontroll teknik.

(3) Nëse shoferi në kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e dërgon automjetin në kontroll teknik e njëjta transportohet në barë të tij.

(4) Gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoferit që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personi juridik për kundërvajtje të bërë nga paragrafi (5) i këtij neni.

## **Neni 86**

### **Mbikëqyrja të cilën e bën policia**

(1) Policia bën mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji në suazat e mbikëqyrjes së sigurisë në komunikacionin rrugor dhe sigurisë gjatë kryerjes së punëve bujqësore dhe punëve në mal.

(2) Dispozitat e këtij kapitulli në mënyrë adekuate zbatohen edhe për kryerjen e mbikëqyrjes nga ana e policisë ndaj biçikletave dhe karrocave.

(3) Nëpunësi polic i uniformuar mund të largojë nga komunikacioni automjetin që është përmirësuar, ashtu që e tejkalon fuqinë më të madhe të motorit ose shpejtësinë më të madhe të caktuar të konstruksionit, sipas dokumentacionit të prodhuesit të automjetit, ose shpejtësisë më të madhe të konstruksionit që është caktuar për kategorinë e veçantë të automjeteve me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

## **KREU VIII**

### **PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE**

## **Neni 87**

### **Procedurë për barazim para Ministrisë së Ekonomisë**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 5-a, 13, 14, 16, 20, 22, 56 dhe 62 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Inspektorati Shtetërorë i Tregut.

(2) Procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni para Inspektoratit Shtetërorë të Tregut e mban Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje.

(3) Kur Inspektorati Shtetërorë i Tregut për ngritjen e procedurës kundërvajtëse do të konstatojë kundërvajtje përpilon procesverbal në të cilin i shënon elementet e rëndësishme të veprimit nga i cili rezultojn shënimi juridik i kundërvajtjes, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimin e veprimit dhe personat e hasur aty për aty, si dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse dhe të njëjtën e shënon në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar. Procesverbalin e nënshkruan inspektori shtetërorë i tregut dhe kryerësi.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse inspektori shtetërorë i tregut kundërvajtjen e përcakton personalisht apo përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, përkatësisht me të dhëna nga evidenca zyrtare procesverbalin e nënshkruan vetëm inspektori.

(5) Nëse kryerësi e pranon veprën që i jepet në barrë apo nëse inspektori shtetërorë i tregut kundërvajtjen e përcakton personalisht apo e përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, inspektori menjëherë do të jep urdhërpagesë kundërvajtëse.

(6) Urdhërpagesën kundërvajtëse përmban emrin personi, adresën dhe numrin e vetëm amë të qytetarit, ndërsa për personin juridik, emrin, selinë dhe numrin tatimorë, vendin dhe kohën e kryerjes së kundërvajtjes, kualifikimin juridik të kundërvajtjes, shumën e gjobës, numrin e llogarisë për pagim dhe mësim juridik.

(7) Pas pranimi dhe nënshkrimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni në afat prej tetë ditë nga pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

(8) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në mesimin juridik.

(9) Inspektori shtetërorë i tregut është i detyruar të mbajë evidencë elektronike për urdhërpagesat e dhëna kundërvajtëse dhe për gjobat e shqiptuara për kundërvajtje të bërë.

(10) Në evidencën elektronike nga paragrafi (9) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: Për kryerësin e kundërvajtjes për personin fizik – emri dhe mbiemri, për personin juridik – emri, vendbanimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet për kundërvajtje të bërë.

(11) Të dhënat nga paragrafi (10) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën elektronike.

(12) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri i Ekonomisë.

## **Neni 88**

### **Procedurë para Ministrisë së Punëve të Brendshme**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 26, 33, 33-a, 35, 36, 37, 38, 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 51, 53, 54, 56-a, 62-a, 65, 66-v, 66-g, 66-l, 81-a, 82 dhe 85 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Ministria e Punëve të Brendshme.

(2) Procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni para Ministrisë së Punëve të Brendshme e mban Komisioni për vendimmarrje sipas kundërvajtjes.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni është përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë. Kryetari i komisionit është jurist i diplomuar me provim të kaluar të jurisprudencës dhe përvojë pune prej më së paku gjashtë vjet në materien në fjalë, ndërsa anëtarët e komisionit të kenë mbaruar arsim të lartë dhe përvojë pune prej më së paku katër vjet nga materia në fjalë.

(4) Dorëzimi i shkrimit të përpiluar nga Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje, bëhet në pajtim me dispozitat nga Ligji për kundërvajtjet dhe Ligji për procedurën e përgjithshme administrative.

(5) Nëse vendbanimi i personit të cilit duhet t'i dorëzohet njoftim, ftesë apo vendim është i panjohur për organin i cili dorëzohet me shkrim,

komisioni do ta publikojë shkrimin në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe me kalimin e tetë ditëve nga dita e publikimit në ueb faqen, do të konsiderohet se pala është njoftuar në mënyrë të rregullt për shkrimin.

(6) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kur kryerësi i kundërvajtjes është i huaj, nëpunësi policorë do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse te gjykata kompetente.

(7) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetërorë për Vendimmarrje në Shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse.

## **Neni 89**

### **Procedura në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**

Procedurë për barazim para Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 47 nga ky ligj, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

(2) Procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni para Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave e mban Komisioni për vendimmarrje sipas kundërvajtjes.

(3) Kur inspektori shtetërorë për bujqësi apo inspektori shtetërorë për pylltari dhe gjueti (në tekstin e mëtutjeshëm të këtij neni: inspektori) për ngritjen e procedurës kundërvajtëse do të konstatojë kundërvajtje përpilon procesverbal në të cilin i shënon elementet e rëndësishme të veprimit nga i cili rezulton shënimi juridik i kundërvajtjes, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit dhe personat e hasur aty për aty, si dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse dhe të njëjtën e shënon në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar. Procesverbalin e nënshkruan inspektori dhe kryerësi.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse inspektori kundërvajtjen e përcakton personalisht apo përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, përkatësisht me të dhëna nga evidenca zyrtare procesverbalin e nënshkruan vetëm inspektori.

(5) Nëse kryerësi e pranon veprën që i jepet në barrë apo nëse inspektori kundërvajtjen e përcakton personalisht apo e përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, inspektori menjëherë do të jep urdhërpagesë kundërvajtëse.

(6) Urdhërpagesën kundërvajtëse përmban emrin personi, adresën dhe numrin e vetëm amë të qytetarit, ndërsa për personin juridik, emrin, selinë dhe numrin tatimorë, vendin dhe kohën e kryerjes së kundërvajtjes, kualifikimin juridik të kundërvajtjes, shumën e gjobës, numrin e llogarisë për pagim dhe mësim juridik.

(7) Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni në afat prej tetë ditë nga pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

(8) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në mesimin juridik.

(9) Inspektori shtetërorë i shtetërorë për bujqësisë apo inspektori shtetërorë për pylltari dhe gjueti është i detyruar të mbajë evidencë elektronike për urdhërpagesat e dhëna kundërvajtëse dhe për gjobat e shqiptuara për kundërvajtje të bërë.

(10) Në evidencën elektronike nga paragrafi (9) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: Për kryerësin e kundërvajtjes për personin fizik – emri dhe mbiemri, për personin juridik – emri, vendbanimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet për kundërvajtje të bërë.

(11) Të dhënat nga paragrafi (10) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën elektronike.

(12) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## **Neni 90**

### **Procedurë për barazim para Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 41 nga ky ligj, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë.

(2) Procedurën kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni para Ministrisë së Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinorë e mban Komisioni për vendimmarrje sipas kundërvajtjes.

(3) Kur inspektori shtetërorë për mjedis jetësorë (në tekstin e mëtutjeshëm të këtij neni: inspektori) për ngritjen e procedurës kundërvajtëse do të konstatojë kundërvajtje përpilon procesverbal në të cilin i shënon elementet e rëndësishme të veprimit nga i cili rezultojnë shënimi juridik i kundërvajtjes, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit dhe personat e hasur aty për aty, si dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse dhe të njëjtën e shënon në procesverbalin për kundërvajtje të konstatuar. Procesverbalin e nënshkruan inspektori dhe kryerësi.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse inspektori kundërvajtjen e përcakton personalisht apo përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, përkatësisht me të dhëna nga evidenca zyrtare procesverbalin e nënshkruan vetëm inspektori.

(5) Nëse kryerësi e pranon veprën që i jepet në barrë apo nëse inspektori kundërvajtjen e përcakton personalisht apo e përcakton me përdorimin e mjeteve dhe veglave teknike të përshtatshme, inspektori menjëherë do të jep urdhërpagesë kundërvajtëse.

(6) Urdhërpagesën kundërvajtëse përmban emrin personl, adresën dhe numrin e vetëm amë të qytetarit, ndërsa për personin juridik, emrin, selinë dhe numrin tatimorë, vendin dhe kohën e kryerjes së kundërvajtjes, kualifikimin juridik të kundërvajtjes, shumën e gjobës, numrin e llogarisë për pagim dhe mësim juridik.



(7) Pas pranimit dhe nënshkrimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, kryerësi është i detyruar ta paguajë gjobën e shqiptuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni në afat prej tetë ditë nga pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

(8) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën të drejtë këshillohet në mesimin juridik.

(9) Inspektori shtetërorë i mjedisit jetësorë është i detyruar të mbajë evidencë elektronike për urdhërpagesat e dhëna kundërvajtëse dhe për gjobat e shqiptuara për kundërvajtje të bërë.

(10) Në evidencën elektronike nga paragrafi (9) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: Për kryerësin e kundërvajtjes për personin fizik – emri dhe mbiemri, për personin juridik – emri, vendbanimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet për kundërvajtje të bërë.

(11) Të dhënat nga paragrafi (10) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën elektronike.

(12) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri i mjedisit jetësorë dhe planifikimit hapësinorë.

## **Neni 91**

### **Procedura për barazim në Ministrinë e Ekonomisë**

*I fshirë* 6

## **Neni 92**

### **Procedura para Ministrisë së Punëve të Brendshme për persona fizik dhe juridik**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 26, 33, 33- a, 35, 36, 37, 38, 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 51, 54, 82 dhe 85 të këtij ligji, nëpunësi i uniformuar policorë është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes, person fizik, t'i propozojë procedurë për barazim para se të parashtrijë kërkesë për procedurë kundërvajtëse.

(2) Për kundërvajtjet nga nenet 33, 37 dhe 40 të këtij ligji, të përcaktuara në procedurë administrative, personi i autorizuar zyrtarë është i detyruar të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

(3) Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 8 ditë nga pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse, nëpunësi i uniformuar policorë parashtron kërkesë për ngritjen e procedura kundërvajtëse te Komisioni nga neni 88 paragrafi (2) nga ky ligj.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 26, 37, 40, 42, 43, 44, 45, 47, 53, 54, 56-a, 62-a, 65, 66-v, 66-g, 66-l, 81-a dhe 85 të këtij ligji, kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik dhe person përgjegjës në person juridik, nëpunësi i uniformuar policorë parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse te Komisioni nga neni 88 paragrafi (2) nga ky ligj.

## **Neni 92-a**

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet. [7](#)

## **Neni 93**

### **Procedura për barazim në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**

*I fshirë* [8](#)

## **Neni 94**

### **Procedura për barazim në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**

*I fshirë* [9](#)

## **KREU IX**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

## **Neni 95**

### **Periudha kalimtare**

Procedurat të cilat kanë filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

## **Neni 96**

### **Vazhdimi me punë**

(1) Personat zyrtarë të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë kryer punën e servisit teknik dhe personi i autorizuar juridik për kontrollin e automjeteve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor, do të vazhdojnë të bëjnë punë si shërbime teknike në pajtim me nenin 58 paragrafi (3) i këtij neni dhe neni 57 paragrafi (4) i këtij ligji.

(2) Personat juridik nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që ta harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e marra në bazë të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e dispozitave të marra në bazë të këtij ligji.

(3) Personat juridik për vlerësimin e përshtatjes së automjeteve, të autorizuar në pajtim me Ligjin për sigurinë e produkteve, do të vazhdojnë të bëjnë punë për identifikim, identifikimin dhe vlerësimin të gjendjes teknike të automjeteve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e marra në bazë të këtij ligji.

(4) Personat juridik nga paragrafi (3) i këtij neni janë të detyruar që ta harmonizojnë statusin e tyre dhe punën e tyre me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e marra në bazë të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e dispozitave të marra në bazë të këtij ligji.

(5) Autorizimet e dhëna personave juridik për kontroll teknik të automjeteve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor, deri

në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejné.

(6) Personat juridik nga paragrafi (5) i këtij neni janë të detyruar që ta harmonizojné punën e tyre me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e marra në bazë të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e dispozitave të marra në bazë të këtij ligji.

(7) Autorizimet e dhëna personave juridik për regjistrimin e automjeteve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor, para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejné edhe më tej.

(8) Personat juridik nga paragrafi (7) i këtij neni janë të detyruar që ta harmonizojné punën e tyre me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e marra në bazë të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e dispozitave të marra në bazë të këtij ligji.

(9) Personat profesional që bëjnë punë te personat juridik për kontroll teknik dhe personat juridik për regjistrim janë të detyruar që t'i plotësojnë kushtet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e marra në bazë të këtij ligji në afat prej dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi e dispozitave të marra në bazë të këtij ligji.

(10) Punëtorët profesional që kanë marrë licencë për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor mund të bëjnë punën e kontrollit teknik deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së licencës.

## **Neni 97**

### **Procedura për regjistrimin e automjeteve**

(1) Regjistrimi i automjetit të tipit që nuk është lejuar në pajtim me dispozitat e harmonizuara të UE, lejimi i tipit për të cilin nuk ekziston leje në Republikën e Maqedonisë e për të cilin është siguruar dokumentacion për plotësimin e të gjitha kërkesave teknike në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të dispozitave të marra në bazë të këtij ligji bëhet në bazë të procedurës së realizuar për vlerësimin e përshtatjes te personat juridik nga neni 96 paragrafi (3) i këtij ligji, deri në afatin e vlefshmërisë së autorizimit të tyre të dhënë në pajtim me Ligjin për sigurinë e produkteve, respektivisht te personat juridik nga neni 96 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Për regjistrimin e traktorit, rimorkios së traktorit dhe rimorkios për banim që përdoren në Republikën e Maqedonisë deri më 1 janar 2009 nuk zbatohen dispozitat nga neni 31 paragrafi (2) alineja 4 e këtij ligji.

## **Neni 98**

### **Afati për sjelljen e dispozitave**

(1) Dispozitat nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të sillen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

## **Neni 99**

### **Dispozitat që pushojné të vlejné**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë të vlejshme nën: 319 paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7), 320, 321, 322 dhe nga 324 deri 368 nga neni 369 fshihen fjalët 322 paragrafi (6); 326 paragrafët (7) dhe (8); 329 paragrafi (3); 330 paragrafi (8); 331 paragrafi (5); 342 paragrafi (3); 345 paragrafi (6); 346 paragrafi (5); 347 paragrafi (2), 354 paragrafët (3) dhe (4); 356 paragrafi (3); 366 paragrafi (7)" nga neni 370 fshihen fjalët "320 paragrafët (3) dhe (4); 322 paragrafi (5); 326 paragrafi (5) dhe (6); 330 paragrafi (6) dhe (7), 343 paragrafi (4); 343 paragrafët (4), (6), (7) dhe (8); 344 paragrafët (6), (7) dhe (8); 345 paragrafi (5), 348 paragrafët (5) dhe (6); 349 paragrafi (4); 355 paragrafët (5) dhe (6), 358 paragrafët (5) dhe (6); 360 paragrafi (5); 361 paragrafi (4); 362 paragrafi(8); 366 paragrafët (5) dhe (6); nga neni 373 fshihen fjalët "320 paragrafi (2); 321 paragrafi (7); 326 paragrafi (4); 343 paragrafi (3); 349 paragrafi (3); 349 paragrafi (3); 355 paragrafi (4); 361 paragrafi (3); 362 paragrafi (7); 365 paragrafi (3); 366 paragrafi (4); 367 paragrafi (3); prej nenit 374 fshihen fjalët "319 paragrafi (6); 322 paragrafi (4), 330 paragrafi (5); 343 paragrafi (5); 345 paragrafi (4); 348 paragrafi (4); 358 paragrafi (4); 360 paragrafi (4)"; nga neni 417 paragrafi 1 fshihen alinetë 6, 11, 15, 16 dhe 17; pushojnë të vlejshme nën 418 dhe 423, nga Ligji për siguri në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 54/2007, 86/2008 dhe 98/2008).

## Neni 100

### Zbatimi i prolonguar

(1) Dispozitat nga neni 23 paragrafët (2), (3) dhe (4), neni 26 paragrafi (4) dhe neni 60 paragrafi (4) do të fillojnë të zbatohen me ditën e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

(2) Fjalët „EU lejimi i tipit“ në nenin 7 paragrafi (1) alineja 1 do të fillojë të zbatohen me ditën e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

(3) Fjala „UE“ në nenin 15 paragrafi (1) i këtij ligji do të zbatohen nga dita e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

(4) Deri në hyrjen e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, ose me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për vlerësimin e përshtatjes me Bashkësinë Evropiane, shprehja "personi fizik ose juridik në Republikën e Maqedonisë ose me seli në Bashkësinë Evropiane" do të thotë "person fizik ose person juridik me seli në Republikën e Maqedonisë".

(5) Pas hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, ose me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për vlerësimin e përshtatjes me Bashkësinë Evropiane shprehja "shtet" në nenin 3 pika 50, në nenin 15 paragrafi (2) dhe shprehja "shteti" në nenin 3, pika 49, do të thotë "vend anëtar i Unionit Evropian".

(6) Dispozitat e nenit 41 paragrafi (1) i këtij ligji do të zbatohen pas datës 31 dhjetor 2010.

## Neni 101

### Hyrja në fuqi e këtij Ligji

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**DISPOZITË NGA LIGJE TË TJERË**

Ligj për plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2011):

**Neni 3**

Akti nënligjor i parapare në nenin 1 të këtij ligji, do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 123/2012, 153/2012 dhe 70/2013):

**Neni 52**

Personat fizike ose juridike të cilët me vetëdije i zotërojnë dhe i shfrytëzojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë traktorët dhe rimorkiot e traktorëve dhe të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë parashtruar kërkesë për regjistrim, ndërsa të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga neni 31 paragrafi (2) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, mund të parashtrojnë kërkesë për regjistrim te Ministria e Punëve të Brendshme me të cilën dorëzojnë:

- dëshmi për pronësi ose 10
- aktvendim për përcaktimin e statusit pronësor të traktorit ose rimorkios së traktorit,
- pëlqim për regjistrim për traktor dhe/ose rimorkio të traktorit të lëshuar në procedurë të identifikimi dhe vlerësim të gjendjes teknike nga shërbimi i autorizuar teknik ose personi juridik për kontroll teknik i autorizuar për kryerjen e identifikimit dhe identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike dhe automjeteve dhe
- dëshmi se janë plotësuar kushtet nga neni 31 paragrafi (2) alinetë 5 dhe 6 të këtij ligji.

Kërkesën për regjistrim personat fizikë dhe juridikë mund ta parashtrojnë deri më 30 qershor 2014.

Nëse pas përfundimit të afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, gjatë kryerjes së kontrollit të komunikacionit rrugor, Ministria e Punëve të Brendshme has traktor ose rimorkio të traktorit e cila nuk është e regjistruar, do t'i zbatojë dispozitat nga neni 26 paragrafët (9) dhe (12) të këtij ligji.

**Neni 53****Procedura për përcaktimin e statusit pronësor të traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve**

Përcaktimi i statusit pronësor të traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve (në tekstin e mëtejshëm legalizim) ngrihet me parashtrimin e propozimi për legalizimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve te gjykata kompetente vendore dhe reale, sipas vendit ku gjendet vendbanimi i parashtruesit të propozimit për legalizim.

Propozimi për legalizim nga paragrafi 1 i këtij neni veçanërisht i përmban këto të dhëna: të dhëna identifikuese marka, lloji, numri i shasisë dhe motorit dhe viti i pordhimti të traktorit dhe/ose rimorkios së traktorit, si dhe shkaqet për të cilat parashtrohet propozimi.

Me propozimin për legalizim nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet deklaratë e dhënë paraprakisht e verifikuar në noter nga parashtruesi i kërkesës, në të cilën parashtruesi në përgjegjësi të plotë materiale dhe penale do të

deklarojë se me vetëdije e ka zotëruar traktorin ose rimorkion e traktorit dhe se për to nuk mbahen procedurë tjetër para gjykatës kompetente.

Me propozimin për legalizim nga paragrafi 1 i këtij neni parashtruesi do t'i dorëzojë të gjitha dëshmitë në dispozicion të cilat i posedon për traktorin dhe/ose rimorkion e traktorit.

Propozimi për legalizim nga paragrafi 1 i këtij neni parashtrohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas propozimit të parashtruar për legalizim nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata në afat prej tri ditësh punë e njofton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave me kërkesë nëpërmjet tabelave për shpallje të njësive të saj rajonale t'i informojë personat e interesuar për propozimin e parashtruar.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në afat prej tri ditësh nga dorëzimi i njoftimit nga gjykata, njoftimin e dorëzon te njësitet rajonale të Ministrisë që në afat prej 24 orësh e shpallin në tabelën e shpalljeve në lokalet e saj me qëllim njohjen e publikut dhe personave të interesuar me propozimin e parashtruar.

Shpallja e njoftimit nga gjykata zgjat 30 ditë nga dita e vendosjes në tabelën e shpalljes.

Nëse pas përfundimit të afatit nga paragrafi 9 të këtij neni personi i interesuar me shkrim te gjykata nuk drejtohet me dëshminë e interesit të tij juridik, gjykata në afat prej 15 ditësh do të miratojë aktvendim për legalizim – përcaktim i statusit pronësor të traktorit ose rimorkios së traktorit.

Nëse në afatin e përcaktuar në paragrafin 9 të këtij neni paraqitet person i interesuar i cili do ta dëshmojë interesin e tij juridik, gjykata me aktvendim do t'i drejtojë pjesëmarrësit në afat të caktuar, jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e miratimit të aktvendimit të ngrenë procedurë kontestimore.

Nëse personi i interesuar në afat prej 15 ditësh nuk ngre procedurë kontestimore, atëherë procedura për legalizim do të vazhdojë kundër aktvendimit nga paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni lejohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

Nëse në afatin nga paragrafi 12 i këtij neni nuk është parashtruar ankesë, aktvendimi bëhet i plotfuqishëm.

#### **Neni 54**

Aktet nënligjore nga nenet 56 paragrafët (3) dhe (6), 56-a paragrafët (3) dhe (6), 62 paragrafët (2) dhe (7), 62-a paragrafët (2) dhe (7) dhe 66 paragrafi (6) të këtij ligji, do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas shpalljes së akteve nënligjore nga paragrafi 1 i këtij neni të njëjtat menjëherë e më së voni në afat prej 24 orësh shpallen në ueb faqen e ministrisë kompetente për miratimin e tyre.

#### **Neni 55**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 123/2012) :

**Neni 56**

Dispozitat e nenit 33-a të përcaktuara me nenin 23 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 57**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen nenet 176 dhe 323 të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 54/2007, 86/2008, 98/2008, 64/2009, 161/2009 dhe 51/11).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 70/2013) :

**Neni 3**

Propozimet për legalizimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve që nuk janë parashtruar në pajtim me afatin nga neni 53 paragrafi (5) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 123/12), mund të parashtrohen në periudhën prej 10 prillit 2013 deri më 30 shtator 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 164/2013) :

**Neni 2**

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje do të mbajë dhe sanksion për kundërvajtje do të kumtojë gjykata kompetente.

**Neni 3**

Ministria e Punëve të Brendshme e vendos sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional nga neni 66 paragrafi (1) i këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 4**

Ministria e Ekonomisë e vendos sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional nga neni 66 paragrafi (2) i këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 5**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen në afat jo më të gjatë se 120 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 6**

Sistemi unik elektronik nga nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, do të vendoset në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 7**

Procedurat e filluara për dhënien e provimit profesional deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundohen sipas dispozitave të rregullave sipas të cilave kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 164/2013):

**Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 138/2014):

**Neni 4**

Personat fizikë dhe juridikë të cilët nuk kanë dorëzuar kërkesë për regjistrimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve në afatin e përcaktuar në nenin 52 paragrafi (2) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 123/12 dhe 70/13), mund të paraqesin kërkesë për regjistrim në periudhën e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 30 qershor 2015.

**Neni 5**

Propozimet për legalizimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve që nuk janë dorëzuar në afatin e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 70/13) mund të dorëzohen në periudhën nga dita e hyrjes së fuqi të ligjit deri më 31 dhjetor 2014.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

**Neni 35**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 154/2015):

**Neni 36**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2016):

**Përcaktimi i statusit pronësor të traktorëve, rimorkiove të traktorëve, makinave mobile, motokultivatorëve, rimorkiove për banim, si dhe automjeteve nga kategoritë O1, O2 dhe L**

**Neni 6**

(1) Përcaktimi i statusit pronësor të traktorit, rimorkios së traktorit, makinës mobile, motokultivatorit, rimorkios për banim, si dhe automjeteve nga kategoritë O1, O2 dhe L (në tekstin e mëtejshëm: "legalizimi") ngrihet me



parashtrimin e propozimit për legalizim të traktorëve, rimorkiove të traktorit, makinës mobile, motokultivatorit, rimorkios për banim, si dhe automjeteve nga kategoritë O1, O2 dhe L deri në gjykatën kompetente të vendit ose reale, sipas vendit ku gjendet vendbanimi i parashtruesit të propozimit për legalizim.

(2) Propozimi për legalizim nga paragrafi (1) i këtij neni, veçanërisht i përmban këto të dhëna: të dhëna identifikuese - markë, tip, numër i shasisë dhe të motorit dhe vitin e prodhimit të automjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe shkaqet për të cilat parashtrohet propozimi.

(3) Me propozim për legalizim nga paragrafi (1) të këtij neni, dorëzohet deklaratë paraprakisht e dhënë e verifikuar në noter nga parashtruesi i kërkesës, në të cilën parashtruesi në përgjegjësi të plotë materiale dhe penale do të deklarojë se me vetëdije i ka zotëruar automjetet nga paragrafi (1) të këtij neni, dhe se për të njëjtat nuk mbahet procedurë tjetër para gjykatës kompetente.

(4) Me propozimin për legalizim nga paragrafi (1) të këtij neni, parashtruesi do t'i dorëzojë të gjitha dëshmitë të cilat i posedon për automjetet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Propozimi për legalizim nga paragrafi (1) të këtij neni, parashtrohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(6) Për propozim të parashtruar për legalizim nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata në afat prej tre ditë nëpërmjet tabelës së shpalljeve të gjykatës i informon personat e interesuar juridikë ose fizikë për propozimin e parashtruar.

(7) Shpallja e njoftimit nga gjykata zgjat 30 ditë nga dita e vendosjes në tabelën e shpalljeve.

(8) Nëse pas përfundimit të afatit nga paragrafi (7) i këtij neni, personi i interesuar gjykatës nuk i drejtohet me shkrim me dëshmim të interesit të tij juridik, gjykata në afat prej 15 ditë do të miratojë aktvendim për legalizim - përcaktim të statusit pronësor të automjeteve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(9) Nëse në afatin e përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni, paraqitet personi i interesuar i cili do ta dëshmojë interesin e vet juridik, gjykata me aktvendim do t'i dërgojë pjesëmarrësit në afat të caktuar, jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e miratimit të aktvendimit, të ngrenë procedurë kontestimore. Nëse personi i interesuar në afat prej 15 ditë nuk ngre procedurë kontestimore, atëherë procedura për legalizim do të vazhdojë,

(10) Kundër aktvendimit nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni është e lejuar ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(11) Nëse në afatin nga paragrafi (10) të këtij neni, nuk do të parashtrohet ankesë, vendimi mbetet i plotfuqishëm.". [11](#)

## **Neni 7**

(1) Personat fizikë ose juridikë të cilët me vetëdije i zotërojnë dhe shfrytëzojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë traktorët dhe rimorkiot e traktorëve, makinat mobile, motokultivatorët, rimorkiot për banim, si dhe automjetet nga kategoritë O1, O2 dhe L, të cilët deri në

ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë parashtruar kërkesë për regjistrim, ndërsa të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga nenin 31 paragrafi (2) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, mund të parashtrojnë kërkesë për regjistrim te Ministria e Punëve të Brendshme me të cilën dorëzojnë:

- dëshmi për pronësi ose aktvendim për përcaktim të statusit pronësor të traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve, makinave mobile, motokultivatorëve, rimorkiove për banim, si dhe automjeteve nga kategoritë O1, O2 dhe L;

- pëlqim për regjistrim të traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve, makinave mobile, motokultivatorëve, rimorkiove për banim, si dhe automjeteve nga kategoritë O1, O2 dhe L është dhënë në procedurë për identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike nga shërbimi i autorizuar ose person juridik për kontroll teknik i autorizuar për kryerje të identifikimit dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjete;

- vërtetim për karakteristika të përcaktuara minimaleteknike dhe të eksploatimit për makinat mobile të dhënë në procedurë për identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit dhe

- dëshmi se janë plotësuar kushtet nga neni 31 paragrafi (2) alinetë 5 dhe 6 të këtij ligji.

(2) Kërkesën për regjistrim personat fizikë dhe juridikë mund ta parashtrojnë deri 31 dhjetor 2017.

(3) Nëse pas përfundimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, gjatë kryerjes së kontrollit të komunikacionit rrugor, Ministria e Punëve të Brendshme gjen traktorë dhe rimorkio të traktorëve, makinë mobile, motokultivator, rimorkio për banim, si dhe automjet nga kategoritë O1, O2 dhe L të cilat nuk janë të regjistruara, do t'i zbatojë dispozitat nga neni 26 paragrafët (9) dhe (12) të këtij ligji." <sup>12</sup>

#### **Neni 9**

Vërtetimet ekzistuese për vozitje provë që i lëshon Ministria e Punëve të Brendshme drejtpërdrejtë ose përmes personave të autorizuar juridikë për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve ose persona juridikë të cilët lëshojnë në treg automjete do të zëvendësohen me formularë të rinj në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji." <sup>13</sup>

#### **Neni 10**

Procedurat e filluara për kërkesat për lëshimin e vërtetimeve për vozitje provë dhe targat provë do të mbarojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 11**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2016):

#### **Neni 8**

(1) Dispozitat e nenit 38 paragrafët (8) dhe (9), të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi

të këtij ligji,

(2) Personat juridikë ekzistues të autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik të automjetet dhe personat juridikë të cilët lëshojnë automjete në treg janë të obliguar në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji ta harmonizojnë punën e tyre dhe të parashtrojnë kërkesë për marrjen e autorizimit në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 12**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.”